

**VLERËSIME DHE KONKLUSIONE NGA RAPORTET E
PUNËS SË GJYKATAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
SË VERIUT, PËR VITIN 2022**

HYRJE

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Rendin kushtetues dhe parimin e ndarjes së pushteteve, si gjykatë më e lartë në shtet dhe bartëse e pushtetit gjyqësor, përmes kompetencës së Seancës së përgjithshme e ndjek punën e të gjitha gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që siguron principin e unitetit dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jep vlerësimin e funksionimit të tyre nga aspekti i përditësimit dhe kualitetit në sigurimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe ofrimin e sigurisë juridike të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përputhje me Ligjin për gjykatat dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 28.03.2022 u mbajt Seancë e përgjithshme e zgjeruar për shqyrtimin e raporteve të punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, ku ishin të ftuar dhe të pranishëm kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative dhe kryetarët e gjykatave të apelit Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Të dhënat nga raportet e gjykatave për vitin 2022, tregojnë se nga gjyqtarët dhe shërbimi gjyqësor është bërë një përpjekje e madhe në mënyrë që mund të konstatohet se edhe në kushte të numrit dukshëm të zvogëluar të gjyqtarëve dhe nëpunësve gjyqësor, kushtet e teknologjisë ekzistuese informatike, hapësinore dhe financiare dhe materiale nga gjithsej 29 gjykatat e të gjitha instancave, 19 gjykata e kanë përfunduar vitin raportues me përditësim, ose që do të thotë se një numër i konsideruar i gjykatave janë vlerësuar si të përditësuara.

Gjykatat vitin 2022 e kanë filluar me 96.204 lëndë, si pjesë e mbetur e vitit të kaluar. Gjatë vitit 2022 të reja të pranuar janë 571.115 lëndë, së bashku me lëndët përsëri në punë 5.636 dhe 222 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej ka pasur 672.823 lëndë. Të kryera janë 564.850, lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 107.974 lëndë. Me atë, si konstatim përfundimtar pozitiv është se një numër i konsiderueshëm i gjykatave në vitin 2022 kanë arritur të tejkalojnë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojnë numrin e lëndëve që kanë mbetur.

Gjykata e Lartë Administrative gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 3.656 lëndë, të reja të pranuar janë 2.870 lëndë, ndërsa të kryera janë 2.884 lëndë, ashtu që është tejkeluar fluksi i lëndëve.

Gjykata Administrative gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 12.181 lëndë, të reja të pranuar janë 6.401 lëndë ndërsa të kryera janë 6,992 lëndë, në mënyrë që është tejkeluar fluksi i lëndëve.

Gjykatat e apelit gjatë vitit 2022 në punë kanë pasur gjithsej 32.357 lëndë, të reja të pranuar janë 23.249 lëndë, ndërsa të kryera janë 23,138 lëndë, në mënyrë që nuk është tejkalluar fluksi i lëndëve.

Gjykatat themelore gjatë vitit 2022, në punë kanë pasur gjithsej 624.629 lëndë, të reja të pranuar janë 538.595 lëndë, ndërsa të kryera janë 531.836 lëndë, në mënyrë që kanë arritur që të tejkalojnë fluksin e lëndëve.

Nga vlerësimet e miratuara dhe konkluzionet e nxjerra sipas raporteve të punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe propozim masat e dhëna ngelet përshtypja se mund të arrihen rezultate edhe më të mira në qoftë se plotësohen vendet e zbrazura për gjyqtarë me zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj, të plotësohen vendet e zbrazura të punës në shërbimin gjyqësor për të gjitha profilet me kuadro përkatës, të sigurohet edukimi i vazhdueshëm, si dhe me rikuperimin e pajisjes informatike, përmirësimin e kushteve hapësinore dhe gjendjes materiale dhe financiare.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi si vijon:

VLERËSIME DHE KONKLUZIONE MBI PUNËN E GJYKATAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, PËR VITIN 2022

GJYKATA E LARTË ADMINISTRATIVE

Në fillim të periudhës raportuese për vitin 2022, në Gjykatën e Lartë Administrative kanë mbetur 795 lëndë të pakryera, 2.870 janë lëndë të reja të pranuar, 9 lëndë janë të evidentuara gabimisht ose gjithsej në punë ka pasur 3.656 lëndë, nga të cilat 2.884 janë lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pakryera 772 lëndë.

Gjatë vitit 2022 Gjykata e Lartë Administrative, në mënyrë administrative ka kthyer në Gjykatën Administrative 195 lëndë për shkak të lëshimeve në përgatitjen e lëndëve dhe në veprimet jo në tërësi të ndërmarra, kurse prej tyre vetëm 187 lëndë janë kthyer në Gjykatën e Lartë Administrative.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore, në fillim të vitit 2022 nuk ka pasur lëndë të pakryera nga administrata gjyqësore, të reja të pranuar janë 1.012 lëndë dhe të gjitha janë kryer.

Nga lëndët e pranuar në Administratën gjyqësore në Regjistrin "Su" janë pranuar gjithsej 351 lëndë dhe të gjitha janë të kryera, në Regjistrin Su-01 janë pranuar 72 lëndë dhe të gjitha janë të kryera, në Regjistrin Su-02 janë pranuar 42 lëndë dhe të gjitha janë kryer, në Regjistrin Su-03 janë pranuar 110 lëndë dhe të gjitha janë kryer, në Regjistrin Su-04 janë pranuar 174 lëndë dhe të gjitha janë kryer, në Regjistrin Su-05 janë pranuar 36 lëndë dhe të gjitha janë kryer, në Regjistrin Su-07 janë pranuar 17 lëndë dhe të gjitha janë kryer, në Regjistrin Su-Izz janë pranuar 28 lëndë dhe të gjitha janë kryer dhe SU-str-dov janë pranuar 3 lëndë dhe të gjitha janë kryer. Në Regjistrin UPP janë pranuar 169 lëndë dhe të gjitha janë kryer dhe në Regjistrin SPI janë pranuar 10 lëndë dhe të gjitha janë kryer.

PUNA E SEKTORËVE

Puna e lëndëve në këtë gjykatë në periudhën prej 01.01.2022 deri më 30.06.2022 zhvillohet në katër këshilla, të formuara në kuadër të tre këshillave të specializuar gjyqësor,

ndërsa në periudhën prej 01.07.2022 deri më 31.12.2022, në tre këshilla, të formuara në kuadër të tre këshillave të specializuar gjyqësor edhe atë:

Këshilli i specializuar gjyqësor për sferën juridiko-pronësore dhe të drejta tjera

Nga viti i kaluar kanë mbetur të pakryera 252 lëndë nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera, të reja të pranuar janë 782 lëndë, të evidentuara gabimisht janë 3 ose gjithsej në punë ka pasur 1.031 lëndë. Janë kryer gjithsej 806 lëndë, kurse kanë mbetur të pakryera 225 lëndë. Në nivelin e këtij këshilli është tejkualuar fluksi për 24 lëndë, përkatësisht është ulur numri i lëndëve që kanë mbetur për 27 lëndë.

Këshilli i specializuar gjyqësor për të drejtat e pensionit, invalidore, sociale, shëndetësore, të drejtat e marrëdhënies së punës, të drejtat financiare dhe të drejta tjera

Në këtë këshill nga viti i kaluar kanë mbetur 248 lëndë të pakryera, janë pranuar 658 lëndë të reja, 2 lëndë të evidentuara gabimisht ose gjithsej në punë ka pasur 904 lëndë, nga të cilat janë kryer 782 lëndë, kanë mbetur 122 lëndë të pakryera. Në nivel të këtij këshilli është tejkualuar fluksi për 124 lëndë, përkatësisht është ulur numri i lëndëve të mbetura për 126 lëndë.

Këshilli i specializuar gjyqësor për të drejtat tatimore, doganore dhe të drejta tjera

Këshilli i parë për të drejtat nga sfera e të drejtave tatimore dhe të drejta tjera për periudhën prej 01.01.2022 – 30.06.2022

Në këtë këshill nga viti i kaluar kanë mbetur 184 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 176 lëndë, gabimisht të evidentuar është vetëm 1 lëndë ose gjithsej në punë kane qenë 359 lëndë, nga të cilat 339 janë lëndë të kryera, kurse kanë mbetur të pakryera 20 lëndë. Në nivelin e këtij këshilli është tejkualuar fluksi për 163 lëndë, përkatësisht është zvogëluar numri i lëndëve që kanë mbetur për 164 lëndë.

Këshilli i specializuar për të drejtat tatimore, doganore dhe të drejta tjera

Këshilli i dytë për të drejtat nga sfera e të drejtave doganore dhe të drejta tjera për periudhën prej 01.01.2022 – 30.06.2022

Në këtë këshill nga viti i kaluar kanë mbetur 111 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 531 lëndë ose gjithsej kanë qenë 642 lëndë në punë, nga të cilat 406 lëndë janë të kryera, kurse kanë mbetur 236 lëndë të pakryera. Në nivelin e këtij këshilli nuk është tejkualuar fluksi për 125 lëndë, përkatësisht është rritur numri i theksuar i lëndëve prej 125 lëndëve.

Duke qenë se sipas Aktvendimit të Këshillit gjyqësor të RMV, katër gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë Administrative, deri më 30.06.2022, u është konstatuar ndërprerja e funksionit të gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim sipas moshës, me Ndryshimin dhe plotësimin e Orarit të punës së Gjykatës së Lartë Administrative për vitin 2022 dhe me Ndryshimin e Programit të punës së Gjykatës së Lartë Administrative për vitin 2022 formohet një këshill në këshillin e tretë të specializuar gjyqësor që vepron dhe vendos për lëndë nga sfera për të drejtat tatimore, doganore dhe të drejta tjera.

Këshilli i specializuar gjyqësor për të drejtat tatimore, doganore dhe të drejta tjera për periudhën prej 01.07.2022 – 31.12.2022

Në këtë këshill nga viti i kaluar kanë mbetur 256 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 723 lëndë, gabimisht të evidentuara janë 3 lëndë, gjithsej në punë ka pasur 976 lëndë, nga të cilat 551 lëndë janë të kryera, kurse kanë mbetur 425 lëndë të pakryera. Në nivelin e këtij këshilli nuk është tejkualuar fluksi për 172 lëndë, përkatësisht është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur për 169 lëndë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën e Lartë Administrative deri më 31.12.2022, nuk ka lëndë të vjetra të pakryera.

Burime njerëzore

Në Gjykatën e Lartë Administrative në gjysmë vjetorin e parë në periudhën prej 01.01.2022 - 30.06.2022 ka Kryetar të Gjykatës dhe 13 gjyqtarë që e kanë realizuar

funkcionin e gjyqtarit, në mënyrë që katër gjyqtarëve me vendim për ndërprerje të funksionit të gjyqtarit të miratuara nga Këshilli gjyqësor të RMV të datës 30.06.2022 u është ndërprerë funksioni i gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim sipas moshës. Në periudhën deri më 31.12.2022 funksionin e gjyqtarit kanë vazhduar ta realizojnë 9 gjyqtarë dhe së bashku me Kryetarin e Gjykatës, në këtë periudhë punojnë 10 gjyqtarë.

Në këtë gjykatë deri më 31.12.2022 ka gjithsej të punësuar 18 nëpunës gjyqësor dhe 1 pjesëtar i policisë gjyqësore.

Gjatë muajit shkurt 2022 në procedurë për punësim me Shpallje publike në Gjykatën e Lartë Administrative është zbatuar procedura për punësimin e 5 nëpunësve gjyqësor, ndërsa gjatë muajit maj 2022 një nëpunësi gjyqësor me titullin bashkëpunëtor gjyqësor i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pranimit si kandidat – dëgjues i trajnimit fillestar në Akademinë për gjyqtarë dhe Prokurorë Publik “Pavel Shatev” Shkup.

Sipas Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën e Lartë Administrative, deri më 31.12.2022 në këtë gjykatë ka pasur 19 persona të punësuar në kuadër të shërbimit gjyqësor edhe atë: 1 administrator gjyqësor, 2 nëpunës udhëheqës gjyqësor, 4 nëpunës profesional gjyqësor, 11 nëpunës – ndihmës profesional gjyqësor dhe 1 pjesëtar i policisë gjyqësore.

Kapacitetet hapësinore

Me themelimin e saj Gjykata e Lartë Administrative, aktivitetet nga kompetenca ligjore i realizon në objektin që gjendet në rr. “Nikolla Parapunov” nr.31 në Shkup, me një sipërfaqe prej 484 m² që disponon me 17 hapësira punuese ku rruhen lëndët për të cilat vendos kjo gjykatë dhe 3 hapësira ndihmëse të vogla që shërbejnë për ruajtjen e materialit për zyra, aparat për fotokopjim dhe të ngjashme. Hapësira e theksuar e ndërtesës në të cilën është e vendosur Gjykata e Lartë Administrative nuk i përmbush nevojat e gjyqtarëve dhe punonjësve, për shkak se gjyqtarët janë vendosur në hapësira që janë shumë të vogla edhe atë në një hapësirë nga dy gjyqtarë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në periudhën raportuese, Gjykata e Lartë Administrative e ka tejkaluar fluksin e lëndëve për 14, përkatësisht e zvogëloi numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 23 dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

-Pajisja e gjykatës me kuadro me numër të nevojshëm të gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore;

-Sigurimi adekuat i kushteve me hapësira për punë në Gjykatën e Lartë Administrative;

-Edukimi në vazhdimësi i gjyqtarëve dhe punonjësve tjerë në gjykatë;

-Vendosja elektronike ndërlidhëse e organeve administrative me Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative.

GJYKATA ADMINISTRATIVE

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në fillim të periudhës raportuese për vitin 2022, në Gjykatën Administrative kanë mbetur 5.580 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 6.401 lëndë, përsëri të evidentuara janë 233 lëndë, gabimisht të evidentuara janë 33 lëndë ose gjithsej në punë kanë qenë 12.181 lëndë, nga të cilat të kryera janë 6.992 lëndë, ndërsa 5.189 lëndë kanë mbetur të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore nga viti i kaluar kanë mbetur 10 lëndë të pa kryera, të reja të pranuar 1.787 lëndë, ose gjithsej në punë ka pasur 1.797 nga të cilat 1.738 të kryera, kurse kanë mbetur të pa kryera 59 lëndë.

Në Regjistrin "Su" ka pasur 6 lëndë të pakryera nga viti i kaluar, të reja të pranuar janë 1.285 lëndë dhe nga gjithsej në punë 1.291 të kryera janë 1.287, ndërsa kanë mbetur 4 lëndë të pakryera. Në Regjistrin "Su-Dov" janë pranuar 13 lëndë të reja dhe të njëjtat janë të kryera. Në Regjistrin "SPI" janë pranuar 28 lëndë të reja dhe nga ato 26 lëndë janë të kryera, ndërsa 2 lëndë kanë mbetur të pakryera. Në Regjistrin "UPP" nga viti i kaluar kanë mbetur 4 lëndë të pakryera, ndërsa janë pranuar 461 lëndë të reja dhe nga gjithsej 465 lëndëve në punë, 412 lëndë janë të kryera, ndërsa 53 lëndë kanë mbetur të pakryera.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Puna e lëndëve në këtë gjykatë në vitin 2022 zhvillohet në tri sektorë të specializuar edhe atë:

Spektori për sferën juridiko – pronësore, denacionalizim, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme

Në këtë sektor funksionojnë tri këshilla edhe atë: një këshillë që vepron dhe vendos mbi lëndët nga sfera juridiko-pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme dhe dy këshilla që veprojnë dhe vendosin mbi lëndë nga sfera e denacionalizimit, urbanizmit, ndërtimtarisë dhe të drejta tjera të ngjashme.

Gjendja me lëndët nga sfera juridiko-pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar kanë mbetur 669 lëndë të pakryera nga sfera juridiko-penale dhe të drejta tjera të ngjashme, janë pranuar 885 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara janë 8 lëndë dhe nga gjithsej 1.516 lëndëve në punë, janë kryer gjithsej 962 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 554 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkualuar për 107, përkatësisht është zvogëluar mbetja për 115 lëndë.

Gjendja me lëndët nga sfera e denacionalizimit dhe të drejta tjera dhe gjendja me lëndët nga sfera e urbanizmit, ndërtimtarisë dhe të drejta tjera të ngjashme.

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.100 lëndë të pakryera, janë pranuar 1.385 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara janë 11 lëndë ose gjithsej në punë ka pasur 2.474 lëndë, gjithsej janë kryer 1.544 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 930 lëndë. Është zvogëluar numri i lëndëve të mbetura për 170 lëndë, përkatësisht është tejkualuar fluksi për 159 lëndë.

Spektori për pensione, të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera, doganat dhe të drejta tjera të ngjashme

Në këtë sektor funksionojnë tre këshilla, nga të cilat njëri është kompetent për lëndët nga sfera e pensioneve, të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera, ndërsa dy këshillat tjerë mbi lëndët nga sfera e doganave dhe të drejtat tjera.

Gjendja me lëndët nga sfera e pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar kanë mbetur 560 lëndë të pakryera, janë pranuar 717 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara janë 2 lëndë dhe nga gjithsej 1.275 lëndëve në punë, janë kryer gjithsej 757 lëndë, ndërsa kanë mbetur 518 lëndë të pakryera. Është zvogëluar mbetja për 42 lëndë, përkatësisht është tejkualuar fluksi për 40 lëndë.

Gjendja me lëndët nga sfera e doganave dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga vitit i kaluar kanë mbetur 1.558 lëndë të pakryera, janë pranuar 1.391 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara janë 4 lëndë, gjithsej në punë ka pasur 2.945 lëndë, gjithsej 1.883 lëndë janë kryer, ndërsa kanë mbetur të pakryera 1.062 lëndë. Është zvogëluar mbetja për 496 lëndë, përkatësisht është tejkualuar fluksi për 492 lëndë.

Spektori i çështjeve financiare dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.693 lëndë të pakryera, janë pranuar 2.286 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 8 lëndë, gjithsej në punë ka pasur 3.971 lëndë, gjithsej të kryera kanë qenë 1.846 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 2.125 lëndë. Është rritur mbetja për 432 lëndë, përkatësisht nuk është tejkualuar fluksi për 440 lëndë.

CILËSIA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin 2022 në Gjykatën Administrative janë paraqitur 2.817 ankesa, ndërsa në Gjykatën e Lartë Administrative me vendime të shkallës së dytë janë kthyer 2.806 lëndë.

CILËSIA E LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORËVE

Sektori për sferën juridiko – pronësore, denacionalizim, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme.

Lëndë nga sfera juridiko – pronësore dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 435 lëndëve të pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 325 janë të konfirmuara ose 74,71%, 51 të ndryshuara ose 11,72%, 39 të abroguara ose 8,97%, dhe 20 të hedhura poshtë ose 4,60%.

Lëndët nga sfera e denacionalizimit dhe të drejta tjera të ngjashme, urbanizëm, ndërtimtari dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 544 lëndë të pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 340 të konfirmuara ose 62,50%, 69 të ndryshuara ose 12,68%, 68 të abroguara ose 12,50% dhe 67 të hedhura poshtë ose 12,32%.

Sektori për pensionet, të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera, doganat dhe të drejta tjera të ngjashme

Lëndët nga sfera e pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 219 lëndët e pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 171 janë të konfirmuara ose 78,08%, 19 të ndryshuara ose 8,68%, 18 të abroguara ose 8,22% dhe 11 të hedhura poshtë ose 5,02%.

Lëndët nga sfera e doganave dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 1.047 lëndët e pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 910 janë të konfirmuara ose 86,91%, 67 të ndryshuara ose 6,40%, 39 të abroguara ose 3,72%, 1 pjesërisht e konfirmuar ose 0,10% dhe 30 të hedhura poshtë ose 2,87%.

Sektori për çështje financiare dhe të drejta tjera të ngjashme

Nga gjithsej 561 lëndët e pranuar për ankesa në Gjykatën e Lartë Administrative, 434 janë të konfirmuara ose 77,36%, 37 të ndryshuara ose 6,60%, 59 të abroguara ose 10,52% dhe 31 të hedhura poshtë ose 5,53%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të periudhës raportuese kanë mbetur 24 lëndë të vjetra. Gjatë vitit 2022 statusin e lëndëve të vjetra e kanë fituar 315 lëndë, ose gjithsej 339 nga të cilat janë kryer 196 lëndë, kurse në fund të vitit 2022 kanë mbetur të pakryera 143 lëndë.

Burime njerëzore

Në vitin 2022 në Gjykatën Administrative janë plotësuar gjithsej 27 vende gjyqitari duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës nga gjithsej 33 vendet e parapara për gjyqtarë, sipas Vendimit të Këshillit gjyqësor të RMV. Njërit prej gjyqtarëve i pushon funksioni i gjyqtarit – gjyqtar në Gjykatën Administrative për shkak që është zgjedhur Kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative. Më 28.04.2022 me Aktvendim të Këshillit gjyqësor të RMV është konstatuar ndërprerja e funksionit të gjyqtarit për shkak të plotësimit të kushteve për realizimin e të drejtës së pensionit me moshë, ndërsa me Aktvendim të datës 18.05.2022 gjithashtu është konstatuar ndërprerja e funksionit të gjyqtarit për një gjyqtar për shkak të plotësimit të kushteve për realizimin e të drejtës së pensionit me moshë.

Në pjesën e shërbimit gjyqësor, sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Administrative, deri më 31.12.2022, janë paraparë gjithsej 171 vende pune, nga të cilat 80 janë plotësuar, duke përfshirë edhe 11 nëpunësit gjyqësor të punësuar në Gjykatë në kohë të caktuar pune, ndërsa 91 vendet tjera të punës janë të paplotësuara.

Gjatë muajve shkurt dhe mars 2022 dy nëpunësve gjyqësor u ka pushuar marrëdhënia e punës, ndërsa në muajin korrik 2022 është bërë transferimi i një nëpunësi nga organi i drejtorisë shtetërore - Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, me titullin “këshilltar – zëdhënës”.

Gjatë vitit 2022 dy nëpunësve edhe atë njërit bashkëpunëtor – përkthyes, dhe tjetrit referent i ri gjyqësor u është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe 11 personave me të cilët ka qenë e lidhur marrëveshja për punësim në kohë të caktuar pune.

Deri më 31.12.2021, në këtë gjykatë janë të punësuar gjithsej 80 persona në kuadër të shërbimit gjyqësor, duke përfshirë edhe nëpunësit gjyqësor të punësuar në kohë caktuar pune.

Kapacitetet hapësinore

Duke filluar nga 06.07.2022 Gjykata Administrative kompetencat e saj ligjore i zbaton në hapësirat e reja në objektin që gjendet në rr. "Dame Gruev" numër 6 në Shkup, i dhënë për shfrytëzim të përhershëm pa kompensim me Vendim O.Nr.44-8928/1 të datës 25.09.2018 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili objekt ka 8 kate dhe në të cilin të gjithë gjyqtarët kanë zyrat e veta të sistemuar nëpër kate, sipas këshillave në të cilat veprojnë.

Në Gjykatën Administrative gjatë vitit 2022 punojnë 30 nëpunës profesional gjyqësor, të vendosur në katin e 8 të ndërtesës së Gjykatës. Në ndërtesën e Gjykatës Administrative ka 8 salla gjykimi të pajisura bashkëkohore për mbajtjen e seancave me gojë, publike dhe të drejtpërdrejta, të cilat janë rregull sipas Ligjit për konteste administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.96/19). Për sigurimin e punonjësve dhe palëve kujdesen 4 pjesëtarë të policisë gjyqësore.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjatë periudhës raportuese Gjykata Administrative nuk e tejkaloi fluksin e lëndëve për 591 lëndë, ndërsa ka zvogëluar mbetjen për 391 lëndë, respektivisht për atë arsye për periudhën për vitin 2022 vlerësohet si **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

-Përforcimi i burimeve njerëzore me pajisjen e kuadrove të gjykatës me nëpunës gjyqësor nga të gjitha kategoritë e parapara ligjore;

-Edukimi në vazhdimësi i gjyqtarëve dhe të punësuarave në gjykatë;

-Tejkalimi i numrit të lëndëve të vjetra për shkak të numrit të rritur të lëndëve që kanë marrë statusin e lëndëve të vjetra në periudhën raportuese, për të cilën gjë është theksuar se sipas Ligjit për konteste administrative për marrjen e vendimit përfundimtar, është i domosdoshëm vendimi nga gjykata më e lartë.

-Të bëhet vendosja elektronike ndërlidhëse e organeve administrative me Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative.

GJYKATA E APELIT SHKUP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin raportues 2022, Gjykata e Apelit Shkup ka pasur në punë 19.726 lëndë, nga të cilat 6.897 lëndë, të cilat si të pakryera kanë kaluar nga viti i kaluar, 12.736 lëndë të reja të pranuar (nga të cilat 4 janë të evidentuara gabimisht) dhe 97 lëndë përsëri në punë.

Gjatë vitit raportues nga numri i gjithsej lëndëve në punë, gjykata ka kryer 12.887 lëndë, ndërsa kanë mbetur 6.839 lëndë të pakryera. Fluksi është tejkaluar, janë kryer gjithsej 65,33% nga gjithsej numri i lëndëve.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit 2022, gjykata në punë ka pasur gjithsej 2.691 lëndë, nga të cilat janë kryer në vitin raportues 2.686 lëndë, kurse ka mbetur 5 lëndë të pakryera.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Spektori penal

Lëndët penale, lëndë penale nga krimi i organizuar, lëndë penale – fëmijët dhe lëndë për kundërvajtje

Në sektorin penal në vitin raportues, gjithsej në punë ka pasur 1.548 lëndë penale (KZH) nga të cilat 397 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, kurse 1.137 lëndë janë të reja të pranuar dhe 14 lëndë përsëri në punë, në mënyrë që gjykata ka kryer gjithsej 977 lëndë, që do të thotë se **fluksi është tejkaluar**, kurse në fund të vitit kanë mbetur 571 lëndë të pakryera.

Për dallim nga viti i kaluar, kur gjykata ka pasur në punë gjithsej 1.655 lëndë, në vitin raportues vëllimi i punës është zvogëluar për 107 lëndë. Fluksi i lëndëve të reja të pranuar

është më i vogël për 61 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kur janë pranuar 1.212 lëndë. Numri i lëndëve të kryera penale është zvogëluar për 281 lëndë. Në krahasim me vitin e kaluar kur janë kryer 1.258 lëndë, në vitin raportues numri i lëndëve të pakryera penale është rritur për 174 lëndë, përkatësisht kanë mbetur 571 lëndë të pakryera.

Në kuadër të sektorit penal, segment të posaçëm paraqet veprimi me lëndët penale të kimit të organizuar (KOKZH), ku në punë ka pasur gjithsej 214 lëndë, nga të cilat 166 lëndë janë të reja të pranuar, nga të cilat 1 lëndë është evidentuar gabimisht, ndërsa 49 lëndë janë të pakryera nga viti i kaluar. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë 156 lëndë janë të kryera, që do të thotë se gjykata e **tejkualuar fluksin**, ndërsa si të pakryera kanë mbetur 58 lëndë.

Në krahasim me vitin e kaluar, kur gjykata në punë ka pasur gjithsej 167 lëndë, në vitin raportues vëllimi i punës është rritur për 47 lëndë, fluksi është për 46 lëndë më i madh në krahasim me vitin e kaluar kur kanë qenë të pranuar 119 lëndë. Numri i lëndëve të kryera KOKZH, në vitin raportues është rritur për 38 lëndë, ndërsa në krahasim me vitin e kaluar janë kryer 118 lëndë. Në vitin raportues numri i lëndëve të pakryera është rritur për 9 lëndë, përkatësisht kanë mbetur 58 lëndë të pakryera.

Në kuadër të sektorit penal, segment të veçantë paraqet veprimi me lëndët penale – fëmijë. Në vitin raportues gjithsej në punë ka pasur 38 lëndë, nga të cilat 36 janë lëndë të reja të pranuar, 2 lëndë janë të pakryera nga viti i kaluar, deri në fund të vitit raportues janë kryer 32 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 6 lëndë.

Në krahasim me vitin e kaluar, gjykata ka pasur në punë gjithsej 32 lëndë, ndërsa në vitin raportues vëllimi i punës është rritur për 6 lëndë, fluksi i lëndëve të reja është më i madh për 5 lëndë në krahasim me vitin e kaluar kur kanë qenë të pranuar 31 lëndë. Numri i lëndëve të kryera në vitin raportues është rritur për 2 lëndë, kur janë kryer 30 lëndë. Në vitin raportues numri i lëndëve të pakryera është rritur për 4 lëndë, përkatësisht kanë mbetur gjithsej 6 lëndë të pakryera.

Në kuadër të këtij sektori, segment të veçantë paraqet veprimi me lëndët për kundërvajtje (PRKZH). Gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 3.810 lëndë, nga të cilat 2.148 lëndë janë të reja të pranuar, 1 lëndë është përsëri e evidentuar në punë, ndërsa 1.661 lëndë janë bartur nga viti i kaluar. Gjykata ka kryer 2.345 lëndë, përkatësisht e ka **tejkualuar fluksin**, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 1.465 lëndë të pakryera.

Në krahasim me vitin e kaluar, gjykata ka pasur në punë 3.672 lëndë, në vitin raportues vëllimi i punës është rritur për 138 lëndë. Numri i lëndëve të kryera është rritur për 334 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, të pakryera janë 1.465 lëndë të mbetura në fund të vitit 2022, është zvogëluar për 196 lëndë në krahasim me periudhën e kaluar raportuese.

Cilësia e punës në sektorin penal

Në vitin raportues, lëndë vlerësimi nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi mjete të deklaruara juridike kanë qenë 125 vendime për lëndë penale të Gjykatës së Apelit Shkup, që paraqet 2,84% nga gjithsej numri i 4.394 vendimeve të sjella në vitin raportues. Nga ato vendime, 108 janë të konfirmuara, përkatësisht 2,46% nga gjithsej lëndët e kryera, 16 vendime janë të abroguara, përkatësisht 0,36% nga gjithsej lëndët e kryera, 1 vendim është i ndryshuar, përkatësisht 0,02% nga gjithsej lëndët e kryera.

Sektori civil

Gjatë vitit 2022, gjykata ka pasur në punë gjithsej 6.414 lëndë civile nga të cilat 2.293 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, 4.078 lëndë janë të reja të pranuar, nga të cilat 1 lëndë është evidentuar gabimisht, 44 lëndë janë përsëri në punë, në mënyrë që gjykata ka kryer gjithsej 3.684 lëndë, përkatësisht **nuk e ka tejkualuar fluksin**, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 2.730 lëndë të pakryera.

Në krahasim me vitin e kaluar, kur në këtë sektor ka pasur gjithsej 6.598 lëndë, vëllimi i punës në vitin raportues është zvogëluar për 184 lëndë. Në këtë mënyrë fluksi në vitin raportues është zvogëluar për 802 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kur janë pranuar 4.923 lëndë. Është zvogëluar numri i lëndëve të kryera në vitin raportues edhe atë për 621 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar. Numri i lëndëve të mbetura në punë në fund të vitit raportues është rritur për 437 lëndë në raport me 2.293 lëndë që kishin mbetur në fund të vitit 2021.

Cilësia e punës në sektorin civil

Lëndë e vlerësimit nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi mjete të deklaruara juridike kanë qenë 194 vendime të Gjykatës së Apelit, që paraqet 5,26% nga gjithsej numri i 3.684 vendimeve të sjella në vitin raportues, nga të cilat 142 janë të konfirmuara ose 3,85% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera, 18 vendime ose 0,49% nga gjithsej numri i lëndëve të kryera janë të abroguara, dhe 34 vendime përkatësisht 0,92% nga gjithsej numri i lëndëve janë të ndryshuara.

Sa i përket numrit prej 194 vendimeve të sjella nga Gjykata Supreme e RMV, 142 vendime, përkatësisht 73,20% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë për mjet të jashtëzakonshëm juridik të konfirmuara, 18 vendime përkatësisht 9,28% janë të abroguara dhe 34 vendime, përkatësisht 17,53% janë të ndryshuara.

Spektori i kontesteve të punës

Gjatë vitit 2022, sektori ka pasur gjithsej në punë 4.373 lëndë, nga të cilat 1.878 lëndë janë bartur nga viti i kaluar, 2.490 lëndë të reja të pranuar (nga të cilat 2 janë gabimisht të evidentuara), 7 lëndë janë përsëri në punë, ashtu që të kryera janë gjithsej 3.048 lëndë, përkatësisht **e ka tejkaluar fluksin**, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 1.325 lëndë të pakryera.

Në krahasim me vitin e kaluar, gjykata në punë ka pasur gjithsej 4.373 lëndë. Nuk ka ndryshim në vëllimin e këtij sektori. Në vitin raportues fluksi është zvogëluar për 237 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kur janë pranuar 2.732 lëndë. Numri i lëndëve të kryera në vitin raportues është rritur për 553 lëndë, në krahasim me vitin e kaluar kur kanë qenë të kryera 2.495 lëndë. Numri i lëndëve të mbetura është zvogëluar për 553 lëndë, në krahasim me 1.878 lëndët që kanë mbetur në fund të vitit 2021.

Cilësia e punës në sektorin e kontesteve të punës

Për vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi mjete të deklaruara juridike janë 60 (ROZH) vendime gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkup, përkatësisht 1,97% nga gjithsej numri i 3.048 vendime të sjella në vitin raportues, nga të cilat 47 vendime, përkatësisht 1,54% nga gjithsej lëndët e kryera janë të konfirmuara, 9 vendime, përkatësisht 0,30% janë të abroguara dhe 4 vendime, përkatësisht 0,13% janë të ndryshuara.

Nga gjithsej numri i 60 lëndëve të kryera për mjete të jashtëzakonshme juridike, të konfirmuara janë 47 lëndë, përkatësisht 78,33%, të abroguara janë 9 lëndë, përkatësisht 15,00% dhe të ndryshuara janë 4 lëndë, përkatësisht 6,67%.

Nga gjithsej 3.048 lëndët e kryera ROZH nga sfera e kontesteve të punës procedura deri në 1 muaj ka zgjatur në 111 lëndë, deri në 2 muaj në 50 lëndë, deri në 3 muaj në 43 lëndë, deri në 6 muaj në 927 lëndë dhe mbi 6 muaj në 1.917 lëndë.

Spektori i kontesteve tregtare

Ky sektor, gjatë vitit raportues 2022, në punë ka pasur gjithsej 2.412 lëndë, nga të cilat 559 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, 1.822 lëndë janë të reja të pranuar dhe 31 lëndë kanë qenë përsëri në punë. Në vitin raportues gjykata ka kryer 1.761 lëndë, ashtu që **nuk e ka tejkaluar fluksin**, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 651 lëndë të pakryera.

Në krahasim me vitin e kaluar, kur gjykata në punë ka pasur 3.080 lëndë, në vitin raportues vëllimi i punës është zvogëluar për 668 lëndë. Fluksi i lëndëve në vitin raportues është zvogëluar për 359 lëndë në krahasim me vitin e kaluar, kur gjithsej janë pranuar 2.212 lëndë. Numri i lëndëve të kryera në vitin raportues është zvogëluar për 760 lëndë në krahasim me vitin e kaluar kur janë kryer 2.521 lëndë. Në fund të vitit raportues 2022 kanë mbetur 651 lëndë, që është për 92 lëndë më shumë në krahasim me vitin e kaluar.

Cilësia e punës në sektorin e kontesteve të punës

Për vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi mjete të deklaruara juridike janë 146 (TSZH) vendime gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkup, përkatësisht 8,29% nga gjithsej numri i 1.761 vendimeve të sjella në vitin raportues, nga të cilat 112 vendime përkatësisht 6,36% e gjithsej lëndëve të kryera janë të konfirmuara, 7

vendime përkatësisht 0,40% janë të abroguara dhe 27 vendime përkatësisht 1,53% janë të ndryshuara.

Nga gjithsej 1.761 lëndët e kryera TSZH nga sfera e kontesteve tregtare procedura deri në 1 muaj ka zgjatur në 356 lëndë, deri në 2 muaj në 210 lëndë, deri në 3 muaj në 234 lëndë, deri në 6 muaj në 653 lëndë dhe mbi 6 muaj në 308 lëndë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2022, gjykata në punë ka pasur gjithsej 8.153 lëndë të vjetra, nga të cilat 2.408 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa për 5.745 lëndë gjatë vitit raportues. Në gjykatë gjithsej janë kryer 5.505 lëndë të vjetra, në fund të vitit kanë mbetur 2.648 lëndë të vjetra të pakryera.

Burime njerëzore

Në përputhje me aktin e sistematizimit dhe vendimit nr.02-2114/1 të datës 01.12.2015 të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është konstatuar se në Gjykatën e Apelit Shkup, funksionin e gjyqtarit e realizojnë kryetari dhe 51 gjyqtarë, megjithatë gjykata në vitin raportues, ka funksionuar në përbërje jo të plotë.

Vitin kalendarik 2022, gjykata e ka filluar me 39 gjyqtar, duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Më 01.07.2022 një gjyqtari i është ndërprerë funksioni i gjyqtarit për shkak të plotësimit të kushteve për pension me moshë. Në shtator 2022 një gjyqtar është zgjedhur për anëtar i Këshillit gjyqësor të RMV dhe të njëjtit i pushon funksioni i gjyqtarit në gjykatë. Në tetor 2022 një gjyqtar është zgjedhur për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të RMV, të cilit i pushon funksioni i gjyqtarit në gjykatë. Më 08.11.2022 një gjyqtari i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension me moshë, ndërsa dy gjyqtarëve për të njëjtën bazë më 07.12.2022. Në fund të vitit raportues në Gjykatën e Apelit Shkup ka pasur 33 gjyqtarë.

Gjatë vitit raportues, në gjykatë ka pasur 120 nëpunës gjyqësor. Në vitin raportues në gjykatë janë realizuar 5 punësime të reja prej 5 të miratuarave sipas Planit vjetor për punësim për vitin 2022 dhe për një vend të paplotësuar pune procedura është në rrjedhë, konkursi është shpallur përsëri për shkak që në konkursin e kaluar nuk ka pasur kandidatë të paraqitur.

Sipas Planit vjetor për punësim për vitin 2021, në gjykatë në vitin raportues janë realizuar 2 punësime, ndërsa njëri ka mbetur i përpunuar, për shkak të mos paraqitjes së kandidatëve për atë vend pune.

Sipas marrëveshjes së lidhur për transferim në vitin raportues janë realizuar 2 punësime.

Në vitin raportues në janar dhe shkurt tre punonjësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve për pensionim me moshë. Tre nëpunësve gjyqësor u është ndërprerë punësimi me kërkesë të tyre, një nëpunësi gjyqësor i pushon vendi i punës për shkak të zgjedhjes në funksion publik, dy nëpunës gjyqësor shfrytëzojnë mungesë për shkak të shtatzënisë dhe lindjes, ndërsa një nëpunës gjyqësor ka shfrytëzuar mungesë pa pagesë në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Kapacitet hapësinore

Gjykata e Apelit Shkup është vendosur në ndërtesë personale, që është ndërtuar në vitin 1960. Në vitin raportues si dhe një periudhë bukur të gjatë, kapacitetet hapësinore nuk i përmbushin kushtet për realizimin e punëve nga kompetenca e saj, duke qenë se në të njëjtën ndërtesë funksionojnë edhe institucione tjera që marrin një pjesë të madhe të hapësirës.

Në vitin raportues në gjykatë është zbatuar procedura për shpenzimet e mbeturinave elektronike, mobileve për zyra, në mënyrë që të njëjtat u janë dorëzuar kompanive të licencuara për riciklim dhe asgjësim. Përmes ankandit elektronik dy automjete pronë të gjykatës janë shpenzuar dhe për të njëjtat gjykata ka pranuar shumë totale prej 600 euro, në kundërvlerë të denarit.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në vitin raportues 2022, Gjykata e Apelit Shkup në punë ka pasur 19.726 lëndë, numër të cilin e përbëjnë:

- 6.897 lëndë të bartura si të pakryera nga viti i kaluar,
- 12.736 lëndë të reja të pranuar
- 97 lëndë përsëri në punë
- 4 lëndë gabimisht të evidentuara

Gjatë vitit raportues, nga gjithsej numri i lëndëve në punë, gjykata ka kryer 12.887 lëndë, ndërsa 6.839 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Në vitin raportues Gjykata e Apelit Shkup e ka tejkaluar fluksin, ashtu që nga gjithsej numri i lëndëve në punë në nivel të gjykatës 19.726 lëndëve, janë kryer gjithsej 12.887 lëndë përkatësisht 65,33%.

Gjatë vitit raportues, nga gjithsej numri i lëndëve të kryera dhe numrit të gjyqtarëve që kanë vepruar, konstatohet se gjykata ka vepruar me angazhim të përforcuar dhe **është gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

-në sektorin civil të bëhen përpjekje që të kryhen lëndët që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar dhe fluksi i lëndëve të reja të pranuar,

-në sektorin e kontesteve të punës të bëhen përpjekje të përforcuara që të zvogëlohet kohëzgjatja e procedurës së vendimmarrjes për lëndët ROZH, në të cilin sektor 62,89 % kryhen gati për më shumë se 6 muaj.

-për lëndët për kundërvajtje të merren masa për kryerjen e lëndëve të pakryera, me vëmendje të posaçme për afatin e parashkrimit.

-në lëndët nga sfera e kontesteve tregtare, të bëhen përpjekje për tejkalimin e fluksit dhe të zvogëlohet mbetja edhe krahas vëllimit të ulur dhe fluksit të lëndëve në punë në vitin raportues.

- kryerja e lëndëve të vjetra,

Gjithashtu, është i domosdoshëm plotësimi i numrit të bartësve të funksionit të gjyqtarit, si dhe pajisja e gjykatës me punësime të reja në shërbimin gjyqësor në përputhje me aktin e sistematizimit.

GJYKATA THEMELORE PENALE

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Penale Shkup është Gjykatë Penale me kompetencë të zgjeruar për rajonin e qytetit të Shkupit (Komuna Qendër, Karposh, Gjorçe Petrov, Saraj, Kisella Vodë, Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Çair, Shuto Orizarë, Çuçer Sandevë, Sopsishte, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden dhe Haraçin) dhe gjykatë në të cilën është formuar njësi e specializuar gjyqësore kompetente për gjykim të veprave nga sfera e krimi të organizuar dhe korrupsionit për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata vitin e ka filluar me 13 064 lëndë, ndërsa në punë ka pranuar 111 275 lëndë të reja, dhe me 741 lëndë përsëri në punë dhe 4 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 125 076 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë ka kryer 109 183 lëndë ndërsa të pakryera kanë mbetur 15 893 lëndë.

Duke marrë parasysh fluksin e rritur të lëndëve, si dhe faktin që Gjykata Themelore Penale Shkup, gjatë vitit 2022 ka pasur mungesë të dukshëm të gjyqtarëve (pensionim, pushim lindje, pushim mjekësor), janë kryer gjithsej 109 183 lëndë, që është për 4 436 lëndë të kryera më shumë nga viti i kaluar 2021 kur kjo gjykatë e ka përfunduar me 104 747 lëndë të kryera.

Këto rezultate në punë tregojnë se edhe krahas asaj që Gjykata Themelore Penale Shkup, vitin raportues 2022 nuk e ka përfunduar si gjykatë e përditësuar, megjithatë edhe me mungesë të burimeve njerëzore (gjyqtarë dhe nëpunës gjyqësor) ka rezultate më të mira nga viti i kaluar 2021 kur gjykata është vlerësuar si gjykatë e përditësuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar për 2 674 lëndë (31 lëndë kanë qenë të pakryera dhe me to gjykata e ka filluar vitin), janë kryer 2 556 lëndë ndërsa procedura nuk është kryer për 118 lëndë.

Në vitin raportues 2022, administratori gjyqësor ka vazhduar me punët dhe detyrat punuese të administratës gjyqësore të cilat janë në kompetencë të saj në përputhje me Rregulloren gjyqësore dhe Ligjin për shërbim gjyqësor. Ai vazhdimisht ka bashkëpunuar me kryetarin e gjykatës lidhur me realizimin e punëve të administratës gjyqësore, ndërsa rregullisht i ka mbledhur edhe raportet mujore të punës së bashkëpunëtorëve gjyqësor. Krahas kësaj, është udhëhequr evidentimi i rregullt për pushimet vjetore dhe mungesat e punonjësve, si dhe evidentimi i përkthyesve gjyqësor, ekspertëve gjyqësor, noterëve dhe përmbaruesve të caktuar të rajonit të Gjykatës Themelore Penale Shkup.

Gjykata ka zëdhënësin e saj, i cili e mban Ueb faqen e gjykatës, rregullisht dhe sipas nevojës publikon njoftime për publikun dhe jep përgjigje për mediumet, komunikon me organizata joqeveritare, me përfaqësues të Organizatave ndërkombëtare në vend, dhe ka propozuar edhe realizimin e projekteve për përparimin e transparencës së gjykatës. Gjatë vitit 2022 këshilltari – zëdhënësi ka publikuar 66 njoftime për publikun, përmes postës elektronike u janë dhënë medimeve 138 përgjigje, ndërsa për qytetarët përmes portalit sud.mk janë dhënë gjithsej 81 përgjigje. Krahas kësaj, në ueb faqen e gjykatës janë anonimizuar dhe publikuar gjithsej 2 183 vendime.

Gjykata edhe gjatë vitit 2022 vazhdimisht e ka zbatuar Ligjin për qasje të lirë në informacionet me karakter publik në mënyrë që është obliguar 1-një person zyrtar për ndërmjetësimin me informacionet me karakter publik. Në këtë gjykatë në periudhën raportuese janë paraqitur 40-dyzet kërkesa për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Për 39-tridhjetë e nëntë kërkesa gjykata është përgjigjur në mënyrë pozitive, 1-një kërkesë i është dërguar poseduesit të informacionit, dhe asnjë kërkesë nuk është refuzuar. Kundër vendimeve të gjykatës është deklaruar 1-një ankesë në Komisionin për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik dhe e njëjta është aprovuar dhe është urdhëruar gjykata që të japë informacione shtesë lidhur me kërkesën e ankuesit.

Gjatë vitit 2022, Zyra për marrëdhënie me publikun në afat ligjor ka vepruar mbi shkresa të paraqitura me shkrim, kërkesa, parashtrësia dhe propozime të palëve, qytetarëve, personave juridik dhe organizatave joqeveritare. Gjykata ka vepruar edhe mbi kërkesa të paraqitura për përjashtim të gjyqtarëve. Drejtuar kryetarit të gjykatës gjatë vitit 2022 i janë paraqitur gjithsej 79-shtatëdhjetë e nëntë kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve. Pastaj janë sjellë 19-nëntëmbëdhjetë aktvendime me të cilat kërkesat për përjashtim të gjyqtarëve janë refuzuar, 3-tre aktvendime me të cilat kërkesa për përjashtim është hedhur poshtë dhe 57-pesëdhjetë e shtatë aktvendime me të cilat kërkesat për përjashtim të gjyqtarëve janë aprovuar. Gjatë vitit 2022, 17-shtatëmbëdhjetë kërkesa për përjashtim janë paraqitur nga palët, ndonëse 62-gjashtëdhjetë e dy kërkesa janë paraqitur nga vet gjyqtarët.

Gjykata Themelore Penale Shkup ka bashkëpunuar me sukses edhe me organe shtetërore tjera, institucione dhe gjykata. Sidomos është i rëndësishëm komunikimi i gjykatës me Gjykatën Themelore Civile Shkup, sidomos lidhur me lëndët e përfunduara – të arkivuara që kanë mbetur në arkivat e gjykatave themelore, përkatësisht nuk u janë dorëzuar gjykatave ku lëndët kanë kaluar në kompetencë sipas ndryshimeve të Ligjit për gjykatat nga viti 2007.

Vazhdon edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë të RMV dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV në pjesën e procedimit mbi kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare, ekstradimet dhe procedurat e transferimit të procedurave dhe personave të akuzuar. Gjatë vitit 2022, Gjykatën Themelore Penale pas mjeteve të miratuara nga Këshilli i Buxhetit Gjyqësor, është përgatitur Plan vjetor për furnizime publike sipas të cilit janë paraparë që të realizohen 28 procedura për furnizime publike, nga të cilat 5-pesë procedura është paraparë që të realizohen si furnizim publik grupor në përputhje me nenin 24 të LFP (Ligjit për furnizime publike) edhe atë përmes 1-një nga ana e Gjykatës së Apelit të RMV, dhe 4-katër nga Këshilli gjyqësor i RMV, pastaj 5-pesë procedura është paraparë që të realizohen si procedura më të thjeshta të hapura dhe 18-tetëmbëdhjetë procedura është

paraparë që të realizohen si furnizime të vlerës së ulët në përputhje me Ligjin për furnizime publike.

Plani vjetor për furnizimet publike për vitin 2022 është plotësuar dy herë, ashtu që është paraparë që të realizohet edhe një procedurë për furnizim publik si procedurë e hapur. Nga procedurat e planifikuara për furnizime publike janë realizuar 4-katër procedura si furnizime grupore publike, 4-katër procedura më të thjeshta të hapura dhe 13-trembëdhjetë procedura si furnizime të vlerës së ulët, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike, të cilat janë realizuar në formë elektronike me shfrytëzimin e mjeteve nga Sistemi elektronik për furnizime publike.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Puna e Gjykatës Themelore Penale është e organizuar në njësi dhe në sektorë edhe atë: Njësia e specializuar gjyqësore kompetente për gjykim të veprave nga sfera e krimit të organizuar dhe korrupsionit, Sektori penal – persona të moshës madhore, Sektori penal – persona të mitur, Sektori hetues, Sektori i procedurës paraprake, Sektori për kundërvajtje dhe Sektori për realizimin e sanksioneve.

Gjykata Themelore Penale Shkup, në vitin raportues 2022 ka pasur fluks drastik të rritur të lëndëve të pranuar-gjithsej 111.275 lëndë, që është për 13 973 lëndë më shumë në krahasim me vitin 2021 kur janë pranuar 97 302 lëndë. Vëllimi i lëndëve në punë në Gjykatën Themelore Penale gjatë vitit 2022 numëron 125 076 lëndë, nga të cilat 2.468 lëndë në Njësinë për krim të organizuar, 76 lëndë Krim të organizuar-vlerësim i aktit akuzues, 7.683 lëndë në Sektorin penal – persona të moshës madhore, 280 lëndë Vlerësim penal të aktit akuzues, 655 lëndë në Sektorin penal – persona të mitur, 966 lëndë në Sektorin për hetim dhe procedurë paraprake Penale – persona të moshës madhore, 95 lëndë – Përgjimi i autorizuar i komunikimeve, 596 lëndë në Sektorin për hetim dhe procedurë paraprake – Krim i organizuar, 27.417 lëndë në Sektorin për kundërvajtje, 31.289 lëndë në Sektorin për ekzekutimin e sanksioneve, 50.728 lëndë në Njësinë për evidencën penale, dënuese dhe për kundërvajtje, si dhe 148 lëndë për Kërkesa dhe 2.674 lëndë – Administratë gjyqësore.

Gjendja me punën e lëndëve është si vijon:

Njësia e specializuar për krim të organizuar dhe korrupsion

Në Njësinë për krim të organizuar dhe korrupsion numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera nga viti 2021 ka qenë 149 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar 237 lëndë ose gjithsej në punë në vitin 2022 ka pasur 386 lëndë. Janë kryer gjithsej 247 lëndë, ndërsa kanë mbetur 139 lëndë të pakryera.

Nga gjithsej numri i lëndëve KOK të kryera gjatë vitit 2022, 247 lëndëve, 231 lëndë janë kryer me aktgjykim, 6 lëndë janë kryer me aktvendim dhe 8 lëndë në tjetër mënyrë.

Në periudhën raportuese nga gjithsej numri i 247 lëndëve të kryera, të ankuara janë 99 lëndë ose 40,08%, nga të cilat 60 janë të konfirmuara ose 24.29%, 24 lëndë janë të abroguara ose 9,72%, ndërsa të ndryshuara janë 15 lëndë ose 6.07%.

Në këshillin penal të Njesisë për krim të organizuar dhe korrupsion gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 2.082 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 76 lëndë.

Në periudhën raportuese nga gjithsej numri i 2006 lëndëve të kryera, të ankuara janë 219 lëndë ose 10,92%, nga të cilat 192 lëndë janë të konfirmuara ose 9.57%, 6 lëndë janë të abroguara ose 0,30%, ndërsa të ndryshuara janë 21 lëndë ose 1.05%.

Gjithsej numrit të 2253 lëndëve në vitin 2022 në këtë Njësi përqindja e numrit të abroguara shënon 1.33%, që duke e marrë parasysh statistikën e këtyllë të vendimeve të kësaj gjykate në 98.675% janë sjellë në mënyrë të rregullt ngase as palët nuk i kanë ankuar as gjykata më e lartë në ato në të cilat i ka vlerësuar të njëjtat i ka konfirmuar, që paraqet cilësi të shkëlqyer të vendimeve të Gjykatës Themelore Penale Shkup.

Penale – persona të moshës madhore

Në Sektorin penal – persona të moshës madhore, në vitin raportues 2022 gjithsej në punë ka pasur 4.310 lëndë penale, nga të cilat 1.535 lëndë janë bartur nga viti i kaluar si të

pakryera, ndërsa 2.775 lëndë janë lëndë të reja. Gjatë vitit 2022 në Sektorin penal persona të moshës madhore janë kryer gjithsej 2.811 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 1.499 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera, 2.811 lëndë, me aktgjykim janë kryer 2.575 lëndë, me aktvendim 220 lëndë dhe 16 lëndë janë kryer në tjetër mënyrë.

Sektorin penal persona të moshës madhore, në vitin raportues 2022 e ka mbajtur cilësinë e lartë të punës, duke u vërejtur nën prizëm të lëndëve të cilat nuk janë ankuar, si dhe nën prizëm të vendimeve të Gjykatës së Apelit Shkup dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga gjithsej 2.811 numri i lëndëve të kryera, gjatë vitit 2022 deri më 31.12.2022 janë ankuar gjithsej 420 lëndë.

Nga gjithsej numri i vendimeve të ankuara 420 në vitin raportues, 48 vendime janë të abroguara, përkatësisht 11,43%, por gjithsej numrit të lëndëve të kryera në këtë Sektor 2.811 të kryera në vitin 2022 përqindja e të abroguarave shënon 1,70%, që duke marrë parasysh statistikën e këtyllë, vendimet e kësaj gjykate në 98,30% janë miratuar në mënyrë të rregullt, ngase as palët nuk i kanë ankuar, ndërsa gjykata më e lartë në ato në të cilat i ka vlerësuar, të njëjtat i ka konfirmuar, që paraqet cilësi të shkëlqyer të vendimeve të Gjykatës Themelore Penale Shkup.

Nga gjithsej numri i 420 – vendimeve të ankuara, gjykata më e lartë ka konfirmuar 330 vendime përkatësisht 78,57%, 42 vendime janë të ndryshuara ose 10,00%. Nga vendimet e ndryshuara, 16 vendime ose 3,81% janë të ndryshuara në aspektin e sanksionit penal sipas Kodit penal, 48 vendime janë të abroguara, përkatësisht 11,43 %.

Këshilli penal – persona të moshës madhore

Në kuadër të Sektorit penal persona të moshës madhore bien edhe vendimet e Këshillit penal nga neni 45 paragrafi 5 të LPP. Në vitin raportues 2022 gjithsej në punë ka pasur 3.373 lëndë penale nga të cilat 188 lëndë janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa 3.185 lëndë janë të reja të pranuar. Gjatë vitit raportues 2022, Këshilli ka kryer gjithsej 3.156 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 217 lëndë.

Gjithsej lëndë të pakryera në fund të vitit 2022 kanë mbetur 217 lëndë, që paraqet 29 lëndë nga gjithsej lëndët e pakryera në fund të vitit 2021 që shënon 188 lëndë.

Cilësia e lëndëve të kryera në Këshillin penal është me përqindje të lartë të së konfirmuarave, përkatësisht nga gjithsej numri lëndëve të kryera - 3.156, janë ankuar 234 vendime ose 7,41%. Nga gjithsej të kryerat në krahasim me të ankuarat e Këshillit penal 5,60% ose 177 lëndë janë të konfirmuara, 0,50% ose 16 lëndë janë të abroguara dhe të ndryshuara janë 1,30% ose 16 lëndë. Sa i përket përqindjes së të ankuarave, 72,84% janë të konfirmuara dhe 6,58% të abroguara dhe 16,87% janë të ndryshuara, që do të thotë se cilësia e lëndëve të kryera në Këshillin penal është në nivel relativisht të lartë.

Sektorin për persona të moshës së mitur

Në Sektorin për persona të moshës së mitur të Gjykatës Themelore Penale Shkup, në fillim të vitit 2022, janë bartur 78 “KM” lëndë të pakryera nga viti 2021. Në vitin 2022 janë pranuar 130 lëndë, ashtu që gjyqtarët për fëmijë gjatë vitit 2022 kanë vepruar për gjithsej 208 lëndë. Gjatë vitit 2022 gjyqtarët për fëmijë kanë kryer gjithsej 132 lëndë. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 76 “KM” lëndë të pakryera.

Gjatë vitit 2022 janë kthyer nga procedura ankuese 6 KM – lëndë, nga të cilat 4 janë të konfirmuara në tërësi, 1 e ndryshuar-në tërësi dhe 1 e abroguar- në tërësi.

Me formimin e lëndëve “KRM”, Gjyqtarët për fëmijë kryesojnë me Këshillat për fëmijë që vendosin mbi lëndët për ndërprerjen e përmbarimit të masave të shqiptuara edukuese; për ndryshimin e masave të shqiptuara edukuese; për ri vendimmarrjen për nevojën nga përmbarimi i masave të shqiptuara edukuese përmbarimi i të cilës fare nuk ka filluar; për ndërprerjen e masave edukuese nëse për masën edukuese gjykata shqipton dënim me burg ose burgim, ndërsa kryesojnë edhe me Këshillat penale për fëmijë që vendosin mbi lëndët për fshirjen e të dhënave për masat e shqiptuara edukuese dhe dënoi me dënim burgim për të mitur nga evidenca dënuese, ndërsa kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me Ligjin për drejtësi për fëmijë. Në fillim të vitit 2022 janë bartur gjithsej 26 lëndë “KRM” të pakryera nga

viti 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 405 lëndë ashtu që Gjyqtarët për fëmijë gjatë vitit 2022 kanë vepruar për gjithsej 431 lëndë. Gjatë vitit 2022 Gjyqtarët për fëmijë kanë kryer gjithsej 388 lëndë. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur të pakryera 43 “KRM” lëndë. Gjyqtarët për fëmijë kryesojnë me Këshillat penal për fëmijë të cilët në mënyrë të kryqëzuar vendosin për “KSM” lëndët e formuara për ankesat kundër aktvendimeve të gjyqtarëve për fëmijë. Në vitin 2022 janë pranuar gjithsej 16 “KSM” lëndë dhe 2 “UO-KM” lëndë. Gjyqtarët për fëmijë veprojnë edhe për lëndë për kundërvajtje ndaj fëmijëve prej 14 deri më 18 vjet, për veprime që me ligj janë parashikuar si kundërvajtje, sipas Ligjit për drejtësi për fëmijët me zbatimin përshtatës të Ligjit për kundërvajtje, Kodit penal dhe Ligjit për procedurë penale. Në fillim të vitit 2022 janë bartur gjithsej 122 “PRK M” lëndë të pakryera nga viti 2021. Në vitin 2022 janë pranuar gjithsej 521 “PRK M” lëndë, ashtu që Gjyqtarët për fëmijë kanë vepruar për gjithsej 643 lëndë. Në vitin 2022 Gjyqtarët për fëmijë kanë kryer gjithsej 543 “PRK M” lëndë. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur gjithsej 100 “PRK M” lëndë të pakryera. Në fund të vitit 2022 në Sektorin e personave të moshës së mitur nuk ka lëndë të vjetra për kundërvajtje

Sektorin për kundërvajtje

Sektorin për kundërvajtje vitin raportues 2022 e ka filluar me 1110 lëndë të vjetra të pakryera si mbetje nga viti 2021. Në vitin 2022 janë pranuar 722 lëndë të reja ose gjithsej në punë ka pasur 1832 lëndë nga të cilat janë kryer 1518 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 314 lëndë, që në vitin 2023 do të jenë prioritet për kryerjen e lëndëve në këtë sektor. Gjatë vitit 2022 në Sektorin për kundërvajtje janë pranuar gjithsej 19 804 lëndë për kundërvajtje nga të cilat: 16 544 lëndë janë nga sfera e “komunikacioni”, 1 225 lëndë janë nga sfera e “rendit dhe qetësisë publike”, 1 513 lëndë janë nga sfera e “pjesa tjetër” dhe 521 lëndë “lëndë për kundërvajtje për persona të mitur”. Nga mbetja e periudhës së kaluar raportuese, nga gjithsej 7 391 lëndë ky sektor gjatë vitit 2022 ka punuar gjithsej 27 194 lëndë. Gjatë vitit aktual janë kryer gjithsej 16 693 lëndë, ndërsa kanë mbetur 10 501 lëndë të pakryera.

Gjatë vitit 2022 në Këshillin penal – sektorin për kundërvajtje janë pranuar 194 lëndë PRK-POV të reja dhe me mbetjen nga viti 2021 prej 29 lëndëve gjithsej në punë ka pasur 223 lëndë. Gjatë vitit 2022 janë kryer 159 lëndë. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 64 PRK-POV lëndë të pakryera. Nga gjithsej 159 lëndët e kryera janë ankuar 21 lëndë, nga të cilat 20 lëndë kanë qenë të konfirmuara ose në krahësim me lëndët e kryera procedurale 12,58%, ndërsa 1 lëndë e abroguar ose 0.63%. Nuk ka të ndryshuara.

Hetimi dhe procedura paraprake

Sektorin hetues i kësaj gjykate funksionon me dy sektorë edhe atë: sektorin- hetim penal që vepron për lëndë hetuese KI dhe OID sipas LPP të vjetër dhe sektorin penal i procedurës paraprake që vepron për lëndë KPP dhe KNZD (dhe UOSK), sipas LPP të ri.

Në vitin raportues 2022 Sektorin hetues punën e tij e ka filluar me 2 lëndë hetuese “KI” të pakryera, që gjithsej në punë në vitin 2022 ka pasur 2 lëndë “KI”, nga të cilat gjatë vitit 2022 nuk ka lëndë KI të kryera. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 2 lëndë “KI” të pakryera.

Procedura paraprake – persona të moshës madhore

Sektorin i procedurës paraprake përbëhet nga një sektor të procedurës paraprake – penale të moshës madhore dhe një sektor të procedurës paraprake në njësinë për krim të organizuar dhe korrupsion.

Sektorin i procedurës paraprake – penale të moshës madhore

Në vitin raportues 2022 ky sektor punën e tij e ka filluar me 2 lëndë KPP të pakryera nga vitet e kaluara, ndërsa janë pranuar 950 lëndë të reja ose gjithsej në punë ka pasur 952 lëndë, nga të cilat janë kryer 934 lëndë, ndërsa në fund të vitit 2022 kanë mbetur 18 lëndë “KPP” të pakryera. Në këtë sektor në fund të vitit 2021 ka pasur 2 lëndë të pakryera ashtu që në vitin 2022 janë evidentuar 10 lëndë të reja “KNZD”, që do të thotë se gjithsej në punë ka pasur 12 lëndë, nga të cilat 5 janë të kryera, ndërsa kanë mbetur 7 lëndë të pakryera.

Në Sektorin e procedurës paraprake në vitin raportues 2022 ndaj 162 personave është përcaktuar masë paraburgimi. Për 36 persona është përcaktuar masë paraburgim shtëpiak, për 23 persona janë përcaktuar masë kujdesi. Gjithashtu, për 21 persona janë

paraqitur propozime për burgim për ekstradim dhe të njëjtëve u është përcaktuar burgim për ekstradim.

Në gjykatë janë pranuar 41 propozim-marrëveshje dhe të njëjtat janë kryer gjatë vitit raportues 2022. Në këtë sektor vepohet edhe me Masa të veçanta hetuese (PIM), të cilat evidentohen në Regjistër të posaçëm përgjimin e komunikimeve me autorizim "UOSK". Në vitin raportues 2022 janë evidentuar 75 lëndë UOSK, dhe me mbetjen nga viti 2021 të 20 lëndëve gjithsej në punë ka pasur 95 lëndë dhe të njëjtat janë kryer gjatë vitit 2022.

Sektori i procedurës paraprake në njësinë për krim të organizuar dhe korrupsion

Gjatë vitit 2022 janë pranuar 572 KOK-PP lëndë dhe mbetja nga viti 2021 prej 15 lëndëve ose gjithsej në punë gjatë vitit 2022 ka pasur 587 KOK-PP lëndë. Nga gjithsej numri i 575 lëndëve të kryera KOK-PP, ndërsa kanë mbetur të pakryera 12 lëndë KOK-PP. Gjithashtu janë evidentuar 7 lëndë të reja OKNZD, ndërsa mbetja prej vitit 2021- 2 lëndë gjithsej në punë në këtë sektor ka pasur 9 lëndë OKNZD dhe të njëjtat janë të kryera gjatë vitit 2022.

Nga lëndët e pranura KOK- PP, 44 lëndë kanë të bëjnë me "Propozim-marrëveshje", në mënyrë që gjatë vitit raportues 2022 janë kryer 42 "Propozim-marrëveshje" ndërsa kanë mbetur të pakryera 2 lëndë.

Gjithashtu, nga lëndët K-PP të pranura 64 lëndë janë pranuar si Kërkesë për masa hetuese të veçanta, ndërsa mbetja prej 6 lëndëve nga viti 2021 gjithsej 70 lëndë. Janë kryer 64 lëndë, ndërsa kanë mbetur 6 lëndë të pakryera.

Në sektorin e procedurës për krim të organizuar dhe korrupsion, në vitin raportues 2022 ndaj 188 personave është përcaktuar masë paraburgimi, për 6 persona është përcaktuar masë Paraburgim shtëpiak. Për 6 persona janë përcaktuar masë paraburgim kujdesi. Gjithashtu, për 9 persona janë paraqitur – Propozime për përcaktimin e paraburgimit për ekstradim dhe të njëjtëve u është përcaktuar paraburgim për ekstradim.

Përmbartimi i sanksioneve

Periodhën raportuese ky sektor e ka filluar me gjithsej numrin prej 3.080 lëndëve të pakryera nga viti i kaluar 2021. Në vitin 2022 janë pranuar gjithsej 28.209 lëndë, ashtu që në punë ka pasur gjithsej 31.289 lëndë. Prej tyre gjithsej të kryera janë 28.330 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera gjithsej 2.959 lëndë.

Siç edhe është treguar ajo edhe në raportet e viteve të kaluara dhe në vitin 2022 raportues, problemi me mospasjen e evidencës për pagimin me kohë të gjobave dhe dënimeve penale në para, si dhe shpenzimet e procedurave nga personat e akuzuar, për të cilët nuk ekziston detyrim ligjor për dorëzimin e provave në gjykatë, edhe më tej krijohet ngarkesë për punë shtesë për shkak të faktit që dënimet në para, gjobat dhe shpenzimet e procedurave, nga personat e akuzuar janë paguar para fillimit të procedurës për pagesën e detyrueshme të së njëjtëve. Gjithashtu kur pagesa e detyrueshme ka filluar nga Drejtoria e të ardhurave publike, gjykata nuk ka marrë njoftim rifillimin e kësaj procedure, dhe ka ndodhur që gjykata të qaset ndaj zëvendësimit të dënimit në para me dënim me burg pas tërheqjes paraprake të pagesës së detyrueshme, ndërsa palët me marrjen e aktit udhëzues të njoftojnë gjykatën se është në rrjedhë procedura për pagesën e detyrueshme, dhe lëndët e evidentuara ku dënimi me para është zëvendësuar me burgim e presim përmbartimin e pagesës së detyrueshme.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në vitin 2022, gjithsej në punë ka pasur 2 427 lëndë të vjetra. Nga ato lëndë, janë kryer 1 831 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 596 lëndë.

Burime njerëzore

Gjykata vitin e kaluar e ka përfunduar me 48 gjyqtarë. Tre gjyqtarëve prej të paraparëve me sistematizim u është pushuar funksioni i gjyqtarit, dy janë deleguar në gjykatë tjetër, ndërsa një në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit 2022, 3 gjyqtarëve u është ndërprerë funksioni për shkak të plotësimit të kushteve për pension me moshë, 3 gjyqtarë janë shkarkuar me vendim të Këshillit gjyqësor, 1 gjyqtar ka

munguar një kohë të gjatë për shkaqe shëndetësore ndërsa 1 gjyqtare ka shfrytëzuar pushim të lindjes.

Në gjykatë gjithsej punojnë 257 nëpunës gjyqësor si dhe 14 punonjës të cilët kanë status të nëpunësve gjyqësor ndërsa kryejnë punë ndihmëse dhe teknike dhe gjithsej 19 pjesëtarë të policisë gjyqësore. 2 nëpunësve gjyqësor u pushon marrëdhënia e punës. Të punësuar janë edhe 25 nëpunës gjyqësor me marrëdhënie në kohë të caktuar. Krahas kësaj, në vitin raportues me shpalljen e realizuar publike janë punësuar edhe 5 nëpunës gjyqësor në kohë të pacaktuar. Gjatë vitit 2021, punësimi u është ndërprerë 9 nëpunësve gjyqësor. Punësimi u është ndërprerë 21 nëpunësve gjyqësor. Edhe 2 personave që nuk kanë status të nëpunësve gjyqësor.

Edhe pse me aktin për sistematizim të vendeve të punës janë paraparë edhe vende pune për nëpunës udhëheqës gjyqësor, Gjykata Themelore Penale, përveç një udhëheqës të sektorit dhe dy udhëheqës të njësisë, nuk ka nëpunës udhëheqës gjyqësor tjerë. Numrit të madh të punësuarve, mungesa e nëpunësve udhëheqës gjyqësor krijon vështirësi në punën e gjykatës. Krahas kësaj mungojnë edhe nëpunës ndihmës profesional si dhe daktilografistë-procesmbajtës.

Kapacitetet hapësinore

Kapacitetet hapësinore me shpërnguljen e ndërtesës së re gjyqësore janë të kënaqshme. Pajisja informatike përtërihet, është furnizuar dhe është instaluar në ndërtesën e re, por ajo është gjendje që çdoherë duhet të përmirësohet.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPZIM MASA

Gjykata Themelore Penale Shkup, si në vitin e kaluar edhe në vitin 2022, ka treguar cilësi të lartë të punës por nuk ka arritur të arrijë në përditësim dhe **nuk është gjykatë e përditësuar**.

Të dhënat statistikore lidhur me cilësinë e punës tregojnë se kjo gjykatë dallohet me përqindje të lartë të vendimeve të pa ankuara, dhe me vendimet e ankuara dhe të konfirmuara nga gjykatat më të larta. Këto tregues tregojnë se bëhet fjalë për gjykatë me rezultate cilësore të punës. Sipas rëndësisë dhe sipas kuantitetit të lëndëve Gjykata Themelore Penale Shkup, me siguri është një nga gjykatat më të ngarkuara dhe nën vëzhgimin e vazhdueshëm të publikut dhe duhet që në të ardhmen të vazhdojë me punë të përditësuar dhe cilësore. Duke marrë parasysh fluksin e rritur të lëndëve, si dhe faktin që Gjykata Themelore Penale Shkup gjatë vitit 2022 ka pasur mungesë të gjyqtarëve (pensionim, pushim mjekësor, pushim lindje), janë kryer gjithsej 109 183 lëndë, që është më shumë se vitin e kaluar 2021 për 4 436 lëndë të kryera kur kjo gjykatë e ka përfunduar me 104 747 lëndë të kryera.

Kushtet hapësinore janë në nivel relativisht të kënaqshëm. Sa i përket gjendjes me pajisjen informatike, është i domosdoshëm përmirësimi i sistemit. Në periudhën që vijon duhet gjykata të përforcohet me kuadro me nëpunës udhëheqës gjyqësor dhe me ndihmës nëpunës profesional siç janë daktilografistë-procesmbajtës.

GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP

Puna e lëndëve në nivel të gjykatës

- Nga viti i kaluar 2021, në Gjykatën Themelore Civile Shkup kanë mbetur 15191 lëndë të pakryera.

- Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Themelore Civile Shkup janë formuar dhe pranuar në punë 42141 lëndë të reja, nga të cilat (40801 të reja, 1340 lëndë të evidentuara përsëri, ndërsa 57 lëndë kanë qenë gabimisht të evidentuara).

- Gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 57281 lëndë.

- Gjatë vitit 2022, janë kryer gjithsej 39291 lëndë.

- Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore Civile Shkup, nuk e ka tejkalluar fluksin, ndërsa mbetja është rritur për 2799 lëndë.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Nga lëndët e ankuara dhe të cilat janë kthyer gjatë vitit raportues: të konfirmuara janë 4668 përkatësisht 16,57%, të ndryshuara janë 247, përkatësisht 0.88%, të abroguara janë 776 përkatësisht 2.75%, 194 të abroguara pjesërisht përkatësisht 0.69%, krahasuar me vitin e kaluar raportues nuk ka përmirësim të cilësisë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit raportues në gjykatë gjithsej në punë ka pasur 5154 lëndë me status të lëndëve të vjetra, nga të cilat 2515 nga viti i kaluar në mënyrë që kanë mbetur të pakryera, ndërsa janë kryer 2428 lëndë, kanë mbetur të pakryera 2728 lëndë.

Sa i përket lëndëve të vjetra, nuk është tejkalluar fluksi dhe është rritur mbetja e lëndëve të vjetra.

Konstatime të shkurta për burimet njerëzore

Gjatë vitit 2022 gjykata kompetencat e saj i ka realizuar me një numër të vogël të nëpunësve gjyqësor prej 581 të përcaktuarit sipas sistematizimit, janë plotësuar 249.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Civile Shkup nuk ka mundësi hapësinore për marrjen e arkivit të noterit, gjithashtu ka nevojë për IT pajisje kompjuterike dhe monitorë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA:

Gjykata Themelore Civile Shkup gjatë vitit 2022 nuk e ka tejkalluar fluksin e lëndëve dhe është rritur mbetja e lëndëve dhe **nuk është gjykatë e përditësuar**, si masa të cilat i propozoj për tejkalimin e dobësive janë: punësim të nëpunësve gjyqësor, gjetja e hapësirës për arkivin, IT pajisje.

GJYKATA THEMELORE VELES

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Nga viti i kaluar 2021, në Gjykatën Themelore Veles kanë mbetur gjithsej 2.730 lëndë të pakryera. Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore Veles ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë mbetjen e lëndëve të pakryera për 109 lëndë, ngaqë në vitin 2022 në punë ka pasur gjithsej 27.149 lëndë, nga të cilat 24.432 janë të kryera, ndërsa 2.621 janë lëndë të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Nga viti i kaluar janë 7 lëndë të pakryera.

Numri gjithsej i lëndëve në punë në vitin 2022 është 1.031, nga të cilat 1.027 janë lëndë të kryera, ndërsa 4 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Gjatë vitit 2022, janë kryer 6.658 lëndë. Prej tyre 504 lëndë janë të konfirmuara, përkatësisht 7,6%, të abroguara janë 106 lëndë përkatësisht 1.6% dhe të ndryshuara janë 130 lëndë përkatësisht 2%.

Puna e lëndëve në nivel të sektorit

Spektori penal

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 1.947 lëndë.

Numri gjithsej i lëndëve në punë në vitin 2022, është 21,220, nga të cilat 19.479 janë lëndë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 1.741 lëndë dhe në nivel të sektorit penal ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë mbetjen e lëndëve të pakryera për 206 lëndë.

Spektori civil

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 783 lëndë.

Numri gjithsej i lëndëve në punë në vitin 2022 është 5.929, nga të cilat 5.049 janë të kryera, ndërsa kanë mbetur 880 lëndë të pakryera dhe në nivel të sektorit civil nuk ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe është rritur mbetja e lëndëve të pakryera për 80 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të sektorit

Spektori penal

Prej 4.645 lëndët e kryera, 282 lëndë përkatësisht 6.1% janë të konfirmuara, 84 lëndë përkatësisht 1,8% janë të abroguara dhe 68 lëndë, përkatësisht 1,5% janë të ndryshuara.

Sektori civil

Prej 1.111 lëndët e kryera gjatë vitit raportues, 190 lëndë, përkatësisht 17,1% janë të konfirmuara, 43 lëndë përkatësisht 3,9% janë të abroguara, ndërsa 16 lëndë përkatësisht 1,4% janë të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën Themelore Veles, gjendja me lëndët e vjetra është si vijon: gjithsej lëndë të vjetra janë 380 nga të cilat 240 lëndë për të cilat ka vepruar gjykata dhe 140 lëndë për trashëgimi për të cilat kanë vepruar noterët, nga të cilat 210 kanë mbetur nga viti i kaluar 2021, janë pranuar 170, janë kryer 169 lëndë për të cilat ka vepruar gjykata dhe 52 lëndë për trashëgimi për të cilat kanë vepruar noterët, ndërsa të pakryera kanë mbetur 159 lëndë, nga të cilat 71 lëndë për të cilat ka vepruar gjykata dhe 88 lëndë për trashëgimi për të cilat kanë vepruar noterët.

Gjatë vitit 2022 gjykata ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë mbetjen e lëndëve të vjetra të pakryera të lëndët për trashëgimi për 46 dhe gjithashtu fluksi i lëndëve të vjetra të lëndët për trashëgimi për të cilat kanë vepruar noterët si të autorizuar të gjykatës është tejkaluar dhe është zvogëluar mbetja për 5 lëndë të vjetra të pakryera.

Konstatime të shkurta për burimet njerëzore

Me vendim të Këshillit gjyqësor të RMV nga 26.11.2015, është përcaktuar që funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Themelore Veles ta realizojnë 18 gjyqtarë. Gjatë vitit 2022 janë plotësuar 16 vende pune duke përfshirë edhe vendin e Kryetarit të gjykatës. Me vendim të Këshillit gjyqësor të RMV gjatë tërë vitit 2022 një gjyqtar është deleguar në Gjykatën Themelore Kavadar dhe një gjyqtar është deleguar në Gjykatën Themelore Negotinë, ndërsa nga 13.12.2022 një gjyqtar është larguar përkohësisht nga realizimi i funksionit të gjyqtarit. Lidhur me burimet njerëzore në përputhje me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës, janë paraparë gjithsej 116, ndërsa deri më 31.12.2021, janë plotësuar 47 vende të punës.

Me planin vjetor për punësim për vitin 2022 janë miratuar mjete për 3 punësime të nëpunësve gjyqësor dhe punësimin e 4 nëpunësve gjyqësor në kohë të caktuar.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa në të cilën punon gjykata është e rinovuar dhe është në gjendje të mirë. Të gjitha hapësirat janë pajisur me mobile dhe pajisje të klimës, janë rinovuar edhe arkivat në të cilat janë vendosur dollapë prej metali.

Seancat dhe gjykimet mbahen në 8 salla gjykimi të pajisura.

Pajisja informatike me të cilën disponon gjykata i përmbush nevojat e gjykatës dhe mundëson zbatimin e tërësishëm të Rregullores gjyqësore sa i përket skanimit të parashtresave dhe formimit të dosjes elektronike të lëndës.

Të gjithë gjyqtarët dhe nëpunësit profesional gjyqësor dhe një pjesë e nëpunësve gjyqësor kanë qasje në internet.

Evidenca e tërësishme dhe të gjitha raportet udhëhiqet dhe krijohet kryesisht përmes AKMIS sistemit.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të së dhënave të theksuara rezulton se Gjykata Themelore Veles në vitin aktual 2022 ka qenë e përditësuar, ngase nuk ka arritur të tejkalojë fluksin për 109 lëndë. Në fillim të vitit 2022, kanë mbetur të pakryera 2.730 lëndë, ndërsa gjithsej në punë kanë qenë 27.149 lëndë, nga të cilat të kryera janë 24.432 lëndë, përderisa 2.621 udhëhiqen si të pakryera, dhe rezulton se Gjykata Themelore Veles gjatë vitit aktual 2022 **është gjykatë e përditësuar**, ngase ka arritur të tejkalojë fluksin dhe të zvogëlojë mbetjen e lëndëve të pakryera për 109 lëndë.

Propozim masa:

- Të mbahet vazhdimisht dinamika e punës ngase është zvogëluar edhe mbetja e lëndëve të vjetra të pakryera.

- Të merren masa për sigurimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe plotësimin e vendeve tjera të punës.
- të shihet mundësia për ri pajisje teknike.

GJYKATA THEMELORE GJEVGJELI

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 468 lëndë. Në punë ka pranuar 11.880 lëndë të reja dhe me 88 lëndë të marra përsëri në punë, gjithsej në punë ka pasur 12.436 lëndë. Prej tyre janë kryer 11.969 lëndë dhe kanë mbetur 467 lëndë të pakryera. Fluksi i lëndëve është tejkualuar dhe mbetja është zvogëluar për 1 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar për 706 lëndë nga të cilat 705 lëndë janë të kryera, ndërsa ka mbetur 1 lëndë e pakryer.

Administrata gjyqësore menaxhohet nga Kryetarja e gjykatës Marica Avramçevska Zafirova.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Gjendja me punën e lëndëve është si vijon:

Sektori penal

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 171 lëndë. Janë pranuar 8.512 lëndë të reja dhe me 54 lëndë të marra përsëri në punë, gjithsej në punë ka pasur 8.737 lëndë. Prej tyre të kryera janë 8.556 lëndë dhe kanë mbetur 181 lëndë të pakryera. Mbetja e lëndëve është rritur për 10 lëndë.

Te ky lloj i lëndëve cilësia është si vijon: Prej 2.182 lëndëve me të drejtë ankese, 28 lëndë ose 1,28% janë të konfirmuara, 13 lëndë ose 0,59% janë të abroguara, 22 lëndë ose 1,01%, janë të ndryshuara. (Përqindja është llogaritur sa i përket gjithsej numrit të lëndëve të kryera).

Sektori civil

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 297 lëndëve. Janë pranuar 2.662 lëndë të reja dhe me 34 lëndë të marra përsëri në punë, gjithsej në punë ka pasur 2.993 lëndë. Mbetja e lëndëve është zvogëluar për 12 lëndë.

Te ky lloj i lëndëve cilësia është si vijon: Prej 700 lëndëve me të drejtë ankese, 158 lëndë ose 22,57% janë të konfirmuara, 18 lëndë ose 2,57% janë të abroguara dhe 2 lëndë ose 0,29% janë të ndryshuara. (Përqindja është llogaritur sa i përket gjithsej numrit të lëndëve të kryera).

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2022, Gjykata Themelore Gjevgjeli ka pasur 24 lëndë të vjetra prej 2 vitesh në punë. Në fund të vitit 2022 në punë kanë mbetur 17 lëndë të vjetra, që do të thotë se numri është zvogëluar për 7 lëndë.

Konstatime të shkurta për burimet njerëzore

Në vitin raportues ka pasur një numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve dhe administratës dhe në raportin nuk tregohet mangësi. Sipas sistematizimit në Gjykatën Themelore Gjevgjeli janë paraparë 13 gjyqtarë. Në vitin 2022 funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar 8 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e gjykatës. Në shërbimin gjyqësor janë paraparë 129 vende pune, ndërsa janë plotësuar 46 vende pune.

Kapacitetet hapësinore

Në Gjykatën Themelore Gjevgjeli ekzistojnë kushte të mira për punën e gjyqtarëve dhe punonjësve në gjykatës. Ndërtesa e gjykatës është funksionare dhe i përmbush nevojat e gjykatës, por nevojitet rikonstruktimi i çatisë që është çati e drejtë, një pjesë e mbuluar me llamarinë, një pjesë me bitum që rrjedh. Gjendja me pajisjen informatike i përmbush nevojat

e gjykatës. Gjykata disponon me një numër të konsiderueshëm të pajisjes kompjuterike, ka qasje në internet, funksionon dorëzimi elektronik.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Për punën e gjykatës mund të përfundohet si vijon:

Nga aspekti i punës së lëndëve Gjykata Themelore Gjevgjeli është **gjykatë e përditësuar**, fluksi është tejkaluar, mbetja është zvogëluar për 1 lëndë.

Cilësia e punës dallohet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve të pa ankuara dhe cilësia e punës sa i përket gjithsej lëndëve të kryera.

Kushtet hapësinore dhe gjendja me pajisjen informatike dhe pajisjen e sigurisë është e kënaqshme.

Propozim masa:

-nevojitet rinovimi i çatisë së ndërtesës dhe infrastruktura.

-Duhet të vazhdohet me punën cilësore.

GJYKATA THEMELORE KAVADAR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në fillim të vitit raportues ka pasur 889 lëndë të pakryera.

Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Themelore Kavadar janë formuar dhe pranuar në punë 11967 lëndë të reja, nga të cilat 11861 të reja, 106 përsëri të evidentuara, ndërsa 1 lëndë gabimisht e evidentuar.

Gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 12855 lëndë.

Gjatë vitit 2022, gjithsej janë kryer 12211 lëndë.

Gjatë vitit 2022, gjithsej numri i lëndëve të pakryera është 644.

Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore Kavadar edhe krahas fluksit të rritur të lëndëve ka arritur të tejkalojë fluksin, ndërsa të zvogëlojë mbetjen për 128 lëndë, dhe është gjykatë e përditësuar.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Prej 12211 lëndëve të kryera, ndërsa nga lëndët e ankuara dhe të cilat janë kthyer gjatë vitit raportues: të konfirmuara janë 357 përkatësisht 2.92%, të ndryshuara janë 15 përkatësisht 0.18% , të abroguara janë 32 përkatësisht 0.38%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit raportues në gjykatë ka pasur në punë gjithsej 244 lëndë me status të lëndëve të vjetra, prej të cilave prej 141 lëndëve nga viti i kaluar kanë mbetur të pakryera, ndërsa 103 janë pranuar gjatë vitit 2020, ndërsa janë kryer 114 lëndë, kanë mbetur të pakryera 130 lëndë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kavadar gjatë vitit 2022 e ka tejkaluar fluksin e lëndëve, mbetjen e ka zvogëluar dhe konsiderohet për **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

Zgjedhja e gjyqtarëve,

Punësimi i nëpunësve gjyqësor,

Rinovimi dhe adaptimi i ndërtesës gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE KRATOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Kratovë, nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur të pakryera gjithsej 231 lëndë, ndërsa të reja të pranuar gjatë vitit 2022 kanë qenë 2777 lëndë, 52 lëndë përsëri në punë, nuk ka lëndë gabimisht të evidentuara, ashtu që numri total i lëndëve në punë në vitin 2022 ka qenë 3060 lëndë. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë, gjatë vitit

2022 janë kryer 2831 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 229 lëndë. Duke marrë parasysh të dhënat e theksuara në vitin raportues 2022 Gjykata Themelore Kratovë e ka tejkaluar fluksin dhe ka kryer 92,51% nga gjithsej numri i lëndëve në punë në nivel të gjykatës dhe është absolutisht gjykatë e përditësuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punën e administratës gjyqësore, lëndë të pakryera në fillim të vitit ka qenë 1 lëndë, të reja të pranuar gjatë vitit 2022 kanë qenë 424 lëndë, janë kryer të gjitha lëndët.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej numri i lëndëve të kryera 2831 lëndë, të konfirmuara janë 117 lëndë, përkatësisht 4,13%, të abroguara janë 47 lëndë, përkatësisht 1,66% dhe të ndryshuara janë 24 lëndë, përkatësisht 0,84%.

Puna e Sektorëve dhe cilësia e punës

Në Sektorin civil të Gjykatës Themelore Civile Kratovë, nga viti i kaluar raportues kanë mbetur të pakryera 160 lëndë, të reja të pranuar janë 602 lëndë, 32 lëndë kanë qenë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara nuk ka. Gjatë vitit 2022 në këtë sektor në punë ka pasur gjithsej 794 lëndë, nga të cilat janë kryer 624 lëndë ndërsa kanë mbetur të pakryera 170 lëndë.

Cilësia e lëndës në nivel të Gjykatës Themelore Civile në vitin raportues 2022 është si vijon: nga numri total i 624 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 103 lëndë, përkatësisht 16,50%, të abroguara 29 lëndë, përkatësisht 4,64% dhe të ndryshuara 7 lëndë, përkatësisht 1,12%.

Në Sektorin penal të Gjykatës Themelore Kratovë nga viti i kaluar kanë mbetur të pakryera 70 lëndë, të reja të pranuar kanë qenë 1752 lëndë, 20 lëndë kanë qenë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara nuk ka. Gjatë vitit 2022 në këtë sektor në punë kanë qenë gjithsej 1842 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 1783 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 59 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorit penal në vitin raportues 2022 është si vijon: nga numri total i 1783 lëndëve të kryera, të konfirmuara kanë qenë 14 lëndë, përkatësisht 0,78%, të abroguara 18 lëndë, përkatësisht 1,00% dhe të ndryshuara 17 lëndë, përkatësisht 0,95%.

Në vitin raportues të punës së Gjykatës Themelore Kratovë për vitin 2022 nuk ka të dhëna për lëndë në Sektorin për kundërvajtje.

Gjendja me lëndët e vjetra

Nga numri total i 60 lëndëve të vjetra, të kryera janë 30 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 2 lëndë penale për penale persona të moshës madhore, 1 lëndë kontestimore të vlerës së ulët, 1 lëndë për konteste pune dhe 26 lëndë për trashëgimi.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Kratovë punon në ndërtesën e saj gjyqësore, e cila i përgjigjet dedikimit funksional të kësaj gjykate.

Problem serioz në punën e gjykatës është ngrohja e cila realizohet me nxehje me avull në energji elektrike, që është jo ekonomike, e rrënuar dhe nuk e arrin temperaturën e duhur për punën normale në hapësirat gjyqësore. Për realizimin e kursimit të energjisë elektrike dhe që ngrohja e gjykatës të jetë më efikase duhet që dritaret e vjetra të drurit të gjykatës të zëvendësohen me dritare PVC dhe dyert e vjetra të zëvendësohen me të reja.

Për përmirësimin e kushteve hapësinore në ndërtesën gjyqësore të gjykatës ka angazhuar kompani e cila ka përpunuar projekt konkret për rinovimin e ndërtesës gjyqësore ku janë llogaritur lartësia e mjeteve të nevojshme për realizimin e këtij rikonstruksioni.

Gjithashtu, nevojitet përpunimi i fasadës efikase dhe energjetike me rinovimin e pjesës së hyrjes (parter dhe verandë), duke qenë se fasada e gjykatës është e rrënuar, hyrja e gjykatës – parteri është në gjendje të keqe, pllakat e dyshemesë janë të thyera dhe të pasigurta për lëvizje dhe duhet rinovimi i një pjese të verandës mbi hyrjen.

Për kursimin e energjisë elektrike nevojitet furnizimi i instalimit të shtresave fotovoltaike, si dhe furnizim me 4 klima.

Në Gjykatën Themelore Kratovë, nevojitet furnizimi me ormanë metali arkivor, ngase në aktualet nuk ka më vend për vendosjen e lëndëve të reja.

Është i domosdoshëm furnizimi me mobile për zyra, ngase aktuali është prishur dhe është i vjetër më shumë se 40 vite.

Për nevojat e gjykatës nevojitet furnizimi me automjet. Gjykata disponon me një automjet “Audi 80”, i prodhuar më 1979, i vjetruar me defekte të vazhdueshme, ndërsa shpenzimet për mirëmbajtjen janë shumë të mëdha dhe e njëjta nuk ka llogari të mirëmbahet dhe nuk është e sigurt për udhëtim. Në të nuk ka as ngrohje as klimë.

Teknologjia informatike

Në Njësinë për kontabilitet përdoret ABLMS-sistemi, i cili ka shpesh probleme gjatë përdorimit nga nëpunësit e autorizuar. Është i domosdoshëm përmirësimi i këtij programi në mënyrë që mos të përballen me probleme në punë.

Për incizim me zë të seancave shfrytëzohet sistemi SRS FEMIDA, përkatësisht softueri për menaxhimin me procesverbalet me zë të seancave. Nevojitet një mënyrë për mirëmbajtjen e këtij sistemi ngase i njëjti është instaluar vetëm në një sallë dhe pajisja veç më është vjetruar, një mikrofon nuk funksionon dhe të njëjtin nuk ka kush e zëvendëson me një pajisje adekuate edhe pse ky problem është paraqitur. Nevojitet që të instalohet edhe një sistem për incizim me zë në një sallë tjetër me qëllim që të mund të plotësojë obligimet ligjore për incizim me zë të seancave, në të kundërtën do të paraqitej ndonjë problem për një kohë të shkurtë të këtij lloji në gjykatë.

Gjykata ka nevojë për zëvendësimin e të gjithë kompjuterëve që punojnë me Windows XP me kompjuterë të rinj. Kjo për arsye që programi punon ngadalshëm dhe çdo ditë haset me probleme, UPS sistemet në salla për incizim me zë duhet të përtërihen.

Konstatime për burimet njerëzore

Në Raportin vjetor për punën e Gjykatës Themelore Kratovë për vitin 2022 nuk ka të dhëna për numrin e gjyqtarëve në gjykatë.

Në vitin raportues 2022 në Gjykatë ka pasur gjithsej 15 punonjës nga shërbimi gjyqësor, nga të cilët vetëm nëpunës kanë qenë të punësuar me kohë të pacaktuar. Gjatë vitit 2023 1 nëpunës gjyqësor – dorëzues do të shkon në pension, ashtu që situata me burimet njerëzore në gjykatë është alarmante. Për realizimin pa pengesë të obligimeve të punës në gjykatë duhen punësime të reja në përputhje me Planin vjetor për punësim në Gjykatën Themelore Kratovë. Gjatë vitit raportues nga Këshilli i buxhetit gjyqësor nuk është miratuar asnjë nga 10 punësimet e planifikuara.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në vitin raportues 2022, Gjykata Themelore Kratovë e ka tejkaluar fluksin dhe ka kryer 92,51% nga numri total i lëndëve në punë në nivel të gjykatës dhe **është gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

- Të bëhen përpjekje për kryerjen e lëndëve të pakryera të vjetra;
- Të mundësohen punësime të reja për pajisjen me kuadro të gjykatës në përputhje me Planin vjetor për punësim;
- Të përmirësohet/mbi ndërtohet programi i sistemit – ABS, zëvendësimi i komponentëve të prishura teknike dhe mbi ndërtimi i Sistemit për incizim me zë të seancave në gjykatë dhe
- Përmirësimi i kapaciteteve hapësinore në gjykatë me kursimin e energjisë elektrike në mënyrë që do të zhvillohej puna papengesë në Gjykatën Themelore Kratovë.

GJYKATA THEMELORE KRIVA PALLANKË

LËNDA E PUNËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur 1.031 lëndë të pakryera.

Gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 5.237 lëndë të reja, 100 lëndë janë përsëri në punë dhe 7 lëndë janë gabimisht të evidentuara.

Gjatë vitit 2022, në punë ka pasur gjithsej 6.368 lëndë.

Gjatë vitit 2022, janë kryer gjithsej 5.348 lëndë.

Gjatë vitit 2022, gjithsej numri i lëndëve të pakryera është 1.021.

Gjykata Themelore Kriva Pallankë, gjatë vitit 2022 e ka tejkaluar fluksin e lëndëve dhe ka zvogëluar mbetjen për 11 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjatë vitit 2022, numri i lëndëve të reja të pranuar është 313.

Numri total i lëndëve të kryera në vitin 2022 është 313, ndërsa të pakryera 0.

Administrata gjyqësore menaxhohet nga Kryetarja e Gjykatës Ljubica Cvetanovska – Stojanovska.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Gjendja me punën e lëndëve është si vijon:

Spektori penal

Nga viti i kaluar 2021, në sektorin penal kanë mbetur të pakryera 169 lëndë.

Numri i lëndëve të reja në vitin 2022 është 3.819 lëndë, 42 lëndë janë përsëri në punë dhe 7 lëndë janë gabimisht të evidentuar.

Numri total i lëndëve në punë gjatë vitit 2022 është 4.030 lëndë.

Numri total i lëndëve të kryera gjatë vitit 2022 në sektorin penal është 3.845 lëndë.

Lëndë të pakryera deri në fund të vitit 2022 kanë mbetur 185 lëndë.

Spektori penal i Gjykatës Themelore Kriva Pallankë nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve dhe e ka rritur mbetjen për 16 lëndë.

Cilësia e Spektorit penal

Prej 969 lëndët e ankuara dhe të kryera të cilat janë kthyer gjatë vitit 2022, të konfirmuara janë 421 lëndë ose 4,33%, të abroguara janë 23 lëndë ose 2.37% dhe të ndryshuara janë 29 lëndë ose 2,99%.

Spektori civil

Nga viti i kaluar 2021, në sektorin civil kanë mbetur 862 lëndë të pakryera.

Numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2022 është 1.105 lëndë, 58 lëndë janë përsëri në punë dhe 0 lëndë janë gabimisht të evidentuara.

Numri total i lëndëve në punë gjatë vitit 2022 është 2.025 lëndë.

Numri total i lëndëve të kryera gjatë vitit 2022 në sektorin civil është 1.190 lëndë.

Numri i lëndëve të pakryera deri në fund të vitit 2022 kanë mbetur 835 lëndë.

Spektori civil i Gjykatës Themelore Kriva Pallankë e ka tejkaluar fluksin e lëndëve dhe ka zvogëluar mbetjen për 27 lëndë.

Cilësia e Spektorit civil

Nga 345 lëndët e ankuara dhe të kryera që janë kthyer gjatë vitit 2022, të konfirmuara janë 82 lëndë ose 23,78%, të abroguara janë 18 lëndë ose 5,21% dhe të ndryshuara janë 12 lëndë ose 3,47%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë në punë ka pasur 362 lëndë të vjetra, nga të cilat: 384 janë lëndë trashëgimore (noterë), 1 lëndë jashtë kontestimore, 4 lëndë nga KUIKP (përmbarrim i dënimit), 3 lëndë për kundërvajtje dhe 6 lëndë kontestimore.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë në vitin 2022 kanë punuar gjithsej 6 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e gjykatës, ndërsa në gjysmën tjetër të shtatorit 2022 edhe 4 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e gjykatës. Në këtë gjykatë në vitin 2022 kanë qenë të punësuar 27 nëpunës gjyqësor. Prej më 01.03.2022 është punësuar një udhëheqës i sportelit të kontesteve, ndërsa prej më 01.12.2022 është punësuar një udhëheqës i sportelit për kundërvajtje, 1 referent i lartë gjyqësor – arkëtar, 5 referentë gjyqësor – daktilografistë (nga të cilët 1 është punësuar nga 01.03.2022), 1 referent gjyqësor – realizues i punëve dhe detyrave në sportelin për përmbarrimin e sanksioneve për kundërvajtje, 2 referentë të rinj gjyqësor – dorëzues, 4 pjesëtarë të policisë gjyqësore, nga të cilët 1 pjesëtar është marrë llogaritur nga 27.12.2022 dhe 1 mirëmbajtës higjiene, përderisa të paplotësuara kanë mbetur (udhëheqës i sporteli të jashtë kontestimores, trashëgimore dhe sporteli për përmbarrimin e sanksioneve për kundërvajtje. Në përputhje me Rregulloren e kësaj gjykate për organizimin

dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës, për shërbimin gjyqësor janë paraparë gjithsej 59 vende pune.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa e Gjykatës Themelore Kriva Pallankë është ndërtuar para 50 viteve. E njëjta është pajisur me sistem të saj për ngrohje që nga viti 1998, që është ri konstruktuar në vitin 2003 dhe 2009. Në vitin 2003 është bërë mbi ndërtimi me ndërtimin e edhe një kati – katin e IV dhe ripërtëritja e fasadës. Në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë ekzistojnë kushte të mira të punës për gjyqtarët dhe të punonjësit në gjykatë. Ndërtesa e gjykatës është funksionale dhe i plotëson nevojat e gjykatës, gjendja me pajisjen informatike i plotëson nevojat e gjykatës.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Nga aspekti i punës me lëndët Gjykata Themelore Kriva Pallankë është gjykatë e përditësuar, fluksin e lëndëve e ka tejkaluar, ndërsa mbetjen e ka zvogëluar për 11 lëndë.

Propozim masa:

Duhet të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve dhe vendet e punës për nëpunës gjyqësor.

Sa i përket kapaciteteve hapësinore, të vazhdojë me përmirësimin e të njëjtëve, ngase bëhet fjalë për ndërtesë të vjetër të ndërtuar para 50 viteve.

Duhet të vazhdohet me punë cilësore.

GJYKATA THEMELORE KUMANOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Kumanovë, vitin 2022 e ka filluar me 3.581 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 31.817 lëndë të reja, përsëri në punë kanë qenë 326 lëndë, gabimisht të evidentuara 14 lëndë ose në punë gjithsej ka pasur 35.710 lëndë, nga të cilat janë kryer 32.231, ndërsa të pakryera kanë mbetur 3.479 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkaluar, përkatësisht janë kryer gjithsej 90,25% nga gjithsej numri i lëndëve në vitin 2022. Krahasuar me 2021, janë kryer 0,68% më shumë në vitin 2022.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2022 e ka filluar me mbetje prej 25 lëndëve nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 4.446 lëndë, gjithsej lëndë në punë ka pasur 4.471 lëndë nga të cilat janë kryer 4.449, ndërsa 22 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Cilësia e lëndës në nivel të gjykatës

Nga gjithsej numri total i 9.488 lëndëve, të konfirmuara janë 694 lëndë ose 7,31%. Të abroguara janë 236 ose 2,49%, ndërsa të ndryshuara janë 128 lëndë ose 1,34%.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

SEKTORI PENAL

Spektori penal vitin 2022 e ka filluar me mbetje prej 1.943 të lëndëve të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 25.250 lëndë të reja, përsëri në punë 144 lëndë, gabimisht të evidentuara 7 lëndë, përkatësisht gjithsej në punë kanë qenë 27.330 lëndë, nga të cilat janë kryer 25.634, ndërsa të pakryera kanë mbetur 1.696 lëndë. Fluksi është tejkaluar. Nga gjithsej numri i 7.191 lëndëve, të konfirmuara janë 253 ose 3,52%, të abroguara janë 68 ose 0,94%, ndërsa të ndryshuara janë 83 ose 1,15%.

SEKTORI CIVIL

Spektori civil vitin e ka filluar me 1.638 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 6.567 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 7 lëndë, përsëri në punë 182 lëndë, përkatësisht gjithsej në punë kanë qenë 8.380 lëndë, nga të cilat 6.597 lëndë janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 1.783 lëndë. Fluksi është tejkaluar. Nga gjithsej lëndët e kryera 2.297, të konfirmuara janë 441 ose 19,19%, të abroguara janë 168 ose 7,31% dhe të ndryshuara janë 45 ose 1,95 %.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata në vitin 2022 ka pasur gjithsej 645 lëndë të vjetra të pakryera për të gjitha bazat, nga të cilat 375 janë bartur nga viti i kaluar, të kryera janë 328 lëndë, ndërsa të pakryera janë kanë mbetur 317 lëndë, nga të cilat 160 lëndë janë për trashëgimi që janë dhënë Noterëve – të autorizuar të gjykatës, deri më 31.12.2022. nga të dhënat e theksuara, rezulton se ka zvogëlim të numrit të lëndëve të vjetra të pakryera në krahasim me vitin 2021 nga gjithsej 58 lëndët.

Burimet njerëzore

Gjykata vitin 2022 e ka filluar me 139 punonjës, por më 31.12.2022 gjykata ka pasur gjithsej 134 punonjës nga të cilët 20 janë gjyqtarë së bashku me U.D. kryetar të gjykatës. Në vitin 2022 në Gjykatën Themelore Kumanovë nga Gjykata Themelore Penale është dërguar përkohësisht një gjyqtar të cilit i ka kaluar koha për të cilën është deleguar dhe i njëjti është kthyer në gjykatë. Në vitin 2022 një gjyqtari i është konstatuar ndërprerja e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim me moshë.

Më 01.01.2022 në Gjykatën Themelore Penale janë punësuar 139 persona. Megjithatë më 31.12.2022 në gjykatë ka pasur gjithsej 134 persona të punësuar. Nga ky numër 20 janë gjyqtarë duke përfshirë edhe U.D. të Kryetarit të gjykatës, një administrator gjyqësor, një udhëheqës i Njesisë së informatikës, 8 bashkëpunëtor të gjyqtarëve, 1 bashkëpunëtor përkthyes, 15 bashkëpunëtor të ri gjyqësor, 2 bashkëpunëtor më të ri gjyqësor – përkthyes, 1 bashkëpunëtor i ri për delikte të korporatës, 10 referentë të pavarur gjyqësor, 10 referentë të lartë gjyqësor, 29 referentë gjyqësor – daktilografistë, 19 referentë të ri gjyqësor, 9 pjesëtar të policisë gjyqësore dhe 8 bashkëpunëtor ndihmës dhe teknik.

Në vitin 2022 njërit prej gjyqtarëve i është konstatuar ndërprerja e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pension me moshë. Më 29.12.2022 një gjyqtar nga ana e Këshillit gjyqësor të RMV është zgjedhur si gjyqtar në Gjykatën Themelore Penale Shkup. Në vitin 2022 janë realizuar 4 punësime të reja. Me marrjen e një personi nga Ministria e mbrojtjes të RMV është punësuar një person pjesëtar i policisë gjyqësore.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa në të cilën punon Gjykata Themelore penale Kumanovë është ndërtuar qysh para 60 viteve. Në një afat të mundshëm shumë të shkurtër duhet të bëhet furnizimi me një sistem të automatizuar bashkëkohor kundër zjarri për hapësirën e serverit; nevojitet rikonstruktimi i tërësishëm i instalimit elektrik për mënjanimin e rrezikut nga ngrohja e tij, zjarri dhe ndërprerja e pa pritshme, për shkak të numrit të madh të konsumuesve të energjisë elektrike – kompjuterë, shtypshkronja, serverë, klima dhe të ngjashme. Nevojitet zëvendësimi i tërësishëm i rrjetit lokal të kompjuterëve personal në AKMIS sistemin. Është i domosdoshëm riparimi i tërë sistemit për ngrohje me ujë të ngrohtë me një cilësi dhe kapacitet adekuat. Gjithashtu, nevojitet rikonstruktimi i ndërtesës në përdhese, dhe me atë edhe të një pjese të hapësirave tjera në gjykatë, për vendosjen e një sistemi një sportel në përdhese dhe shpërnguljen e sallave për gjykim nga përdhësja në katet e sipërme. Të gjendet një mënyrë që Avokatura shtetërore e RMV për Kumanovë të dislokohej nga hapësirat e gjykatës. Të sigurohen mjete financiare për vendosjen e fasadës së re efikase energjetike të ndërtesës gjyqësore; nevojitet të sigurohen mjete për rikonstruktimin e tërësishëm të verandës – tendës, që e mbulon hyrjen e ndërtesës gjyqësore. Ka nevojë për sigurimin e mjeteve për angazhimin e arkivit shtetëror, në rregullimin e arkivit gjyqësor edhe atë të kutive të arkivit dhe rafteve metalike.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Kumanovë, gjatë vitit raportues prej gjithsej 35.710 lëndëve, nga të cilat janë kryer 32.231, ndërsa të pakryera kanë mbetur 3.479 lëndë. Fluksi është tejkualuar, përkatësisht janë kryer gjithsej 90,25% nga gjithsej numri i lëndëve në vitin 2022. Nga këtu, rezulton se Gjykata Themelore Penale gjatë vitit 2022 është **gjykatë e përditësuar** dhe e ka tejkualuar fluksin për 414 lëndë dhe ka zvogëluar mbetjen për 102 lëndë. nga analiza e cilësisë së punës në nivel të gjykatës, dhe sidomos të sektorëve, sektorin civil cilësia është zvogëluar, ndërsa në sektorin penal nga të dhënat përcaktohet se cilësia e punës është rritur në nivel të gjykatës në krahasim me vitin 2021.

Propozim masa:

- përpjekje të mëdha për përmirësimin e cilësisë së punës në nivel të gjykatës, dhe sidomos në sektorin civil,
- investimi i kapaciteteve hapësinore të ndërtesës gjyqësore, instalim elektrik, ngrohja me ujë të ngrohtë, sistemi kundër zjarrit dhe
- plotësimi i rregullt i vendeve të sistematizuara të punës.

GJYKATA THEMELORE NEGOTINË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Negotinë vitin 2022 e ka filluar me 980 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Në vitin 2022 janë pranuar 6.743 lëndë të reja, përsëri në punë 42 lëndë, gabimisht të evidentuara 6 lëndë ose në punë ka pasur gjithsej 7.759 lëndë, nga të cilat janë kryer 7.097, ndërsa kanë mbetur të pakryera 662 lëndë. Fluksi është tejkualuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2022 e ka filluar me 7 lëndë të mbetura nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 587 lëndë, gabimisht të evidentuara 0 lëndë, dhe gjithsej në punë ka pasur 594 lëndë, nga të cilat 585 janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 9 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej numri i 174 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 124 ose 71,26%. Të abroguara janë 32 ose 18,39 %, ndërsa të ndryshuara janë 14 ose 8,06 %, pjesërisht të abroguara 1 ose 0,57 %, të hedhura poshtë 3 ose 1,72%.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

SEKTORI PENAL

Spektori penal vitin 2022 e ka filluar me 74 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 2.021 lëndë, përsëri në punë 13 lëndë, gabimisht të evidentuara 0, dhe gjithsej në punë kanë qenë 2.108 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 2.061, ndërsa të pakryera kanë mbetur 47 lëndë. Fluksi është tejkualuar. Prej gjithsej 2.061 lëndëve, të konfirmuara janë 18 ose 60,00 %, të abroguara janë 9 ose 30,00 %, të ndryshuara 2 ose 6,67 dhe të hedhura 1 ose 3,33 %.

LËNDË PËR KUNDËRVAJTJE

Spektori për kundërvajtje vitin 2022 e ka filluar me 572 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 1.383 lëndë të reja. Përsëri në punë 17 lëndë, gabimisht të evidentuara 0, dhe gjithsej në punë kanë qenë 1.972 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 1.765, ndërsa të pakryera kanë mbetur 207 lëndë. Fluksi është tejkualuar. Nga gjithsej 1.765 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 60 ose 68,96 %, të abroguara janë 14 ose 16,09 %, ndërsa të ndryshuara janë 11 ose 12,65 %, pjesërisht të abroguara 1 ose 1,15% dhe të hedhur poshtë 1 ose 1,15%.

SEKTORI CIVIL

Spektori civil vitin 2022 e ka filluar me 104 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 832 lëndë të reja, përsëri në punë kanë qenë 11 lëndë, gabimisht të evidentuara 3, dhe gjithsej në punë ka pasur 944 lëndë, nga të cilat 827 lëndë kanë qenë të kryera ndërsa të pakryera kanë mbetur 117 lëndë. Fluksi nuk është tejkualuar vetëm për 5 lëndë. Prej gjithsej 827 lëndëve, të konfirmuara janë 46 ose 80,71 %, të abroguara 9 ose 15,79 % dhe të hedhura poshtë 1 ose 1,75 %.

LËNDË PËR PËRMBARIMIN E SANKSIONEVE

Ky sektor vitin 2022 e ka filluar me 62 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 1.649 lëndë të reja, përsëri në punë 0, gabimisht të evidentuara 3, dhe gjithsej në punë kanë qenë 1.708 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 1619, ndërsa të pakryera kanë mbetur 89. Fluksi nuk është tejkualuar për 30 lëndë.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata vitin 2022 e ka përfunduar me 60 lëndë të vjetra të pakryera, nga të cilat lëndë gjyqësore janë vetëm 6, ndërsa 54 lëndë të tjera janë lëndë trashëgimore të vjetra të

noterët.

Burime njerëzore

Në vitin 2022 në gjykatë kanë vepruar 5 gjyqtarë, së bashku me kryetarin dhe një gjyqtarë të deleguar përkohësisht. Në gjykatë nuk ka ndarje konkrete për veprimin e gjyqtarëve mbi një materie por një gjyqtar vepron për lëndë penale, një për lëndë për kundërvajtje dhe përmbarim të sanksioneve, ndërsa kryetari dhe dy gjyqtarët tjerë për lëndë civile dhe për kundërvajtje dhe si anëtarë të Këshillit penal. Megjithatë, në mars 2023 një gjyqtar kalon në pension, dhe njëkohësisht i përfundon mandati edhe gjyqtarit të deleguar, dhe është i patjetërsueshëm përsëri delegimi i një gjyqtari nga një gjykatë tjetër, ndërsa në afatgjatë dhe zgjedhja e një gjyqtari të ri, ngase gjykata ka nevojë për 5 gjyqtarë. Në gjykatë ka 20 punonjës në kohë të pacaktuar, dhe 1 në kohë të caktuar, por nuk ka asnjë bashkëpunëtor profesional në kohë të pacaktuar. Gjykata ka urgjentisht nevojë për punësimin e bashkëpunëtorëve gjyqësor dhe të mirëmbajtësi, 1 ekonomi dhe 1 pjesëtar të policisë gjyqësore.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa në të cilën punon Gjykata Themelore Negotinë është krejtësisht në gjendje të mirë dhe sa i përket hapësirës tërësisht i plotëson nevojat e gjykatës, është e pajisur me mobilie të reja dhe është vendosur dysheme druri dhe tualetet janë duke u rinovuar, është ri përtëritur fasada e jashtme dhe gardhi. Duhet të ri përtërihet pajisja për incizim me zë dhe furnizim me pajisje të re për fotokopje, ndërsa është siguruar edhe një server i ri që veç më është në funksion dhe rregullisht instalohen të gjitha përmirësimet dhe versionet e reja të AKMIS sistemit.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë së të dhënave të deklaruara rezulton se Gjykata Themelore Negotinë në vitin 2022 ka qenë **e përditësuar** dhe e ka tejkalluar fluksin.

Propozim masa:

Nga të dhënat e deklaruara rezulton se Gjykata Themelore Negotinë në vitin 2022, ka treguar rezultate cilësore të mira dhe kuantitative.

GJYKATA E APELIT GOSTIVAR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata e Apelit Gostivar vitin 2022 e ka filluar me 663 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 3.654 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 0 lëndë, lëndë përsëri në punë 1 ose në punë ka pasur gjithsej 4.318 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 3.377, ndërsa të pakryera kanë mbetur 941 lëndë. Fluksi nuk është tejkalluar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2022 e ka filluar pa mbetje të lëndëve të pakryera nga viti 2021. Në vitin 2022 janë pranuar 1.669 lëndë, gabimisht të evidentuara 0, dhe gjithsej në punë kanë qenë 1.669 lëndë, nga të cilat të kryera janë të gjitha 1.669 lëndë. Fluksi është tejkalluar.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej numri i 3.377 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 73 ose 2,16%, të abroguara ose 0,47%, ndërsa të ndryshuara janë 3 ose 0,09 %.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Sektori penal

Sektori penal vitin 2022 e ka filluar me 181 lëndë të pakryera nga viti i kaluar 2021. Në vitin 2022 janë pranuar 1.468 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 0, përsëri në punë 1, dhe gjithsej në punë kanë qenë 1.650 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 1.419, ndërsa të pakryera kanë mbetur 231 lëndë. Fluksi nuk është tejkalluar. Nga numri total i 1.419 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 30 ose 2,11%, të abroguara 4 ose 0,28% dhe të

ndryshuara 0.

Sektori civil

Sektori civil vitin 2022 e ka filluar me 482 lëndë të pakryera nga viti i kaluar 2021. Në vitin 2022 janë pranuar 2.186 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 0, lëndë përsëri në punë 0, dhe gjithsej në punë kanë qenë 2.668 lëndë, nga të cilat 1.958 lëndë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 710 lëndë. Fluksi nuk është tejkualar. Nga numri total i 1.958 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 43 ose 7,18 %, të abroguara janë 12 ose 0,61 % dhe të ndryshuara 3 ose 0,15 %.

Gjendja me lëndë të vjetra

Gjykata vitin 2022 e ka filluar me 21 lëndë të vjetra të pakryera dhe 557 lëndë të reja të pranuar ose gjithsej në punë kanë qenë 578, nga të cilat 410 lëndë janë të kryera, ndërsa 168 lëndë kanë mbetur të vjetra të pakryera.

Burime njerëzore

Në vitin 2022, funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar 11 gjyqtarë duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, përkatësisht 5 gjyqtarë më pak nga numri i përcaktuar i gjyqtarëve, ndërsa në vitin 2023, 1 gjyqtarë shkon në pension, dhe nevojitet plotësimi i vendeve të zbrazura të gjyqtarëve. Në gjykatë punojnë 33 nëpunës gjyqësor dhe 3 personel teknik. Gjykata nuk ka administrator gjyqësor, gjatë rrjedhjes së këtij viti 5 punonjësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës, por janë realizuar edhe 5 punësime të reja. Megjithatë që të arrihet efikasiteti maksimal në punë nevojiten punësime të reja dhe plotësimi i vendeve të zbrazura të punës së gjyqtarëve.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata e Apelit Gostivar sa i përket hapësirës është e pajisur mirë, me një numër të mjaftueshëm të zyrave, disponon me teknologji informatike të nivelit të lakmueshëm, por ka nevojë të ndërtimit të liftit, ngase hapësirat e gjykatës janë në katin e 3-të, si dhe rikonstruktimi i sallës së gjyqimit nuk i plotëson krejtësisht nevojat e gjykatës.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave të deklaruara rezulton se Gjykata e Apelit Gostivar gjatë vitit 2022 **nuk ka qenë e përditësuar** dhe nuk e ka tejkualuar fluksin, por ka qenë efikase edhe gjatë vitit aktual janë kryer më shumë lëndë se sa në vitin e kaluar.

Propozim masa:

Në periudhën e kaluar do të duhet ti kushtohet vëmendje të veçantë kryerjes më të shpejtë të lëndëve të vjetra, si dhe tejkualimit të fluksit të lëndëve të reja.

GJYKATA THEMELORE GOSTIVAR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2022 në nivel të gjykatës në punë ka pasur gjithsej 41507 lëndë, nga të cilat janë kryer 34675 lëndë, ndonëse 6832 udhëhiqen si të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjithsej në punë 762 lëndë, janë kryer 670 lëndë, 2 lëndë udhëhiqen si të pakryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

- Sektori civil (sfera)

Gjithsej të kryera janë 1797 lëndë, nga të cilat: 271 përkatësisht 15.08% janë të konfirmuara, 97 përkatësisht 5.40 % të abroguara dhe 10 përkatësisht 0.56% të ndryshuara.

- Sektori penal (sfera)

Janë kryer gjithsej 8688 lëndë, nga të cilat 260 përkatësisht 2.99% të konfirmuara, 76 përkatësisht 0.87 % të abroguara dhe 68 përkatësisht 0.78 % të ndryshuara.

- Cilësia e punës për të gjitha bazat

Janë kryer gjithsej 10485 lëndë nga të cilat: 531 përkatësisht 5,06 % të konfirmuara, të abroguara 173 përkatësisht 1,65%, të ndryshuara 78 përkatësisht 0.74%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjithsej në punë kanë qenë 2065 lëndë të pakryera të vjetra, nga të cilat 701 janë të

kryera, ndërsa mbesin të pakryera 1364 lëndë.

Konstatime të shkurta për burimet njerëzore

Në vitin 2022 gjykata ka pasur 18 gjyqtarë, një gjyqtar është dërguar përkohësisht në Gjykatën Themelore Kërçovë nga nëntori i vitit 2022, 67 të punësuar në shërbimin gjyqësor, 6 të punësuar sipas LMP, 5 polic gjyqësor nga të cilët 4 nëpunës gjyqësor në vitin 2022 kanë shkuar në pension.

Për veprim optimal të shërbimit gjyqësor në Gjykatën Themelore Gostivar në vitin 2022, është dashur të realizohen më shumë punësime, për vendet e zbrazura, gjithsej 29.

Kapacitetet hapësinore

Tregohet për kushte joadekuate të hapësirave. Teknologji e prishur informatike përkatësisht kompjuterëve, printerëve dhe skanerëve. Nevojitet rritja e sigurimit në gjykatë, modernizimi i video mbikëqyrjes dhe pajisja e tri sallave të gjykimit me incizim me zë.

PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Gostivar e ka tejkualuar fluksin dhe konsiderohet si gjykatë e përditësuar.

Propozim masa:

- Të merren masa për plotësimin e vendeve të nevojshme të punës.
- Të shihet mundësia për ri pajisjen teknike të gjykatës.

GJYKATA THEMELORE DIBËR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Dibër, kanë mbetur të pakryera gjithsej 492 lëndë nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore Dibër ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 82 lëndë, ngase në vitin 2022 në punë ka pasur gjithsej 11.335 lëndë, nga të cilat janë kryer 10.926 lëndë, ndërsa të pakryera janë 410 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Lëndë e pakryer nga viti i kaluar është vetëm 1 lëndë.

Në vitin 2022 gjithsej numri i lëndëve në punë është 315 lëndë.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Lëndë të kryera janë 1.010 nga të cilat: 38 përkatësisht 3.66% të konfirmuara, 15 përkatësisht 1.48% të abroguara dhe 3 përkatësisht 0.29% të ndryshuara.

Sektori civil

Në punë ka pasur gjithsej 10.985 lëndë, nga të cilat 10.575 janë të kryera, 410 janë të pakryera.

Cilësia e lëndëve

Lëndë të kryera janë 254, nga të cilat: 22 përkatësisht 8.63% të konfirmuara, 12 përkatësisht 4.72% të abroguara dhe 2 përkatësisht 0.78 % të ndryshuara.

Sektori penal

Në punë ka pasur gjithsej 4.217 lëndë, nga të cilat 4.193 janë të kryera, 24 janë të pakryera.

Cilësia e lëndëve

Janë kryer gjithsej 1.007 lëndë, nga të cilat: 16 përkatësisht 1.58 % të konfirmuara, 3 përkatësisht 0.29% të abroguara dhe 1 përkatësisht 0.29 % të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën Themelore Dibër, gjendja me lëndët e vjetra është si vijon: gjithsej lëndë të vjetra janë 250, nga të cilat 175 lëndë të vjetra të bartura nga viti i kaluar dhe 75 lëndë të vjetra të regjistruara gjatë vitit 2022. Janë kryer 90 lëndë të vjetra ndërsa kanë mbetur të pakryera 160 lëndë të vjetra.

Burime njerëzore

Në periudhën raportuese funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar kryetari i gjykatës dhe tre gjyqtarë, por nga 01.03.2021, ngase kryetari i gjykatës Ilir Iseni është emëruar për zëvendës drejtor i Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publik Shkup, ndërsa vendi i gjyqtarit është lënë në pezullim. Sipas vendimit të Këshillit gjyqësor janë paraparë 5 gjyqtarë së bashku me kryetarin e gjykatës, përderisa sipas Rregullores për organizimim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës janë sistematizuar 18 vende të punës, për të cilat janë paraparë 52 realizues.

Nevojitet që në vitin 2023 të plotësohen vendet e zbrazura të punës edhe atë: 1 Referent i lartë gjyqësor – arkivist, 1 Referent për pranim dhe dërgim të postës dhe 1 realizues i higjienës, 1 bashkëpunëtor profesional dhe 1 bashkëpunëtor interpretues.

Kapacitetet hapësinore

Në këtë gjykatë zbatohet AKMIS sistemi. Një sallë është e pajisur për incizim me zë të seancave dhe e njëjta shfrytëzohet. Sa i përket teknologjisë informatike është në nivel të duhur. Ueb faqja e gjykatës përditësohet rregullisht me të dhënat për punën e gjykatës dhe me të gjitha informacionet e nevojshme për palët nga një Këshilltar i informatikës. Në vitin raportues në ndërtesën e gjykatës është bërë rikonstruktimi i çatisë me furnizim publik të zbatuar paraprakisht. Për punët e realizuara nuk është bërë pranim teknik, pasi që mbikëqyrja ka konstatuar se ka lëshim në punët e bëra nga dokumentacioni i tenderit dhe marrëveshjes për furnizime publike, dhe për ato arsye nuk janë paguar mjetet në para për atë qëllim, në mënyrë që është njoftuar edhe Këshilli i buxhetit gjyqësor i RMV.

PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë së të dhënave të prezantuara rezulton se Gjykata Themelore Dibër gjatë vitit 2022 ka qenë e përditësuar, ngase ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve. Në fillim të vitit 2022, kanë mbetur 492 lëndë të pakryera, ndërsa gjithsej në punë kanë qenë 11.335 lëndë, nga të cilat 10.926 lëndë janë të kryera, ndërsa 410 udhëhiqen si të pakryera, dhe rezulton se Gjykata Themelore Dibër gjatë vitit 2022, ka qenë e përditësuar ngase ka arritur të tejkalojë fluksin dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 82 lëndë.

Propozim masa:

-Të mbahet vazhdimësia përkatësisht dinamika e punës, ngase është zvogëluar fluksi dhe mbetja e lëndëve të pakryera.

- Të merren masa për sigurimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe plotësimi i vendimeve të tjera të nevojshme të punës.

- të shihet mundësia për pajisje teknike.

GJYKATA THEMELORE KËRÇOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Kërçovë, nga viti i kaluar kanë mbetur gjithsej 2.513 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 20.087 lëndë, 286 lëndë janë përsëri të evidentuara, 2 lëndë janë gabimisht të evidentuara ose gjithsej në punë kanë qenë 22.884 lëndë.

Gjatë vitit raportues janë kryer 19.526 lëndë, ndërsa 3.358 lëndë kanë mbetur të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në periudhën raportuese lëndë të administratës gjyqësore ka pasur 1 IZZ lëndë të pakryer, të reja të pranuar janë gjithsej 1.005 lëndë, nga të cilat: në Regjistrin SU (SU; SU-1; SU-2; SU-3; SU-4; SU-5; SU-6 dhe SU-7) janë pranuar 897 lëndë dhe të gjitha janë të kryera, në Regjistrin IZZ janë pranuar 89 lëndë dhe prej gjithsej 90 lëndëve në punë së bashku me 1 lëndë të pakryer në fillim të periudhës raportuese, janë kryer 89 lëndë, ndërsa ka mbetur 1 lëndë e pakryer, në Regjistrin SU-DOV dhe SU-STR-DOV janë pranuar 6 lëndë të reja dhe të gjitha janë kryer dhe në Regjistrin UPP janë pranuar 13 lëndë të reja dhe të gjitha janë kryer.

Ndaj raportit të punës së Gjykatës Themelore Kërçovë, është bashkëlidhur pasqyrë e tabelës për qarkullimin e lëndëve në gjykatë të cilat nuk janë të përfshira me normën orientuese për vitin 2022, sipas të cilëve nga sektori penal, sektori civil dhe nga administrata gjyqësore, kanë mbetur të pakryera 439 lëndë, janë pranuar 9.872 lëndë, përsëri të evidentuara 4 lëndë, dhe prej gjithsej 10.315 lëndëve në punë janë kryer 9.798, ndërsa kanë mbetur të pakryera 517 lëndë.

Gjithashtu është bashkëlidhur një paraqitje tabelore të qarkullimit të lëndëve të cilat përfshihen me normën orientuese për vitin 2022, sipas të cilit nga të gjitha sferat kanë mbetur të pakryera 2.074 lëndë, janë pranuar 10.216 lëndë, të evidentuara përsëri 281 lëndë, gabimisht të evidentuara 2 lëndë dhe nga gjithsej në punë prej 12.569 lëndëve janë kryer 9.728 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 2.841 lëndë.

VËLLIMI I PUNËS SË GJYKATËS

Sa i përket lëndëve të cilat kanë të bëjnë me veprime të caktuara nga procedura paraprake dhe OSK prej gjithsej 91 lëndëve në punë, janë kryer 90 lëndë.

Sa i përket lëndëve penale kundër personave të moshës madhore dhe KOOA prej gjithsej 447 lëndëve në punë, në periudhën raportuese janë kryer 354 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 93 lëndë. Në periudhën raportuese në krahasim me periudhën e kaluar numri i lëndëve penale kundër personave të moshës madhore është rritur për 45 lëndë.

Prej gjithsej 26 lëndëve penale në punë kundër personave të moshës së mitur janë kryer 19 lëndë, ndërsa kanë mbetur 7 lëndë të pakryera.

Sa i përket lëndëve penale të ndryshme ku bëjnë pjesë lutje penale, veprime të ndryshme hetuese dhe lëndë penale për regjistra të ndryshëm prej gjithsej 336 lëndëve në punë, janë kryer 323 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 13 lëndë.

Prej gjithsej 3.113 lëndëve për kundërvajtje në punë, janë kryer 2.654 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 459 lëndë.

Sa i përket lëndëve për përmbarrimin e sanksioneve në periudhën raportuese prej gjithsej 4.444 lëndëve në punë, të kryera janë 4.339 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 105 lëndë.

Në nivel të sektorit penal mund të konstatohet se prej gjithsej 8.457 lëndëve në punë në vitin raportues, janë kryer 7.779 lëndë ose 91,98%, ndërsa kanë mbetur të pakryera 754 lëndë ose 8,91%.

Sa i përket lëndëve nga sfera civile prej gjithsej 4.112 lëndëve në punë, janë kryer 1.949 lëndë, ndërsa kanë mbetur për tu kryer edhe 2.163 lëndë.

Mund të konstatohet se në këtë sektor ka rritje të fluksit të lëndëve nga viti i kaluar.

Sa i përket lëndëve të sferës jashtë procesit prej gjithsej 4.490 lëndëve në punë, të kryera janë 3.974 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 516 lëndë.

CILËSIA E PUNËS SË GJYKATËS

Sipas të dhënave nga Gjykata Themelore Kërçovë prej gjithsej 354 lëndëve penale të kryera kundër personave të moshës madhore dhe KOOA janë ankuar 62 vendime, ndërsa janë kthyer nga gjykata e shkallës së dytë 54 lëndë nga të cilat 33 lëndë janë të konfirmuara, 12 të abroguara, 7 lëndë të ndryshuara dhe për 1 lëndë ankesa është hedhur poshtë.

Nga këto të dhëna rezulton se nga gjykata e shkallës së dytë janë kthyer 53 lëndë, por jo numri i theksuar prej 54 lëndëve.

Prej gjithsej 12 lëndëve të kryera kundër personave të moshës së mitur janë ankuar 4 vendime, ndërsa është kthyer 1 lëndë nga gjykata e shkallës së dytë dhe e njëjta është abroguar.

Prej gjithsej 323 KS lëndëve, janë ankuar 37 vendime, ndërsa janë kthyer nga gjykata e shkallës së dytë 30, nga të cilat të konfirmuara janë 28 lëndë dhe 1 lëndë është ndryshuar.

Prej gjithsej 2.654 lëndëve të kryera për kundërvajtje, janë ankuar 102 lëndë, janë kthyer nga gjykatat e shkallës së dytë 97 lëndë, prej tyre të konfirmuara janë 80 lëndë, të abroguara 10 lëndë, 5 janë të ndryshuara dhe ankesa është hedhur poshtë në 2 lëndë.

Sa i përket të dhënave për lëndët proceduese prej gjithsej 1.675 lëndëve të kryera, të ankuara janë 797 lëndë, ndërsa të kthyer nga gjykata e shkallës së dytë 682 lëndë, nga të

cilat të konfirmuara janë 512 lëndë, të abroguara 89 lëndë, 1 lëndë e ndryshuar dhe pjesërisht të abroguara janë 68 lëndë.

Nga këto të dhëna rezulton se nga gjykata e shkallës së dytë janë kthyer 670 lëndë, dhe jo numri i theksuar 682 lëndë.

Prej gjithsej 274 lëndëve të kryera jashtë procesorë 35 lëndë janë ankimor, ndërsa të kthyer nga gjykata e shkallës së dytë 36 lëndë, nga të cilat 20 të konfirmuara, 1 e ndryshuar, 14 të abroguara dhe 1 lëndë pjesërisht e abroguar.

Prej gjithsej 1.074 lëndëve për trashëgimi në punë, 564 lëndë janë kryer nga noterët.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën Themelore Kërçovë në fund të vitit 2021 kanë mbetur 261 lëndë të pakryera nga të cilat: 23 lëndë pronësore, 54 lëndë të vlerës së vogël, 7 lëndë jashtë kontestimore, 6 lëndë për ndarje fizike, 2 KUIKP, 63 lëndë të kontesteve të punës, 17 lëndë obligative, dhe 89 trashëgimore. Në fillim të periudhës raportuese ka pasur 86 lëndë të vjetra nga viti i kaluar (pa trashëgimore), të reja të pranuar janë 233 lëndë dhe prej gjithsej 319 lëndëve në punë, të kryera janë 147 lëndë, ndërsa kanë mbetur për tu kryer 172 lëndë.

Burime njerëzore

Sa i përket burimeve njerëzore, gjatë vitit raportues kanë punuar 7 gjyqtarë, përfshirë edhe Kryetarin e gjykatës, ndërsa nga muaji nëntor 2022, 8 gjyqtarë, së bashku me një gjyqtar të deleguar për periudhën prej 6 muajsh dhe 45 persona të personelit administrativ.

Në periudhën raportuese 3 persona nga personeli administrativ kanë shkuar në pension. Nga 15 vendet e punës të parapara me sistematizim për personelin administrativ daktilografistë, janë plotësuar 4 vende pune, ndërsa lidhur me kërkesën drejtuar Këshillit të buxhetit gjyqësor për miratim për punësimin e kuadrit të këtyre është realizuar vetëm një punësim, edhe pse janë miratuar dy punësime të reja.

Në periudhën raportuese nga dy vendet e punës të parapara për këshilltar gjyqësor është plotësuar vetëm një vend, ndërsa nga 14 vendet e parapara realizues për vendet e punës bashkëpunëtor profesional janë plotësuar 6 vende, nga 14 vendet e parapara bashkëpunëtor më i ri gjyqësor janë plotësuar 4 vende.

Kapacitetet hapësinore

Sa i përket kushteve të hapësirës për punë në këtë gjykatë, tregohet për nevojën nga vërja e një sistemi sportel, kërkesë kjo që është dërguar në Këshillin e buxhetit gjyqësor prej para ca vitesh, por deri më tani nuk janë miratuar mjete, ndërsa ka nevojë edhe për ndërrimin e mobileve të zyrave në të gjitha hapësirat ngase aktualisht është dëmtuar dhe vjetërsuar. Pesë hapësira nga ndërtesa gjyqësore shfrytëzon Prokuroria Themelore Publike Kërçovë, dhe në qoftë se gjendet zgjidhje për lirim të atyre hapësirave, gjendja me kushtet hapësinore për punën në gjykatë do të përmirësohej.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Nga numri i lëndëve të pranuar së bashku me lëndët përsëri të evidentuara ose gjithsej lëndët e reja të pranuar prej 20.371 dhe numri i lëndëve të kryera prej 19.526 rezulton se Gjykata Themelore Kërçovë nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve për 561 lëndë, përkatësisht e ka rritur numrin e lëndëve të pakryera për 845 lëndë dhe vlerësohet si **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

- Duke marrë parasysh se Gjykata Themelore Kërçovë, me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (Gazeta Zyrtare e RMV numër 96/2019) është caktuar si gjykatë me kompetencë të zgjeruar që kompetencën nga paragrafët 1 dhe 2 nga Ligji për gjykatat, e realizon edhe për rajonin e Gjykatës Themelore Dibër, duke u nisur nga numri total i lëndëve në punë dhe numrit ekzistues të gjyqtarëve, do të duhet që Këshilli gjyqësor të shqyrtojë mundësinë të tejkalojë fluksin e lëndëve të reja.

-Përforcimi i burimeve njerëzore me pajisjen e kuadrit të gjykatës me nëpunës gjyqësor nga të gjitha kategoritë e parapara ligjore;

-Tejkalimi i numrit të lëndëve të vjetra për shkak të numrit të rritur të lëndëve që kanë marrë statusin e lëndëve të vjetra në periudhën raportuese, me angazhim shtesë të

gjqtarëve, duke qenë se më tepër se gjysma e lëndëve me statusin e tillë nuk janë kryer në periudhën raportuese

-Edukimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe punonjësve në gjykatë;

GJYKATA THEMELORE TETOVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 2.381 lëndë, ndërsa ka pranuar 59.448 lëndë të reja. Përsëri në punë janë marrë 385 lëndë, ndërsa gabimisht të evidentuara janë 6 lëndë. Nga këtu, në punë gjithsej kanë qenë 62.208 lëndë, nga të cilat të kryera janë 58.604 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 3.604 lëndë. Fluksi i lëndëve i vitit aktual nuk është tejkualuar. Mbetja është rritur për 1.223 lëndë, ose për 51,78 % sa i përket mbetjes nga viti 2021.

Rritja e numrit të lëndëve të pakryera i nënshtrohet faktit që në vitin 2022 8 gjyqtarëve u është ndërprerë funksioni i gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim me moshë, përderisa 1 gjyqtar është zgjedhur anëtar i Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat adekuat është vepruar për 1.611 lëndë dhe të gjitha janë kryer.

Puna e lëndëve dhe cilësia e punës

Gjendja me punën e lëndëve është si vijon:

Sektor i penal

Nga viti i kaluar kanë mbetur 968 lëndë. Janë pranuar 31.341 lëndë të reja, 213 lëndë janë marrë përsëri në punë, ndërsa 4 lëndë janë evidentuar gabimisht. Gjithsej në punë ka pasur 32.518 lëndë, nga të cilat janë kryer 31.229 lëndë, përderisa të pakryera kanë mbetur 1.289 lëndë. Mbetja e lëndëve është rritur për 321 lëndë ose 33,16%.

Sektor i civil

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.412 lëndë. Janë pranuar 26.459 lëndë të reja, 169 lëndë janë marrë përsëri në punë, ndërsa 2 lëndë janë gabimisht të evidentuara. Gjithsej në punë ka pasur 28.038 lëndë. Janë kryer 25.724 lëndë, përderisa të pakryera kanë mbetur 2.314 lëndë. Numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është rritur për 902 lëndë ose për 63,88%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Raporti i dorëzuar vjetor i punës së Gjykatës Themelore Tetovë në vitin 2022 nuk përfshin të dhëna për gjendjen me lëndët e vjetra.

Burime njerëzore

Gjykata Themelore Tetovë vitin 2022 e ka filluar me 146 punonjës nga të cilët 22 gjyqtarë, 111 nëpunës gjyqësor dhe 12 personel ndihmës-teknik.

Gjatë vitit 2022 për shkak të pensionimit, marrëdhënia e punës u është ndërprerë 8 gjyqtarëve, 1 nëpunësi gjyqësor dhe 2 punonjësve si personel ndihmës – teknik, përderisa njërit prej nëpunësve gjyqësor i është ndërprerë marrëdhënia e punës për arsye tjera.

Gjatë vitit 2022 janë punësuar 3 nëpunës gjyqësor me kohë të pacaktuar, ndërsa përkohësisht janë angazhuar 14 persona. Njëpërmjet shpalljes së brendshme janë avancuar 10 nëpunës gjyqësor.

Nevojitet të punësohet edhe një realizues në Policinë gjyqësore.

Kapacitetet hapësinore

Mirëmbajtja investuese e ndërtesës gjyqësore të Gjykatës Themelore Tetovë është në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo gjykatë, përsëri tregon, se ballafaqohet me problem rreth nxehjes (për arsye të instalimit në tërësi të dëmtuar), si dhe mirëmbajtja e hapësirave të podrumit të cilat nuk janë rinovuar.

Në vitet e kaluara janë bërë disa aktivitete të mëdha investimi, përkatësisht fasada e re, konstruksioni i çatisë dhe të ngjashme, dhe është instaluar edhe një lift. Megjithatë, rrjeti elektrik në gjykatë është vjetruar dhe nuk i përgjigjet nevojave.

Ndërtesën gjyqësore të Gjykatës Themelore Tetovë e shfrytëzojnë edhe Prokuroria Themelore Tetovë, Avokatura e shtetit Tetovë, si dhe Shërbimi provues, në mënyrë që gjykata ballafaqohet me probleme hapësinore dhe financiare.

Në hyrjen e ndërtesës gjyqësore është vendosur një detektor metali dhe rëntgen detektor, që në momentin është jashtë funksionit. Janë vendosur kamera me video mbikëqyrje, ndërsa PP aparatet rregullisht riparohen.

Lëndët në Gjykatë rruhen në rafte të posaçme (metali apo druri), të cilat janë me bravë ose me dry, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e sigurt e lëndëve.

Në Gjykatën Themelore Tetovë gjatë vitit 2021 janë realizuar 10 procedura për furnizime publike.

Sa i përket pajisjes informatike, aktive janë 125 njësi punuese – kompjuterë personal të cilët janë të lidhura me rrjetin dhe kanë qasje në aplikacionet e programeve përkatëse. Njëkohësisht, një pjesë e konsideruar nga pajisja informatike është e vjetër dhe e amortizuar, dhe i nevojitet ndërrimi i tërësishëm i rrjeteve. Pas kësaj, propozimi i IKT njësisë është të bëhet zëvendësimi i printerëve lokal me ato me rrjete. Katër nga gjithsej 8 sallat e gjykimeve disponojnë me pajisje për incizim me zë, të njëjtat janë funksionare dhe në to bëhen incizim audio.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Nga aspekti i punës me lëndët gjykata vlerësohet si **gjykatë e pa përditësuar**. Nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve të reja dhe e ka rritur numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera në fund të vitit. Kjo i nënshtrohet faktit që gjatë vitit 2022, 8 gjyqtarëve u është ndërprerë funksioni i gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim, ndërsa 1 gjyqtar është zgjedhur anëtarë i Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Propozim masa:

Në periudhën e ardhshme duhet të bëhen përpjekje sa i përket çështjes për zgjedhje të gjyqtarëve të rinj dhe plotësimi i vendeve të punës në shërbimin gjyqësor.

Duhet të sigurohen kushte adekuate hapësinore për punë.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet e pajisjes informatike të gjykatës.

Duhet të vazhdohet me punën cilësore.

GJYKATA E APELIT MANASTIR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Nga viti i kaluar 2021, në Gjykatën e Apelit Manastir kanë mbetur të pakryera gjithsej 697 lëndë.

Gjatë vitit 2022, Gjykata e Apelit Manastir ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve të pakryera për 66 lëndë, ngase në vitin 2022 në punë ka pasur gjithsej 5.216 lëndë, nga të cilat të kryera janë 4.585 lëndë, ndërsa të pakryera janë 631 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

4 lëndë janë të pakryera nga viti i kaluar.

Numri total i lëndëve në punë në vitin 2022 është 1.073, nga të cilat të kryera janë 1.072 lëndë, ndërsa e pakryer ka mbetur 1 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Gjatë vitit 2022, janë kryer 4.564 lëndë. Prej tyre të konfirmuara janë 104 lëndë, përkatësisht 2,28%, të abroguara janë 24 lëndë përkatësisht 0,52% dhe të ndryshuara janë 7 lëndë përkatësisht 0.15%.

Puna e lëndëve në nivel të sektorit

Sektori civil

Nga viti i kaluar janë 558 lëndë të pakryera.

Numri total i lëndëve në punë në vitin 2022 është 3.445, nga të cilat të kryera janë 2.934 lëndë ndërsa kanë mbetur të pakryera 511 lëndë dhe në nivel të sektorit civil ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 47 lëndë.

Sektori penal

Nga viti i kaluar janë 139 lëndë.

Numri total i lëndëve në punë në vitin 2022 është 1771, nga të cilat të kryera janë 1.651 ndërsa të pakryera janë 120 lëndë dhe në nivel të sektorit penal ka arritur të tejkalojë fluksin e lëndëve dhe të zvogëlojë numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 19 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të sektorit

Sektori civil

Prej 2.920 lëndëve të kryera gjatë vitit raportues, 172 lëndë, përkatësisht 2,46% janë të konfirmuara, 12 lëndë përkatësisht 0,41% janë të abroguara, ndërsa 7 lëndë përkatësisht 0,23% janë të ndryshuara.

Sektori penal

Prej 1.644 lëndëve të kryera, 32 lëndë përkatësisht 1,94% janë të konfirmuara, 12 lëndë përkatësisht 0,72% janë të abroguara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në Gjykatën e Apelit Manastir, gjendja me lëndët e vjetra është si vijon: gjithsej lëndë të vjetra janë 141 nga të cilat 13 kanë mbetur nga viti i kaluar, janë pranuar 128, janë kryer 141, ndërsa 15 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Burime njerëzore

Gjatë vitit 2022 në Gjykatën e Apelit Manastir nga 25 vendet e parapara për gjyqtarë së bashku me kryetarin e gjykatës, kanë vepruar 16 gjyqtarë, ngase në korrik 2022 një gjyqtar ka shkuar në pension.

Me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, janë paraparë gjithsej 116, ndërsa deri më 31.12.2022, janë plotësuar 47 vende pune.

Me planin vjetor për punësim për vitin 2022 janë miratuar mjete për 3 punësime të nëpunësve gjyqësor, është miratuar avancimi i 4 nëpunësve gjyqësor dhe punësimi i 4 nëpunësve gjyqësor në kohë të caktuar.

Kapacitetet hapësinore

Edhe më tej qëndron nevoja për rinovimin e zyrave gjyqësore, furnizimi me inventar, riparimi i nyjzimit sanitar.

Vitin e kaluar 2022 në ndërtesën ende qëndron e vendosur Prokuroria e Lartë Publike, e cila shfrytëzon një pjesë të hapësirave në katin e dytë.

Ndërtesa në të cilën punon gjykata është rinovuar dhe është në gjendje të mirë. Të gjitha hapësirat janë të pajisura me mobilie dhe pajisje klimatike, janë rinovuar edhe arkivat në të cilat janë vendosur dollapë metali.

Pajisja informatike me të cilën disponon gjykata i plotëson nevojat e gjykatës dhe mundëson zbatimin e tërësishëm të Rregullores gjyqësore sa i përket skanimit të parashtrësive dhe formimit të dosjes elektronike të lëndës.

Të gjithë gjyqtarët dhe nëpunësit profesional gjyqësor dhe një pjesë e nëpunësve gjyqësor kanë qasje në internet.

Evidenca e tërësishme dhe të gjitha raportet udhëhiqen dhe krijohen kryesisht përmes AKMIS sistemit.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë së të dhënave të ekspozuara rezulton se Gjykata e Apelit Manastir në vitin 2022 është **gjykatë e përditësuar**, ngase ka arritur të tejkalojë fluksin për 66 lëndë. Në fillim të vitit 2022, kanë mbetur të pakryera 597 lëndë, ndërsa gjithsej në punë ka pasur 5.216 lëndë, nga të cilat të kryera janë 4585 lëndë, përderisa 631 lëndë udhëhiqen si të pakryera, dhe rezulton që Gjykata e Apelit Manastir gjatë vitit 2022 ka qenë gjykatë e përditësuar

ngase e ka tejkualuar fluksin dhe e ka zvogëluar numrin e lëndëve që kanë mbetur të pakryera për 66 lëndë.

Propozim masa:

- Të mbahet për hershmëria përkatësisht dinamika e punës ngase është zvogëluar fluksi i lëndëve që kanë mbetur të pakryera dhe të lëndëve të vjetra.

- Të merren masa për sigurimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe plotësimi i vendeve tjera të nevojshme të punës.

- Të shihet mundësia për ri pajisje teknike.

GJYKATA THEMELORE MANASTIR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Manastir vitin 2022 e ka filluar me 4.611 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 30.318 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 6 lëndë, 357 lëndë përsëri në punë ose gjithsej në punë ka pasur 35.280 lëndë, nga të cilat 30.169 lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur 5.111 lëndë të pakryera. Fluksi nuk është tejkualuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Administrata gjyqësore vitin 2022, e ka filluar me 15 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 1.709 lëndë të reja, gabimisht të evidentuar 0, dhe gjithsej në punë ka pasur 1.724 lëndë, nga të cilat të kryera janë 1.721 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 3 lëndë. Fluksi është tejkualuar.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Prej gjithsej 30.169 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 833 ose 2,78 %, të abroguara janë 268 ose 0,89 %, ndërsa të ndryshuara janë 114 ose 0,38 %.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

SEKTORI PENAL

Sektori penal vitin 2022 e ka filluar me 2.278 lëndë të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 21.433 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara 3, 169 lëndë përsëri në punë, dhe gjithsej në punë ka pasur 23.877 lëndë, nga të cilat 21.167 janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 2710 lëndë. Fluksi nuk është tejkualuar. Prej gjithsej 21.167 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 368 ose 1,74%, të abroguara 117 ose 0,55% dhe të ndryshuara 49 ose 0,23%.

SEKTORI CIVIL

Sektori civil vitin 2022 e ka filluar me 2.318 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar 2021. Gjatë vitit 2022 janë pranuar 7.176 lëndë, gabimisht të evidentuara 3, 188 lëndë përsëri në punë, dhe gjithsej në punë ka pasur 9.679 lëndë, nga të cilat të kryera kanë qenë 7.281, ndërsa të pakryera kanë mbetur 2.398 lëndë. Fluksi nuk është tejkualuar. Prej gjithsej 7.281 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 470 ose 6,46 %, të abroguara janë 151 ose 2,07% dhe të ndryshuara 65 ose 0,89%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata vitin 2022 e ka filluar me 118 lëndë të pakryera të vjetra dhe 97 lëndë trashëgimore te noterët, ndërsa në fund të vitit 2022 numri i lëndëve të pakryera të vjetra është rritur dhe tani ka 127.

Burime njerëzore

Gjatë vitit 2022 gjykata ka punuar me 75 realizues të punësuar në kohë të pacaktuar, nga të cilët 1 administrator gjyqësor, 1 udhëheqës i njësisë së informatikës, 1 këshilltar i informatikës, kuadër profesional 9, 5 referentë të pavarur, 8 referentë të lartë, 20 referentë gjyqësor, 18 referentë më të ri, 1 vozitës, 1 arkivues, 6 policë, 1 mjeshtër i përgjithshëm, 1 telefonist, 3 mirëmbajtëse të higjienës dhe edhe 23 persona të punësuar në kohë të caktuar të kuadrit të ndryshëm, që pjesërisht i përgjigjet vëllimit të punës së gjykatës. Gjykata ka nevojë për punësimin e realizuesve në kohë të caktuar.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Manastir është e pajisur mirë me hapësira, me numër të mjaftueshëm të zyrave, sallave të gjykimit dhe sporteleve, ndërsa disponon edhe me teknologjinë informatike të nivelit të lakmueshëm, me 60 kompjuterë të rinj, printerë dhe skanerë, por me përmirësimin e AKMIS sistemit paraqitet nevoja për furnizimin me kompjuterë të rinj.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave të ekspozuara rezulton se Gjykata Themelore Manastir gjatë vitit 2022 vlerësohet si **gjykatë e pa përditësuar** dhe nuk e ka tejkeluar fluksin, por ka qenë efikase sepse me një numër të vogël të gjyqtarëve dhe punonjësve ka kryer shumë lëndë nga viti i kaluar 2021.

Propozim masa:

Në periudhën e ardhshme do të duhet t'i kushtohet vëmendje të veçantë kryerjes së lëndëve të vjetra, si dhe tejkalimit të fluksit të lëndëve të reja.

GJYKATA THEMELORE KRUSHEVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2022 në nivel të gjykatës në punë ka pasur gjithsej 2480 lëndë, nga të cilat të kryera janë 2077 lëndë, ndërsa 403 lëndë udhëhiqen si të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjithsej në punë ka pasur 492 lëndë, të kryera 472 lëndë, 20 lëndë të pakryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Spektori civil (sfera)

Janë kryer 179 lëndë, nga të cilat: 1 përkatësisht 0,56% janë të konfirmuara, 0 përkatësisht 0% të abroguara, 0 përkatësisht 0% të ndryshuara.

Spektori penal (sfera)

Janë kryer 264 lëndë, nga të cilat: 6 përkatësisht 2,27% të konfirmuara, 1 përkatësisht 0,38% të abroguara dhe 1 përkatësisht 0,38% të ndryshuara.

Cilësia e punës për të gjitha bazat

Gjithsej të kryera janë 443 nga të cilat: të konfirmuara 7 përkatësisht 1,58 %, të abroguara 1 përkatësisht 0,23 %, të ndryshuara 1 përkatësisht 0,23 %.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në vitin 2022, kanë mbetur të pakryera gjithsej 2 lëndë të vjetra, të pranuar në gjykatë në vitin 2020.

Konstatime të shkurta për burimet njerëzore

Në vitin 2022 gjykata ka pasur 2 gjyqtarë deri në shtator. Nga muaji tetor vetëm një gjyqtar i cili është UD kryetar i gjykatës. Gjykata ka 14 punonjës si personel teknik, ndërsa sipas sistematizimit janë paraparë 26 vende pune, pa gjyqtarët. Në raportin e gjykatës është dhënë lista e punësimeve me prioritet.

Kapacitetet hapësinore

Sa i përket kapaciteteve hapësinore dhe kapaciteteve tjera teknike vërehet ndërtesa e vjetruar gjyqësore dhe nevoja për riparimin e saj, ndërsa sa i përket pajisjes teknike nuk janë të theksuara vërejtje të posaçme.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Krushevë nuk e ka tejkeluar fluksin dhe **nuk është gjykatë e përditësuar.**

Propozim masa:

- Të merren masa për plotësimin e vendeve të zbrazura.
- Të merren aktivitete për rritjen e përditësimit të gjykatës.

GJYKATA THEMELORE OHËR

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Nga viti i kaluar 2021, në Gjykatën Themelore Ohër kanë mbetur gjithsej 4.375 lëndë. Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Themelore Ohër janë formuar dhe janë pranuar në punë 17.552 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara kanë qenë 11 lëndë, në punë ka pasur gjithsej 21.916 lëndë, janë kryer 16.363 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 5.553 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Nga viti i kaluar kanë mbetur 19 lëndë të pakryera

Janë pranuar gjithsej 597 lëndë të reja.

Gjithsej numri i lëndëve në punë ka qenë 616.

Gjithsej numri i lëndëve të kryera ka qenë 597.

Të pakryera në fund kanë mbetur 19 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Gjatë vitit 2022, në gjykatë janë kryer 6.185 lëndë për të cilat lejohet mjet juridik.

Të ankuara kanë qenë 1.261/1.269 lëndë, nga të cilat 874 të konfirmuara, përkatësisht 68,9%, 247 lëndë, përkatësisht 19,5% kanë qenë të abroguara, 88 lëndë përkatësisht 6,9% janë të ndryshuara, 33 lëndë përkatësisht 2,6% janë pjesërisht të abroguara, ndërsa 22 lëndë përkatësisht 1,7% janë të hedhura poshtë dhe 5 lëndë përkatësisht 0,4 % të tjera.

Puna e lëndëve në nivel të sektorit

Spektori penal

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 1.502 lëndë.

Gjatë vitit 2022 janë pranuar gjithsej 11.732 lëndë të reja, gjithsej numri i lëndëve të evidentuara gabimisht ka qenë 7.

Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2022 ka qenë 13.227.

Gjithsej numri i lëndëve të kryera ka qenë 10.713.

Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 2.514 lëndë të pakryera.

Spektori civil

Lëndë të pakryera nga viti i kaluar janë 2.854 lëndë.

Gjithsej numri i lëndëve të reja gjatë vitit 2022 ka qenë 5.223, gjithsej numri i lëndëve gabimisht të evidentuara ka qenë 4.

Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2022 ka qenë 8.073.

Gjithsej numri i lëndëve të kryera ka qenë 5.053.

Të pakryera në fund të vitit 2022 kanë mbetur 3.020 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të sektorit

Spektori penal

Gjatë vitit 2022, në sektorin janë kryer 2.643 lëndë për të cilat lejohet mjet juridik.

Të ankuara janë 334/372 lëndë, nga të cilat 240 lëndë, përkatësisht 64,6% kanë qenë të konfirmuara, 81 lëndë përkatësisht 21,8% janë të abroguara, 32 lëndë përkatësisht 8,6% janë të ndryshuara, 1 lëndë përkatësisht 0,2% pjesërisht të abroguara, ndërsa 17 lëndë përkatësisht 4,6% të hedhura poshtë dhe 1 lëndë, përkatësisht 0,2% është të tjera.

Spektori civil

Në vitin 2022, në këtë sektor janë kryer 3.542 lëndë për të cilat lejohet mjet juridik.

Të ankuara janë 927/897 lëndë, nga të cilat 634 lëndë përkatësisht 70,7% janë të konfirmuara, 166 lëndë përkatësisht 18,5% janë të abroguara, 56 lëndë përkatësisht 6,2% janë të ndryshuara, 32 lëndë përkatësisht 3,6% janë pjesërisht të abroguara, ndërsa 5 lëndë përkatësisht 0,6% janë të hedhura poshtë, ndërsa 4 lëndë përkatësisht 0,4 janë të tjera.

Gjendja me lëndët e pakryera të vjetra

Në Gjykatën Themelore Ohër ka gjithsej 1164 lëndë të vjetra të pakryera, deri më 2020, nga të cilat 834 lëndë të vjetra janë lëndë trashëgimore të cilat janë në punë të noterët:

-Konteste të vlerës së vogël 30 lëndë,

-konteste pronësore 52,

- konteste tregtare 7,
- për falimentim 1,
- penale për persona të moshës madhore 68 lëndë,
- për kundërvajtje 31,
- VPP lëndë 69,
- trashëgimore 834 (në punë te noterët),
- Urdhër pagesa për ankesa 1,
- KUIKP 9,
- Konteste pune 6,
- Konteste obliguese 39,
- Konteste familjare 3,
- Lëndë për ofendim dhe shpifje 1,
- KPP 5,
- IKP 1,
- IOIP 1,
- IPRK 4
- KNZD 1,
- KOOA 1

Sipas viteve struktura e lëndëve të vjetra të pakryera është si vijon: 1 nga viti 2009, 1 nga viti 2011, 1 nga viti 2013, 16 nga viti 2014, 4 nga viti 2015, 5 nga viti 2016, 186 nga viti 2017, 264 nga viti 2018, 284 nga viti 2019 dhe 402 lëndë të vjetra të pakryera nga viti 2020.

Burime njerëzore

Gjykata Themelore Ohër vitin 2022 e ka përfunduar me gjithsej 73 punonjës nga të cilët 12 gjyqtarë në mënyrë që 1 gjyqtar me orar të shkurtë pune dhe kryetari i gjykatës. Gjithsej numri i gjyqtarëve sipas sistematizimit duhet të jetë 18 gjyqtarë. Gjithsej punonjës në shërbimin gjyqësor janë 60.

Si punësime me prioritet që duhet të plotësohen, janë vendet e punës si vijojnë: Nëpunës udhëheqës gjyqësor – 1 realizues, nëpunës profesional gjyqësor – 5 realizues, Person që merret me informatikën – realizues, nëpunës gjyqësor për në sportelet gjyqësore – 4 realizues, Daktilografistë 2 – realizues, operator i qendrës telefonike 1 – realizues dhe sekretar teknik i kryetarit 1 realizues.

Teknologji informatike

Në gjykatë ka gjithsej 72 kompjuterë, të cilat sipas karakteristikave dhe gjendjes së vjetërsisë një pjesë e tyre nuk i plotëson karakteristikat themelore për realizimin e shpejtë dhe efikase të detyrave të punës së punonjësve. Për atë shkak duhet ndërrimi i kompjuterëve të vjetruar me minimum 10 kompjuterë të rinj dhe 10 printerë. Si pjesë e grupit për furnizim publik është siguruar një server i ri. Konsiderohet se me furnizimin e kompjuterëve të rinj do të ketë nevojë për pajisje shtesë, ngase vjetrimi i aktualeve është alarmant, në mënyrë që duhet të ndërrohen me të reja.

Në 4 sallat e gjykimit është vendosur incizim me zë të lëndëve civile përmes aplikacionit FEMIDA, por duhet të sigurohet mbështetja harduerike për pajisjen e incizimit me zë, si dhe përshtatja e softuerit për incizim me zë për platformat më të reja.

Pajisja e gjykatës

Gjykata disponon me 4 vetura zyrtare prej të cilave vetëm njëra është funksionare.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Ohër nuk e ka tejkaluar fluksin dhe konsiderohet si **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

Duhet të plotësohen vendet e punës të gjyqtarëve dhe të kuadrit – profesional administrativ.

Kryetari i Gjykatës Themelore Ohër të veprojë në përputhje me Ligjin për shfrytëzimin dhe disponim me sendet në pronësi shtetërore dhe me sendet në pronësi komunale dhe në atë mënyrë të zgjidhet çështja me automjetet zyrtare jo funksionare.

GJYKATA THEMELORE PRILEP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Themelore Prilep, vitin 2022 e ka filluar me 3 659 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga viti i kaluar. Gjatë vitit 2022 në gjykatë janë pranuar 13 846 lëndë të reja për të gjitha bazat dhe së bashku me lëndët e mbetura nga viti i kaluar dhe 1 lëndë gabimisht e evidentuar, në gjykatë kanë qenë gjithsej në punë 17 504 lëndë. Gjatë vitit janë kryer 12 309 lëndë, kanë mbetur të pakryera 5 195 lëndë.

Në vitin 2022, Gjykata Themelore Prilep nga gjithsej numri i 17 504 lëndëve në punë ka pasur 9 413 lëndë nga sfera penale, ndërsa 9 091 lëndë nga sfera civile. Prej tyre, në mënyrë të ndarë sipas llojit të lëndëve, nga gjithsej numri i lëndëve në punë, 3 098 lëndë bien në lëndët gjyqësore për përmbarimin e sanksioneve (vuajtje të dënimit me burg, ndërprerja e vuajtjes së dënimit, përmbarimi i dënimeve penale me gjobë, shpenzime dhe paushall, përmbarimi i gjobave për kundërvajtje, shpenzime dhe paushall), 1 844 janë lëndë gjyqësore nga sfera penale (K persona të moshës madhore, K persona të mitur, veprime në procedurën paraprake dhe vlerësimi i aktit akuzues), 9 413 lëndë për kundërvajtje, 5 432 janë VPP lëndë, ndërsa 8 091 janë lëndë proceduese civile dhe 96 lëndë bien në lëndët gjyqësore për përmbarim (kundër përmbarim, ankesa kundër parregullsive gjatë lëshimit të lejeve).

Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 558 lëndë të pakryera për përmbarimin e sanksioneve (vuajtja e dënimit me burg, ndërprerja e vuajtjes së dënimit, përmbarimi i dënimeve me gjobë, shpenzime dhe paushall, përmbarimi i gjobave për kundërvajtje, shpenzime dhe paushall), 664 janë lëndë gjyqësore nga sfera penale (K persona të moshës madhore, K persona të mitur, veprime në procedurën paraprake dhe vlerësimi i aktit akuzues), 2 399 lëndë për kundërvajtje, 483 janë VPP lëndë, ndërsa 1 086 janë lëndë proceduese civile dhe 5 lëndë bien në lëndët gjyqësore për përmbarim (kundër përmbarim, ankesa kundër parregullsive gjatë përmbarimit dhe lëshimit të lejeve).

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në vitin 2022 nga ana e administratës gjyqësore është vepruar për lëndë të evidentuara në regjistrat adekuat edhe atë për gjithsej 347 lëndë nga të cilat 298 janë kryer gjatë vitit raportues, ndërsa 45 kanë mbetur të pakryera.

Në bazë të njoftimeve të ndryshme në administratën gjyqësore kanë arritur 221 lëndë nga të cilat 193 janë kryer, ndërsa 28 kanë mbetur të pakryera. Më tej në SU-IZZ regjistrin janë evidentuar 94 lëndë dhe të gjitha janë kryer, në regjistrin për evidentimin e parashtrësive dhe ankesave janë evidentuar 1 lëndë e pakryer nga viti i kaluar dhe 7 parashtrësia nga të cilat 1 ka mbetur e pakryer. Janë paraqitur 8 kërkesa të reja për qasje të lirë në informacionet, ndërsa 12 janë hasur nga viti i kaluar. 4 kërkesa për qasje të lirë në informacionet janë kryer ndërsa 16 kanë mbetur të pakryera.

Gjatë vitit 2022 Gjykata Themelore Prilep, në përputhje me planin për furnizime publike, ka publikuar dhe ka zbatuar furnizime publike për naftë për ngrohje për sezonin ngrohës 2022/2023, tonerë, material për zyra, energji elektrike dhe për karburant për veturën zyrtare. Përmes furnizimeve qendrore nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Gjykatës Supreme, është bërë edhe furnizimi i shërbimeve për telefona fiks, telefona dore dhe internet.

Gjykata ka Zyrën e saj për marrëdhënie me publikun. Në ueb faqen e gjykatës rregullisht janë publikuar vendime të plotfuqishme sipas Ligjit për udhëheqjen me qarkullimin e lëndëve në gjykatat, dhe gjatë vitit 2022 janë publikuar 801 vendime. Gjykata ka mundësuar praktikë vullnetare për studentët dhe juristët e diplomuar dhe magjistrat. Me kërkesë të shkollave fillore dhe të mesme të qytetit janë mbajtur takime kohë pas kohe për të njoftuar nxënësit dhe studentët me kompetencën e gjykatës, vendosje organizuese të saj dhe në përgjithësi me punën e gjykatës.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Puna e sektorëve

Gjykata Themelore Prilep është gjykatë me kompetencën të zgjeruar dhe i realizon punët përmes Sektorit penal dhe Sektorit civil. Në vitin raportues 2022 gjendja e punës me lëndët në sektorët është si vijon:

Sa i përket gjithsej numrit të lëndëve të kryera, të dhënat tregojnë se në vitin 2022 në Gjykatën Themelore Prilep gjithsej janë kryer 12 611 lëndë gjyqësore, nga të cilat 5 792 në sektorin penal të gjykatës, ndërsa 6 517 lëndë gjyqësore në sektorin civil të gjykatës.

Analiza sipas llojeve të lëndëve tregon se gjatë vitit 2022 janë kryer: 2 540 lëndë që bien në lëndët gjyqësore për përmbarimin e sanksioneve, 1 180 janë lëndë gjyqësore nga sfera penale, 5 792 lëndë për kundërvajtje, 4 949 janë VPP lëndë, ndërsa 6 517 janë lëndë proceduese civile dhe 91 lëndë bien në lëndët gjyqësore për përmbarim.

Sa i përket gjithsej lëndëve të pakryera, të dhënat e ekspozuara tregojnë se lëndë të pakryera më 31.12.2022 në Gjykatën Themelore Prilep janë gjithsej 5 240 lëndë gjyqësore nga të cilat 3 621 në sektorin penal të gjykatës, ndërsa 1 574 lëndë gjyqësore në sektorin civil të gjykatës.

Në sektorin penal, nga viti i kaluar ka pasur 2 286 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga sfera penale, me të cilat ka filluar viti raportues. Në mënyrë të ndarë sipas llojit të lëndëve, nga gjithsej numri i lëndëve të pakryera në fillim të vitit, 439 lëndë gjyqësore bien në lëndët gjyqësore për përmbarimin e sanksioneve, 572 janë lëndë gjyqësore nga sfera penale, 2 286 lëndë për kundërvajtje. Në vitin 2022 janë pranuar 7 127 lëndë gjyqësore të reja nga sfera penale. Në mënyrë të ndarë sipas llojit të lëndëve, nga gjithsej numri i lëndëve të reja të pranuar, 2 659 lëndë bien në lëndët gjyqësore për përmbarimin e sanksioneve, 1 272 janë lëndë gjyqësore nga sfera penale, 3 196 lëndë për kundërvajtje.

Sa i përket lëndëve të kryera totale, të dhënat tregojnë se në vitin 2022 në Gjykatën Themelore Prilep gjithsej janë kryer 12 611 lëndë gjyqësore, nga të cilat 5 792 në sektorin penal të gjykatës, ndërsa 6 517 lëndë gjyqësore në sektorin civil të gjykatës.

Gjykata vitin raportues në sektorin penal në punë ka pasur gjithsej 9 413 lëndë, nga të cilat 5 792 lëndë i ka kryer, ndërsa kanë mbetur të pakryera 3 621 lëndë, përkatësisht sektori penal ka arritur të kryejë 61,53 % nga gjithsej numri i lëndëve në punë në këtë sektor, ndërsa kanë mbetur të pakryera 38,47 % nga gjithsej numri i lëndëve të cilat kanë qenë në punë.

Në sektorin civil, në fillim të vitit 2022, janë bartur si të pakryera nga viti i kaluar 1 373 lëndë gjyqësore nga sfera civile, përkatësisht në mënyrë të ndarë sipas llojit të lëndëve, nga numri total i lëndëve të pakryera në fillim të vitit, 512 janë VPP lëndë, lëndë gjyqësore nga sfera civile, përkatësisht në mënyrë të ndarë sipas llojit të lëndëve, nga numri total i lëndëve të pakryera në fillim të vitit, 512 janë VPP lëndë, ndërsa 854 janë lëndë proceduese civile dhe 7 lëndë bien në lëndët gjyqësore për përmbarim.

Lëndë të reja të pranuar në vitin 2022 janë gjithsej 6 719 lëndë gjyqësore nga sfera civile. Përkatësisht Gjykata Themelore Prilep në punë ka pasur gjithsej 8 091 lëndë nga sfera civile. Prej tyre 4 921 janë VPP lëndë, ndërsa 1 709 janë lëndë proceduese civile dhe 89 lëndë bien në lëndët për përmbarim.

Gjykata vitin raportues në sektorin civil prej gjithsej 8092 lëndëve ka kryer 6517 lëndë ndërsa kanë mbetur të pakryera 1574 lëndë, përkatësisht sektori civil ka arritur të kryejë 80,54 % nga numri gjithsej i lëndëve në punë në këtë sektor, ndërsa kanë mbetur të pakryera 19,46 % nga numri total i lëndëve që kanë qenë në punë.

Cilësia e punës së sektorëve

Gjendja me cilësinë e vendimeve të marra është treguar në raport me gjithsej numrin e lëndëve të kryera.

Në nivel të Gjykatës Themelore Prilep, nga gjithsej 12 611 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 335 lëndë ose 2,65%, të abroguara janë 113 ose 0,89%, të ndryshuara janë 100 lëndë ose 0,79%, pjesërisht të abroguara 17 ose 0,13% lëndë dhe të hedhura poshtë janë 2 ose 0,01% lëndë.

Në sektorin penal nga numri total i 6 179 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 90 lëndë ose 16,02 %, të abroguara janë 30 lëndë ose 5,73 % , të ndryshuara janë 24 lëndë ose 5,16 % dhe të hedhura poshtë janë 14 ose 0,42%.

Në sektorin civil nga numri total i 6 517 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 286 lëndë ose 4,3 %, të abroguara janë 66 ose 1,01 %, të ndryshuara janë 66 lëndë ose 1,01 % dhe pjesërisht të abroguara janë 13 ose 0,19 %.

Këto përqindje çojnë në konkluzionin se gjykata në vitin raportues ka pasur cilësi të lartë të lëndëve të kryera.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fund të vitit raportues, gjendja me lëndët e vjetra të pakryera sipas vitit të pranimit në Gjykatën Themelore Prilep është si vijon:

Lëndë të vjetra të pakryera janë 135 dhe prej tyre 2 nga viti 2016, 6 nga viti 2017, 16 nga viti 2018, 48 nga viti 2019 dhe 64 nga viti 2020 година. KZH – të pakryera kanë mbetur 15 lëndë dhe 2 lëndë PRKZH.

Burime njerëzore

Gjatë vitit 2002 në Gjykatën Themelore Prilep, janë pensionuar 5 gjyqtarë, dhe në fund të vitit kanë mbetur të punojnë tre gjyqtarë në sektorin civil dhe dy gjyqtarë në sektorin penal.

Në Gjykatën Themelore Prilep, Administratori gjyqësor menaxhon me shërbimin gjyqësor dhe është përgjegjës për realizimin dhe kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo-teknike të gjykatës. Në Gjykatën Themelore Prilep janë plotësuar vendet e punës Udhëheqës i sektorit të informatikës dhe Udhëheqës i sektorit civil që janë të paraparë me Ligjin për shërbimin gjyqësor dhe me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës.

Numri i nëpunësve profesional gjyqësor në gjykatë është 13 prej të cilëve tre këshilltarë gjyqësor dhe 10 bashkëpunëtor gjyqësor. Numri i referentëve të punësuar gjyqësor në Gjykatën Themelore Prilep është 20 në kohë të pacaktuar dhe një në kohë të caktuar, 13 nëpunës gjyqësor me titullin referent i ri gjyqësor, pesë referentë të lartë gjyqësor dhe 7 referentë të pavarur gjyqësor në kohë të pacaktuar dhe një në kohë të caktuar. Nga viti 2011 edhe krahas kërkesave të paraqitura shumë herë, Gjykata Themelore Prilep nuk ka të punësuar referent- kontabilistë gjyqësor, edhe pse sipas dispozitave pozitive ligjore, çdo institucion shtetëror është e domosdoshme që të ketë një lloj të tillë të kuadrit.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Prilep disponon me personal teknik që ka shtatë – qendrën telefonike, mjeshtër të kazanit me avull – mjeshtër të përgjithshëm, 4 mirëmbajtëse të higjienës dhe një shofer. Mbrojtjen e objektit dhe pronës së gjykatës, si dhe mbajtjen e rregullit në ndërtesën e gjykatës e bëjnë gjashtë polic gjyqësor.

Gjatë vitit 2022, punonjësit e gjykatës shpesh kanë vizituar trajnimet e organizuara nga Akademia për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik “Pavel Shatev” Shkup, përmes aplikacionit ZOOM, ndërsa një pjesë e vogël kanë marrë pjesë në trajnimet e mbajtura me prani fizike.

Gjykata disponon me një numër të mjaftueshëm të pajisjes kompjuterike për nëpunësit gjyqësor. Me investime kapitale, një pjesë e pajisjes kompjuterike u ndërrua me pajisje të re, megjithatë në një pjesë e njëjta nga cilësia është në gjendje të prishur para se gjithash për arsye vjetrimi, dhe sidomos është alarmante gjendja me printerët. Në kërkesën për investime kapitale, Gjykata Themelore Prilep vazhdimisht thekson kërkesat për përtëritjen e pjesës së pajisjes informatike të vjetruar.

Gjatë vitit 2022 nga administrata gjyqësore janë plotësuar obligimet ligjore rreth kontrollit të rregullt dhe mirëmbajtjes së pajisjes dhe instalimeve në gjykatë – sistemit kundër zjarrit dhe aparateve, rrjetit të hidratuar, sistemit për video mbikëqyrje në gjykatë. Njëkohësisht edhe ndërtesa gjyqësore dhe pajisja në gjykatë përfshihen me sistem të shërbimeve siguroese nga dëmtimi i tyre.

Për përmirësimin e gjendjes së sigurisë të punonjësve dhe palëve, Gjykata Themelore Prilep ka nevojë për ripërtëritjen dhe bashkëkohësinë e pajisjes për video mbikëqyrje në ndërtesën gjyqësore e cila veç më është e vjetruar, ndërsa një pjesë është jofunksionale.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Prilep, vitin raportues 2022 e ka përfunduar si gjykatë e pa përditësuar, nuk e ka tejkuluar fluksin për 1 537 lëndë, dhe e ka rritur mbetjen për 1536 lëndë. Nga të dhënat e këtij raporti, duhet të përmendet se në Gjykatën Themelore Prilep, për shkak të pensionimit të 5 gjyqtarëve, në periudhën raportuese kanë punuar tre gjyqtarë në sektorin civil dhe dy gjyqtarë në sektorin penal. Për atë shkak, është vënë në dyshim përditësimi dhe cilësia e lëndëve të punuara, si dhe mundësia e një numri të madh të lëndëve të vjetruara. Përveç kësaj, është evidente edhe ajo që gjykimet caktohen dhe shtyhen për 5 e më shumë muaj, për arsye që ekziston rreziku nga parashkrimi i një numri të konsiderueshëm të lëndëve penale dhe për kundërvajtje.

Për këtë situatë të Gjykatës Themelore Prilep, disa herë, me shkrim dhe gojarisht është njoftuar Këshilli gjyqësor, në mënyrë që është kërkuar në Gjykatën Themelore Prilep të delegohen një ose dy gjyqtarë në sektorin penal për tu penguar parashkrimi i lëndëve penale, si dhe të sundojë fluksi aktual i lëndëve.

GJYKATA THEMELORE RESNJË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2022 në nivel të gjykatës në punë kanë qenë gjithsej 4956 lëndë, nga të cilat të kryera janë 4470 lëndë, ndërsa 486 udhëhiqen si të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Gjithsej në punë ka 857 lëndë, janë kryer 854 lëndë, 3 lëndë të pakryera. Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Sektori civil (sfera)

Cilësia e punës. Janë kryer 29 lëndë, nga të cilat: 22 përkatësisht 75,86% janë të konfirmuara, 5 përkatësisht 17,24 % të abroguara, 2 përkatësisht 6,90 % të ndryshuara.

Sektori penal (sfera)

Cilësia e punës. Janë kryer 66 lëndë, nga të cilat: 47 përkatësisht 72,30 % të konfirmuara, 9 përkatësisht 13,85 % të abroguara dhe 9 përkatësisht 13,85 % të ndryshuara.

Cilësia e punës për të gjitha bazat

Janë kryer gjithsej 95 lëndë, nga të cilat: të konfirmuara janë 69 përkatësisht 73,40 %, të abroguara 14 përkatësisht 14,90, të ndryshuara 11 përkatësisht 11,70%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2022 në punë kanë qenë 74 lëndë ndërsa 28 lëndë në vitin 2021 përkatësisht gjithsej 102 lëndë të pakryera, nga të cilat 44 janë të kryera, ndërsa mbesin 58 të pakryera.

Burime njerëzore

Në vitin 2022 gjykata ka pasur 3 gjyqtarë, 3 bashkëpunëtor gjyqësor deri më 26.03.2022, ndërsa pastaj 2 bashkëpunëtor gjyqësor, 1 bashkëpunëtor i ri gjyqësor, 4 referentë në sportel, 1 përkthyes, 3 daktilografistë, 1 person i informatikës, 1 ekonom që punon edhe si vozitës, 1 mjeshtër i përgjithshëm, 1 dorëzues, 4 polic gjyqësor dhe 1 mirëmbajtës higjiene.

Në vitin 2022 nuk është plotësuar një vend i zbrazur për gjyqtar dhe nuk janë realizuar punësime të reja.

Kapacitetet hapësinore

Nuk janë theksuar vërejtje për kushtet hapësinore, pastaj tregohet edhe për nevojën me ri pajisjen e gjykatës në aspekt të teknologjisë informatike dhe teknologjisë tjetër. Detektori i derës së gjykatës nuk punon ka disa vite.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Resnjë e ka tejkuluar fluksin e lëndëve, ndërsa është zvogëluar mbetja ashtu që konsiderohet **si gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa:

- Të merren masa për plotësimin e vendit të zbrazur për gjyqtar.
- Të shihet mundësia për pajisjen teknike të gjykatës.

- Të mbahet vazhdimësia përkatësisht dinamika e punës.

GJYKATA THEMELORE STRUGË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 3.597 lëndë. Në punë ka pranuar 17.395 lëndë të reja dhe me 188 lëndë të marra përsëri në punë, si dhe 14 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 21.166 lëndë. Prej tyre ka kryer 16.310 lëndë dhe të pakryera kanë mbetur 4.856 lëndë. Fluksi i lëndëve nuk është tejkaluar dhe mbetja është rritur për 1.259 lëndë.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar për 2.048 lëndë dhe të gjitha lëndët janë të kryera.

Administrata gjyqësore udhëhiqet nga Kryetari i gjykatës Ifet Bajramoski.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Gjendja me punën e lëndëve është si vijon:

Sektori penal

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 2.023 lëndëve. Janë pranuar 9.160 lëndë të reja dhe me 86 lëndë që janë marrë përsëri në punë, si dhe 12 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 11.257 lëndë. Prej tyre të kryera janë 8.126 lëndë dhe të pakryera kanë mbetur 3.131 lëndë. Mbetja e lëndëve është rritur për 1.108 lëndë. Te ky lloj i lëndëve cilësia është si vijon: Prej 8.126 lëndëve të kryera, të ankuara janë 238 lëndë. Prej 147 lëndëve të ankuara ose 61,76% janë të konfirmuara, 74 lëndë ose 31,09% janë të abroguara dhe 17 lëndë ose 7,15% të ndryshuara.

Sektori civil

Nga viti i kaluar kanë mbetur 1.574 lëndë. Janë pranuar 6.187 lëndë të reja dhe me 102 lëndë të marra përsëri në punë, si dhe 2 lëndë gabimisht të evidentuara, gjithsej në punë ka pasur 7.861 lëndë. Prej tyre të kryera janë 6.136 lëndë dhe të pakryera kanë mbetur 1.725 lëndë. Është rritur numri i lëndëve që kanë mbetur për 151 lëndë.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: Prej 6.138 lëndëve të kryera, të ankuara janë 285 lëndë. Nga lëndët e ankuara, 205 lëndë ose 71,93% janë të konfirmuara, 73 lëndë ose 25,62% të abroguara dhe 7 lëndë ose 2,45% të ndryshuara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2022, Gjykata Themelore Strugë ka pasur 92 lëndë të vjetra prej 2 vitesh në punë. Në fund të vitit 2022 në punë kanë mbetur 134 lëndë, që do të thotë se numri është rritur për 42 lëndë.

Burime njerëzore

Sipas sistematizimit në Gjykatën Themelore Strugë duhet të sistemohen 15 gjyqtarë, por gjatë vitit raportues 2022 funksionin e gjyqtarit e kanë ushtruar 6 gjyqtarë së bashku me kryetarin e gjykatës. Sipas Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë janë paraparë 120 vende pune nga të cilat janë plotësuar 49.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa e gjykatës është relativisht e re dhe e njëjta është ri ndërtuar dhe rinovuar, është e furnizuar me mobilie të re për të gjitha hapësirat. Janë përgatitur dy salla gjykimi me pajisje për incizim tonik, janë kërkuar mjete për pajisje të edhe dy hapësirave për incizim audio – video sipas Ligjit të ri për procedurë penale.

Gjendja me pajisjen informatike i përmbush nevojat e gjykatës.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Nga aspekti i punës së lëndëve, Gjykata Themelore Strugë është **gjykatë e pa përditësuar**. Fluksin e lëndëve nuk e ka tejkaluar, ndërsa mbetjen e ka rritur për 1.259 lëndë. Cilësia e punës dallohet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve të pa ankuara dhe cilësia e punës sa i përket gjithsej lëndëve të kryera.

Kushtet hapësinore dhe gjendja me pajisjen informatike dhe atë të sigurisë përmbushen.

Propozim masa:

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet e pajisjes së informatikës të gjykatës dhe të përmirësohet gjendja me kuadrin e gjyqtarëve, administratën gjyqësore dhe policinë gjyqësore.

Duhet të vazhdohet me punë cilësore.

GJYKATA E APELIT SHIPTIP

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata e Apelit Shtip, në vitin 2022 në punë ka pasur gjithsej 2648 lëndë të reja, dhe së bashku me 452 lëndët e pakryera nga viti i kaluar 2021, gjithsej në punë kanë qenë 3100 lëndë. Prej 3100 lëndëve në punë në vitin 2022 janë kryer 2292 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 808 lëndë. Fluksin i lëndëve të pakryera në vitin 2022 Gjykata e Apelit Shtip nuk e ka tejkaluar sepse mbetja e lëndëve është rritur për 356 lëndë (krahasuar me vitin 2021 kur kanë mbetur të pakryera 452 lëndë, në vitin 2022 kanë mbetur të pakryera 808 lëndë) dhe krahas asaj që numri i lëndëve të reja është zvogëluar në vitin 2022 për 175 lëndë. Në fakt në vitin 2021 ka pasur 2823 lëndë të reja të pranuar, ndërsa në vitin 2022 janë pranuar 2648 lëndë të reja. Nga të dhënat statistikore paraprakisht të theksuara mund të arrihet në konkluzion se Gjykata e Apelit Shtip, vitin 2022 e ka përfunduar si gjykatë e pa përditësuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Vitin 2022 nga administrata gjyqësore është vepruar për lëndë të evidentuara në regjistra përkatës edhe atë gjithsej në 1 983 lëndë, dhe të gjitha janë kryer gjatë vitit raportues.

Sipas bazës së njoftimeve të ndryshme në administratën gjyqësore kanë arritur 1340 lëndë, më tutje në regjister të besueshëm janë evidentuar 5 lëndë, në regjistrin për evidencën e parashtrësive dhe ankesave janë evidentuar 66 parashtrësia, 567 kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve dhe kryetarit dhe 5 kërkesa për qasje të lirë në informacionet.

Gjatë vitit 2022, pas mjeteve të miratuara nga Këshilli i Buxhetit Gjyqësor të RMV, Gjykata e Apelit Shtip, përgatiti plan vjetor për furnizime publike që janë paraparë dhe zbatuar 3 furnizime publike.

Gjatë vitit, kryetari i Gjykatës së Apelit Shtip së bashku me gjyqtarët e dy sektorëve sipas orarit paraprakisht të përgatitur, kanë realizuar vizitë në të gjitha gjykatat themelore nga rajoni i apelit të kësaj gjykate, për të cilat janë përgatitur edhe raporte të posaçme në të cilat janë konstatuar gjendjet me udhëheqjen e qarkullimit të lëndëve në këto gjykata, kushtet e punës me kuadro dhe hapësira, si dhe nevojat informatike të gjykatave dhe gjyqtarëve.

Nëpërmjet zyrës për marrëdhënie me publikun, kjo gjykatë në vitin 2022 ka pranuar 1005 kërkesa me shkrim. Janë pranuar 5 kërkesa për informacione me karakter publik, nga të cilat 3 janë aprovuar dhe është dhënë informacioni i kërkuar, ndërsa 2 janë refuzuar ngase është vlerësuar se informacioni i kërkuar nuk është informacion me karakter publik.

Krahas kësaj, në ueb faqen e gjykatës janë publikuar rregullisht edhe informacione për publikun, raporte mujore dhe periodike për punën e gjykatës, njoftime, shpallje, buletine. Në vitin raportues janë publikuar 2035 vendime.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Puna e sektorëve

Gjykata e Apelit Shtip është themeluar për rajonin e gjykatave themelore Berovë, Vinicë, Dellçevë, Koçan, Radovish, Sveti Nikollë, Strumicë dhe Shtip. Puna e Gjykatës së Apelit Shtip është e organizuar në dy sektorë, përkatësisht Sektorin penal dhe Sektorin civil. Në vitin raportues 2022, gjendja me punën e lëndëve në sektorë është si vijon:

Në sektorin penal, nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 29 lëndëve penale dhe për kundërvajtje të shkallës së dytë, të evidentuara si KZH, 5 lëndë për kundërvajtje PRKZH të shkallës së dytë ose gjithsej 34 lëndë të pakryera nga viti i kaluar me të cilat ka filluar viti

raportues. Më tej 52 lëndë KZH janë evidentuar përsëri në punë si lëndë penale të shkallës së dytë, 18 lëndë për kundërvajtje PRKZH të shkallës së dytë dhe 8 KSZH në regjistrin për këshillin penal të shkallës së dytë ose gjithsej 78 lëndë kanë qenë përsëri në punë në Gjykatën e Apelit në sektorin penal. Janë pranuar 387 lëndë KZH të reja penale dhe për kundërvajtje të shkallës së dytë, 8 lëndë penale dhe për kundërvajtje të shkallës së dytë në procedurën kundër personave të mitur KZHM, 172 lëndë për këshillin penal të shkallës së dytë KSZH, 408 lëndë për kundërvajtje PRKZH të shkallës së dytë dhe 37 lëndë të evidentuara në regjistër si lëndë të ndryshme penale.

Gjykata në vitin raportues në sektorin penal ka pasur gjithsej 1124 lëndë nga të cilat ka kryer 1036 lëndë ndërsa kanë mbetur të pakryera 88 lëndë, përkatësisht sektori penal ka arritur të përfundojë 92,3 % nga gjithsej numri i lëndëve, ndërsa në punë kanë mbetur gjithsej 7,7% nga gjithsej numri i lëndëve.

Në sektorin civil, nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 279 lëndëve civile GZH të shkallës së dytë, 30 lëndë ROZH për konteste nga marrëdhënia e punës, 109 lëndë TSZH për konteste tregtare të shkallës së dytë, ose gjithsej kanë mbetur nga viti i kaluar 418 lëndë me të cilat ka filluar viti raportues. Gjatë vitit janë pranuar 610 lëndë të reja civile të shkallës së dytë GZH, 447 lëndë të shkallës së dytë për konteste nga marrëdhënia e punës ROZH, 237 lëndë të shkallës së dytë për konteste tregtare TSZH dhe 53 lëndë të ndryshme civile R ose gjithsej lëndë të reja të pranuar në sektorin civil kanë qenë 1347 lëndë me të cilat ka filluar viti raportues. Krahas kësaj, përsëri në punë kanë qenë 208 lëndë.

Gjykata në vitin raportues në sektorin civil ka pasur gjithsej 1973 lëndë nga të cilat ka kryer 1253 ndërsa kanë mbetur të pakryera 720 lëndë, përkatësisht sektori civil ka arritur të përfundojë 63,5 % nga gjithsej numri i lëndëve në punë në këtë sektor, ndërsa kanë mbetur të pakryera 36,5 % nga gjithsej numri i lëndëve që kanë qenë në punë.

Cilësia e punës së sektorëve

Gjendja me cilësinë e vendimeve të miratuara është treguar në raport me gjithsej numrin e lëndëve të kryera.

Në sektorin penal prej gjithsej 1037 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 25 lëndë ose 2,41 %, të abroguara janë 2 lëndë ose 0,19 %, të ndryshuara janë 2 ose 0,19 % dhe të hedhura poshtë janë 5 ose 0,48%.

Në sektorin civil nga gjithsej 1.253 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 30 lëndë ose 2,39%, të abroguara janë 10 lëndë ose 0,80%, të ndryshuara janë 4 lëndë ose 0,32% dhe të hedhura poshtë janë 12 ose 0,96%.

Këto përqindje qojnë në konkluzionin se gjykata në vitin raportues ka pasur cilësi të lartë të lëndëve të përfunduara.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fund të vitit raportues, gjendja me lëndët e vjetra të pakryera sipas vitit të pranimit në Gjykatën e Apelit Shtip është si vijon:

KZH – kanë mbetur të pakryera 15 lëndë dhe 2 lëndë PRKZH.

GZH – të pakryera kanë mbetur 153 lëndë, TSZH – të pakryera kanë mbetur 53 lëndë dhe ROZH – të pakryera kanë mbetur 5 lëndë.

Lëndë në procedurë më shumë se 2 vjet sipas vitit të pranimit në gjykatën themelore, në vitin 2022 në Gjykatën e Apelit Shtip kanë qenë gjithsej 17 edhe atë 1 lëndë nga viti 2017, 2 lëndë nga viti 2018, 4 lëndë nga viti 2019 dhe 10 lëndë nga viti 2020.

Burime njerëzore

Në fillim të vitit 2022, Gjykata e Apelit Shtip ka pasur 54 punonjës nga të cilët 11 gjyqtarë së bashku me kryetarin e gjykatës, 35 nëpunës gjyqësor, 6 pjesëtar të policisë gjyqësore dhe 2 mirëmbajtëse higjiene. Gjatë vitit 2022 është pranuar në punë një nëpunës gjyqësor.

Me aktvendime të Këshillit gjyqësor të RMV të datës 18.04.2022, janë shkarkuar gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shtip, Zoranço Micevski dhe Suzana Zdraveva, në mënyrë që është zvogëluar numri i gjyqtarëve në 9 duke përfshirë kryetarin e gjykatës. Më 01.07.2022, Kryetarja e gjykatës Kornelija Davçeva ka shkuar në pension, në mënyrë që numri i gjyqtarëve është zvogëluar në gjithsej 8 gjyqtarë. Dy gjyqtarëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës për arsye të ndryshme, por gjatë muajit dhjetor me konkursin e

shpallur publik janë pranuar dy bashkëpunëtor gjyqësor, ashtu që në fund të vitit numri i nëpunësve gjyqësor ka qenë 36 ndërsa gjithsej punonjësve 52.

Krahas gjendjeve të theksuara, ka ndikuar edhe ajo që njëri prej gjyqtarëve të materies civile të datës 13.07.2016 është zgjedhur për Kryetar të Gj.Th. Vinicë, ndërsa nga korriku i vitit 2020, i njëjti gjyqtar e ka kryer funksionin e U.D. kryetar të së njëjtës gjykatë. Për arsye se në dhjetor të vitit 2022, Këshilli gjyqësor ka zgjedhur kryetar në Gj.Th. Vinicë, nga shkurti i vitit 2023 pritet që ky gjyqtar të kthehet në vendin e punës në Gj.A Shtip. Megjithatë, edhe pse me sistematizimin e vendeve të punës për Gj.A Shtip janë paraparë 16 gjyqtarë, gjykata punon me 7 gjyqtar më pak veç më një kohë të gjatë. Të gjithë faktorët parapraakisht të theksuar kanë ndikuar që viti raportues të përfundojë me mbetjen më të madhe të lëndëve nga viti i kaluar.

Kapacitetet hapësinore

Kapacitetet hapësinore të ndërtesës së Gjykatës së Apelit Shtip në parim i përmbushin nevojat e kushteve për realizimin e obligimeve të punës përveç që ka një mungesë të hapësirave për vendosjen adekuate të këshilltarëve gjyqësor dhe bashkëpunëtorëve si dhe të proces verbalistëve. Vlerësimi është se kjo gjendje mund të tejkalohet vetëm nëse Prokuroria e Lartë Publike që është e vendosur në ndërtesën gjyqësore të kalojë në ndërtesë tjetër. Hapësirat në të cilat janë të vendosur gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësor janë të pajisur me mobilie të duhur dhe me pajisje informatike, çdo gjyqtar ka kompjuterin e tij dhe ka qasje në AKMIS dhe në internet. Gjykata disponon me tre salla gjykimi prej të cilave njëra është me sistem të incizimit me zë dhe ato në tërësi i përmbushin nevojat e gjykatës. Sa i përket përdorimit dhe zbatimit të sistemit të informatikës i njëjti është në tërësi funksionar.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata e Apelit Shtip në vitin 2022 me vëllimin e rritur të punës dhe numrin dukshëm të zvogëluar të gjyqtarëve ka punuar si gjykatë e pa përditësuar. Nga treguesit e dhënë të gjendjes me lëndët konstatohet se fluksi i lëndëve të pakryera në vitin 2022 nuk është tejkaluar, ngase mbetja e lëndëve të pakryera është rritur për 355 lëndë (në vitin 2021 kanë mbetur të pakryera 452 lëndë, ndërsa në vitin 2022 kanë mbetur të pakryera 808 lëndë) edhe krahas asaj që numri i lëndëve të reja është zvogëluar në vitin 2022 për 175 lëndë. Në fakt në vitin 2021 ka pasur 2823 lëndë të reja të pranuar, ndërsa në vitin 2022 janë pranuar 2648 lëndë të reja. Që nga korriku i vitit 2021 gjykata punon me dy gjyqtar më pak në lëndët civile, pasi që në gjykatë kanë mbetur vetëm tre gjyqtarë nga materia civile të cilët e mbulojnë tërë rajonin e Gjykatës së Apelit Shtip, ashtu që për ato shkaqe gjykata ka mbetje prej 808 lëndëve të pakryera, nga të cilat 720 janë lëndë civile ndërsa 88 lëndë janë lëndë penale.

Gjykata e Apelit Shtip veç më punon me shtatë gjyqtar më pak, ndërsa në vitin 2023 në pension sipas moshës do të shkojnë tre gjyqtarë me moshë 64 vjeçe, ndërsa dy gjyqtarë – gra kanë lajmëruar shkuarjen në pension me pension me moshë prej 62 vjet, që do të thotë se gjykata do të mbes me 4 gjyqtar deri në fund të vitit 2023.

Edhe krahas pajisjes së zvogëluar të kuadrit, cilësia e vendimeve të sjella edhe në të dy sektorët është në nivel të lartë.

Propozim masa:

Megjithatë për përditësim më të madh të gjykatës është e domosdoshme që në gjykatë të zgjidhen të paktën 8 gjyqtarë të rinj.

Krahas kësaj, gjykata ka nevojë për më shumë bashkëpunëtor profesional, edhe pse me sistematizimin janë paraparë 8 bashkëpunëtor profesional janë plotësuar vetëm tre vende.

Gjykata e Apelit Shtip ka nevojë për serverë të rinj dhe vazhdimisht modernizimin e pajisjes së informatikës.

GJYKATA THEMELORE BEROVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Berovë nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur gjithsej 858 lëndë të pakryera, ndërsa të reja të pranuar gjatë vitit kanë qenë 3252 lëndë, lëndë përsëri në punë 19, lëndë gabimisht të evidentuara 1, ashtu që gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2022 ka qenë 4128. Nga numri total i lëndëve në punë, gjatë vitit 2022 janë kryer 3458, ndërsa kanë mbetur të pakryera 670 lëndë. Në këtë mënyrë gjatë vitit raportues gjithsej janë kryer 83,76% në nivel të gjykatës, që do të thotë se Gjykata Themelore Berovë është gjykatë e përditësuar.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punën e administratës gjyqësore, lëndë të pakryera në fillim të vitit - 1 lëndë, gjatë vitit 2022 janë pranuar 475 lëndë të reja, gabimisht të evidentuara nuk ka. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë 476, janë kryer të gjitha lëndët.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Gjatë vitit raportues nga gjithsej numri i 1277 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 57 lëndë, përkatësisht 4,46%, të abroguara janë 14 lëndë përkatësisht 1,09% dhe të ndryshuara janë 3 lëndë përkatësisht 0,23%.

Puna e Sektorëve dhe cilësia e punës

Në Sektorin penal të Gjykatës Themelore Berovë nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur 375 lëndë të pakryera, të reja të pranuar të këtij lloji gjatë vitit 2022 janë 1854 dhe 6 lëndë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara 1 lëndë. Numri gjithsej i lëndës në Sektorin penal në vitin raportues 2022 ka qenë 2235, prej të cilave gjatë vitit 2022 janë kryer 1850 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 385 lëndë. Në këtë mënyrë gjatë vitit raportues Sektori penal i Gjykatës Themelore Berovë nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve.

- Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorit penal.

Nga gjithsej 1025 lëndët e kryera, prej të cilave: të konfirmuara 9 lëndë ose 0,87%, të abroguara 5 lëndë ose 0,48%, ndërsa të ndryshuara nuk ka.

Në Sektorin civil të Gjykatës Themelore Berovë nga viti i kaluar 2021 kanë mbetur 482 lëndë të pakryera, ndërsa të reja të pranuar të këtij lloji gjatë vitit 2022 janë 922, përsëri në punë janë 13 lëndë. Numri gjithsej i lëndëve në Sektorin civil në vitin raportues 2022 ka qenë 1417 lëndë, prej të cilave lëndë 1132 kanë qenë të kryera dhe 285 kanë qenë të pakryera. Në këtë mënyrë gjatë vitit raportues Sektori civil i Gjykatës Themelore Berovë e ka tejkaluar fluksin e lëndëve.

- Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorit civil

Nga gjithsej numri i 252 lëndëve të kryera, vendimet kanë qenë të konfirmuara në 48 lëndë ose 19,04%, të abroguara 9 lëndë ose 3,57%, ndërsa të ndryshuara kanë qenë 3 lëndë ose 1,19%.

Në vitin raportues për punën e Gjykatës Themelore Berovë për vitin 2022 nuk ka të dhëna për Sektorin për kundërvajtje.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata Themelore Berovë, vitin raportues 2022 e ka filluar me 50 lëndë të vjetra. Të reja të pranuar janë 33 lëndë, ose gjithsej në punë kanë qenë 83 lëndë të vjetra. Prej lëndëve të vjetra janë kryer 53 lëndë. Në këtë mënyrë gjatë vitit raportues në Gjykatën Themelore Berovë janë kryer 63,85% e lëndëve të vjetra.

Konstatime për burimet njerëzore

Në vitin raportues 2022 në Gjykatën Themelore Berovë kanë qenë të punësuar 22 persona dhe 1 gjyqtar i cili njëkohësisht është edhe UD kryetar i gjykatës.

Për realizimin e obligimeve të punës në Gjykatë ekzistojnë nevoja reale për punësimin e 1 personi të informatikës, 1 daktilografist, 1 bashkëpunëtor profesional, 1 referent i pavarur gjyqësor dhe 1 mirëmbajtës higjiene.

Kapacitetet hapësinore

Kapacitetet hapësinore të Gjykatës Themelore Berovë janë të përshtatshme për realizimin e obligimeve të punës. Gjykata Themelore Berovë është e vendosur në ndërtesë të një ndërtimi të fortë me beton dhe hekur. Gjykata ka dy hyrje, nga të cilat njërën e shfrytëzon Prokuroria Publike Berovë.

Gjatë vitit raportues është bërë furnizimi me kamera për video mbikëqyrje dhe qendër telefoni.

Instalimi për ngrohje me avull në Gjykatë është i vjetruar dhe është i domosdoshëm rinovimi urgjent. Nga aspekti i gjendjes së sigurisë duhet të vendoset një derë detektor në hyrjen e Gjykatës.

Teknologjia informatike

Gjatë vitit raportues 2022 Gjykata Themelore Berovë është e pajisur me kompjuterë të rinj, printerë, skanerë dhe serverë të rinj, ashtu që është përmirësuar furnizimi i gjykatës me pajisje të informatikës.

Për nevojat e gjykatës për realizimin e tërësishëm të obligimeve të punës nevojitet të sigurohen edhe 3 kompjuterë të rinj, në mënyrë që do të përmbusheshin në tërësi nevojat e pajisjes informatike.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në Gjykatën Themelore Berovë gjatë vitit 2022 gjithsej janë kryer 83,76% në nivel të gjykatës, që do të thotë se Gjykata Themelore Berovë është gjykatë e përditësuar.

Propozim masa:

- Në Sektorin penal të Gjykatës Themelore Berovë të bëhen përpjekje më të mëdha që të tejkalohet fluksi i lëndëve;
- Në nivel të gjykatës janë kryer 63,85% nga lëndët e vjetra, në mënyrë që është i domosdoshëm angazhim më i madh në nivel të gjykatës për kryerjen e lëndëve të vjetra të pakryera;
- Domosdoshmëria e unifikimit dhe gjithë përfshirja e raportit vjetor të punës së gjykatës, me të dhëna të plota për lëndët në Sektorin për kundërvajtje për vitin 2022 dhe
- Për rritjen e efikasitetit të gjykatës duhet të realizohen punësime të reja dhe furnizim me pajisje informatike.

GJYKATA THEMELORE VINICË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 703 lëndë, ndërsa ka pranuar 4.148 lëndë. Përsëri në punë janë marrë 35 lëndë. Prej tyre në punë ka pasur gjithsej 4.886 lëndë, prej të cilave janë kryer 4.335 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 551 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkaluar dhe mbetja është zvogëluar për 152 lëndë, përkatësisht për 21,62 % të lëndëve që kanë mbetur nga viti 2021.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar për 731 lëndë dhe të gjitha janë të kryera.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Gjendja e punës së lëndëve është si vijon:

Sektorin penal

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 572 lëndëve. Janë pranuar 2.156 lëndë të reja, ndërsa 31 lëndë janë marrë përsëri në punë. Gjithsej në punë ka pasur 2.759 lëndë, prej të cilave të kryera janë 2.332 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 427 lëndë. mbetja e lëndëve është zvogëluar për 145 lëndë ose për 25,35% në krahasim me vitin 2021.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: prej 913 lëndëve të kryera (sipas të dhënave nga tabela nr.5 që nuk përshtatet me të dhënat për lëndët e kryera nga tabela nr.4) të ankuara janë 78 lëndë. Pas kësaj, 38 lëndë ose 4,2 % janë të konfirmuara, 29 lëndë ose 3,2 % janë të abroguara dhe 11 lëndë ose 1,2 % janë të ndryshuara. Përqindjet janë marrë në raport me numrin e 913 lëndëve të kryera.

Sektorin civil

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 131 lëndëve. Janë pranuar 1.261 lëndë, dhe me 4 lëndë të marra përsëri në punë, gjithsej në punë ka pasur 1.396 lëndë. Janë kryer 1.272 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 124 lëndë. Mbetja e lëndëve është zvogëluar për 7 lëndë ose për 5,34 %.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: prej 217 lëndëve të kryera (sipas të dhënave nga tabela nr.5 që nuk përshtatet me të dhënat për lëndët e kryera nga tabela nr.4) të ankuara janë 45 lëndë. Prej 38 lëndëve të pa ankuara ose 17,5 % janë të konfirmuara, 4 lëndë ose 1,8 % të abroguara dhe 3 lëndë ose 1,4 % të ndryshuara. Përqindjet janë marrë në raport me numrin e 217 lëndëve të kryera.

Paralajmërim: Në raportin që Gjykata Themelore Vinicë e dorëzoi në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë dhënë të dhëna sipas llojeve të ndara të lëndëve por vetëm në mënyrë grupore për të gjitha lëndët nga sektori.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata Themelore Vinicë në fillim të vitit 2022 ka pasur 12 lëndë të vjetra. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 16 lëndë të vjetra, që do të thotë se numri është rritur për 4 lëndë.

Burime njerëzore

Gjatë vitit 2022 Gjykata Themelore Vinicë ka punuar me dy gjyqtarë dhe me kryetarin e gjykatës.

Sipas Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Vinicë janë paraparë 38 vende pune, nga të cilat janë plotësuar vetëm 16. Nga këtu, gjykata punon me një numër të pa mjaftuar të realizuesve-nëpunësve gjyqësor.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Vinicë është vendosur në ndërtesë që në tërësi nuk i plotëson nevojat hapësinore të gjykatës.

Pajisja ekzistuese vazhdimisht mirëmbahet.

Në sferën IT nevojitet ri përtëritja e lidhjes së rrjetit aktual, që është që nga viti 2009.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Nga aspekti i punës së lëndëve gjykata ka treguar përditësim.

Cilësia e punës dallohet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve të pa ankuara dhe cilësia e punës lidhur me gjithsej lëndët e kryera.

Propozim masa:

Në periudhën e ardhshme nevojitet të bëhen përpjekje lidhur me çështjen për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj dhe plotësimi i vendeve të punës në shërbimin gjyqësor.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet hapësinore dhe kapacitetet e pajisjes informatike të gjykatës.

Nevojitet vazhdimi me punë cilësore.

GJYKATA THEMELORE DELLÇEVË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjatë vitit 2022 në nivel të gjykatës kanë qenë gjithsej 6523 lëndë, nga të cilat të kryera janë 5012 lëndë, ndërsa 1511 lëndë udhëhiqen si të pakryera. Fluksi është tejkaluar, përkatësisht janë kryer gjithsej 76,48% nga gjithsej numri i lëndëve në vitin 2022.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punë 628 lëndë, të kryera janë 628 lëndë, nuk ka lëndë të pakryera.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Janë kryer 1204 lëndë, nga të cilat të konfirmuara 46 përkatësisht 3,82 %, të abroguara 18 përkatësisht 1,49% dhe të ndryshuara 12 përkatësisht 0,99%.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

- Sektori penal

Në punë gjithsej kanë qenë 3558 lëndë, nga të cilat të kryera janë 2690, ndërsa të pakryera kanë mbetur 868 lëndë.

Cilësia e punës: Janë kryer 951 lëndë, nga të cilat të konfirmuara 19 përkatësisht 1,99%, të arboguara 11 përkatësisht 1,15%, të ndryshuara 9 përkatësisht 0,94%.

- Sektori civil

Në punë kanë qenë gjithsej 2288 lëndë, nga të cilat 1659 janë kryer, kanë mbetur të pakryera 629 lëndë.

Cilësia e punës: Janë kryer 253 lëndë nga të cilat të konfirmuara janë 27 përkatësisht 10,67%, të abroguara 7 përkatësisht 2,76%, të ndryshuara 3 përkatësisht 1,18%.

Për Sektorin për kundërvajtje nuk ka të dhëna në Raportin vjetor të punës së Gjykatës Themelore Dellçevë, për vitin 2022.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2022 kanë mbetur të pakryera 54 lëndë, të reja të pranuar janë 112 lëndë, gjithsej lëndë në punë kanë qenë 166, nga të cilat 109 lëndë janë të kryera, ndërsa të pakryera kanë mbetur 57 lëndë.

Burime njerëzore

Në vitin 2022 në Gjykatën Themelore Dellçevë gjithsej të punësuar kanë qenë 32 persona, nga të cilët 26 në kohë të pacaktuar dhe 6 persona në kohë të caktuar deri më 31.12.2022. Gjatë vitit 2022, një bashkëpunëtor profesional ka shkuar në pension, ndërsa një ka shkuar në Akademinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, ashtu që gjykata ka mbetur pa bashkëpunëtorë gjyqësor. Dy daktilografiste kanë dhënë dorëheqje. Në gjykatë ka një gjyqtar i cili njëkohësisht është edhe kryetar i gjykatës. Në gjykatë ka: një këshilltar gjyqësor – person i informatikës, një bashkëpunëtor më i ri – kontabilist, një bashkëpunëtor më i ri profesional, tre referentë të pavarur gjyqësor, një referent i lartë, dy referentë gjyqësor, shtatë referent më të rinj, shtatë polic gjyqësor, një vozitës – mjeshtër i përgjithsëm dhe një mirëmbajtëse higjiene. Përkohësisht kanë qenë të punësuar dy dorëzues për Komunën Makedonska Kamenica, një mirëmbajtës higjiene, një daktilografistë dhe dy bashkëpunëtor gjyqësor.

Kapacitetet hapësinore

Gjykata Themelore Dellçevë punon në ndërtesë, në të cilën tre hapësira i shfrytëzon Prokuroria Publike Dellçevë, me hyrje të posaçme. Theksohet nevoja për rinovimin urgjent të ngrohjes me avull dhe ndërrimin e dy kazanëve me avull. Nevoja për rinovim është theksuar edhe në raportin e punës së Gjykatës Themelore Dellçevë për vitin 2022. Gjithashtu, nevojitet të vendoset derë detektor për hyrjen në gjykatë.

Në këtë gjykatë zbatohet sistemi AKMIS. Një nga sallat është e pajisur për incizim me zë të seancave dhe e njëjta shfrytëzohet. Sa i përket teknologjisë informatike, e njëjta i përmbush nevojat momentale. Aplikacionet programore në gjykatë funksionojnë mirë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në bazë të dhënave të referuara në Gjykatën Themelore Dellçevë, në fillim të vitit 2022, kanë mbetur 1180 lëndë të pakryera, ndërsa gjithsej në punë ka pasur 6523 lëndë, nga të cilat janë kryer 5012 lëndë, ndërsa 1511 udhëhiqen si të pakryera, dhe rezultojnë që Gjykata Themelore Dellçevë gjatë vitit 2022 ka qenë **gjykatë e pa përditësuar**, ngase nuk ka arritur të tejkalojë fluksin për 302 lëndë dhe e ka rritur mbetjen për 331 lëndë. Për realizimin efikas në procedimin në nivel të gjykatës është e domosdoshme të jepet prioritet në zgjedhjen e lëndëve të vjetra të pakryera.

Propozim masa:

Në bazë të dhënave të ekspozuara, rezultojnë se për përmirësimin e gjendjes në gjykatë, nevojiten përpjekje të mëdha për përmirësimin e cilësisë së punës në nivel të gjykatës, dhe sidomos në sektorin penal;

- Të merren masa për sigurimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe për plotësimin e vendeve të tjera të punës,

- të shihet mundësia për ri pajisjen, përkatësisht rinovimi i gjykatës si dhe përmirësimi i gjendjes së sigurisë të gjykatës, me vendosjen e detektor derës në hyrjen e gjykatës.

GJYKATA THEMELORE KOÇAN

PUNA E LËNDËS NË NIVEL TË GJYKATËS

Në Gjykatën Themelore Koçan, kanë mbetur 2.023 lëndë të pakryera. Gjatë vitit 2022 janë formuar dhe pranuar në punë 12.353 lëndë të reja, 89 lëndë janë përsëri në punë dhe 4 lëndë janë gabimisht të evidentuara. Gjatë vitit 2022, gjithsej në punë kanë qenë 14.461 lëndë. Gjatë vitit 2022, gjithsej të kryera janë 12.170 lëndë. Në vitin 2022, numri gjithsej i lëndëve të pakryera është 2.291.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në fillim të vitit 2022 kanë mbetur 3 lëndë të pakryera.

Gjatë vitit 2022 numri i lëndëve të pranuar të reja është 2.093 lëndë dhe një lëndë gabimisht e evidentuar. Gjithsej numri i lëndëve në punë në vitin 2022 është 2.095 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve të kryera në vitin 2022 është 2.092 lëndë, të pakryera 3 lëndë.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Janë kryer gjithsej 2.500 lëndë, të konfirmuara 303 lëndë ose 12,1%, të abroguara 71 lëndë ose 2,8 % dhe të ndryshuara 36 lëndë ose 1,4%.

Spektori penal

Nga viti i kaluar 2021, në sektorin penal kanë mbetur 1.514 lëndë të pakryera. Numri i lëndëve të reja të pranuar në vitin 2022 ka qenë 7.047 lëndë, lëndë përsëri në punë ka pasur 46 dhe 1 lëndë ka qenë gabimisht e evidentuar. Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2022 ka qenë 8.606 lëndë. Gjithsej numri i lëndëve të kryera gjatë vitit 2022 në sektorin penal është 7.003 lëndë. Lëndë të pakryera deri në fund të vitit 2022 kanë mbetur 1.603 lëndë.

Cilësia e Sektorit penal

Prej 1.674 lëndëve të ankuara dhe të kryera, të konfirmuara janë 138 lëndë ose 8,2%, të abroguara janë 34 lëndë ose 2 % dhe të ndryshuara janë 27 lëndë ose 1,6%.

Spektori civil

Nga viti i kaluar 2021, në sektorin civil kanë mbetur 506 lëndë. Numri i lëndëve të reja të pranuar në vitin 2022 është 3.213 lëndë, 43 lëndë përsëri në punë dhe 2 lëndë janë evidentuar gabimisht. Gjithsej numri i lëndëve në punë gjatë vitit 2022 është 3.760 lëndë. Numri i lëndëve të kryera gjatë vitit 2022 në sektorin civil është 3.075 lëndë. Të pakryera deri në fund të vitit 2022 kanë mbetur 685 lëndë.

Cilësia e sektorit civil

Prej 826 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 165 lëndë ose 20%, të abroguara janë 37 lëndë ose 4,5% dhe të ndryshuara janë 10 lëndë ose 1,2%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit 2022 në Gjykatën Themelore Koçan, në punë ka pasur gjithsej 147 lëndë të vjetra sipas të gjitha bazave. Lëndë penale për persona të moshës madhore janë gjithsej 38, nga të cilat 1 nga viti 2013, 2 nga viti 2015, 1 nga viti 2016, 3 nga viti 2017, 2 nga viti 2018, 5 nga viti 2019, 24 nga viti 2020. Lëndë për kundërvajtje janë gjithsej 47, nga të cilat 1 nga viti 2017, 18 nga viti 2019 dhe 28 nga viti 2020. Urdhërpagesa sipas ankesave 1 lëndë nga viti 2020. Këshilli penal jashtë seancë dëgjimore 2 lëndë nga viti 2020, Trashëgimore gjithsej 18 lëndë nga të cilat 2 nga viti 2016, 2 nga viti 2017, 4 nga viti 2018, 3 nga viti 2019 dhe 7 nga viti 2020. Përmbarimi i dënimeve penale në para, shpenzime dhe paushall 2 lëndë nga viti 2020. Konteste pronësore 1 nga viti 2015. Konteste të vlerës së vogël 1 nga viti 2020. Konteste tregtare gjithsej 5 lëndë nga të cilat 1 nga viti 2019 dhe 3 nga viti 2020. Konteste obliguese 3 nga viti 2019. Lëndë jashtë kontestimeve 1 nga viti 2019. Përmbarimi i burgimit të personave të mitur dhe masa edukuese 1 nga viti 2018. Përmbarimi i gjobës për kundërvajtje gjithsej 2 lëndë nga të cilat 1 nga viti 2018 dhe 1 nga viti 2020. Përmbarimi i sanksioneve penale dhe për kundërvajtje dhe masa alternative gjithsej 3 lëndë nga të cilat 1 nga viti 2019 dhe 2 nga viti 2020. Persona të thirrur për vuajtjen e dënimit gjithsej 22 lëndë nga të cilat 1 nga viti 2016, 3 nga viti 2017, 4 nga viti 2018, 9 nga viti 2019 dhe 5 nga viti 2020.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Koçan deri më 31.12.2022 kanë qenë të punësuar 34 nëpunës gjyqësor sipas Ligjit për shërbimin gjyqësor, 3 punonjës sipas Ligjit për marrëdhënie pune dhe 8 gjyqtarë, por gjatë vitit 2022 një gjyqtar është emëruar për U.D. kryetar në Gjykatën Themelore Berovë, një gjyqtar i deleguar në Gjykatën Themelore Vinicë në muajin dhjetor 2022 është kthyer në Gjykatën Themelore Koçan, ndërsa një gjyqtar është zgjedhur për kryetar të Gjykatës Themelore Vinicë, përkatësisht gjatë vitit funksionin e gjyqtarit e kanë kryer gjithsej 6 gjyqtarë.

Gjatë vitit 2022 janë zbrazur 4 vende pune, ndërsa në vitin 2023 është paraparë pensionimi i një gjyqtari. Gjykata mbetet me 5 gjyqtarë, ndërsa sipas vendimit të Këshillit gjyqësor të RMV për Gjykatën Themelore Koçan është paraparë që funksionin e gjyqtarit ta realizojnë 10 gjyqtarë.

Probleme të zakonshme

Në këtë gjykatë edhe më tej ka probleme teknike me sistemin për incizim me zë, në mënyrë që incizimi me zë i seancave civile bëhet në një sallë gjykimi që është e përgatitur teknikisht, por palëve iu dorëzohen procesverbale me shkrim në vend të CD-ve. Nevojitet furnizimi me pajisje të re të plotë për audio incizim të sallave të gjykimit.

Kapacitetet hapësinore

Nevojitet të gjendet zgjidhje për sigurimin e hapësirës shtesë për sallat e gjykimit, si dhe për të vendosurit e shërbimit gjyqësor. Kushtet hapësinore në gjykatë nuk përmbushen pasi që nuk ka hapësirë të posaçme për daktilografistë, nuk ka hapësirë për avokatë dhe, ndërsa hapësira për arkivin nuk mjafton për ti vendosur lëndët. Problem është që në të njëjtën ndërtesë janë të vendosur Prokuroria Themelore Publike dhe Avokatura e shtetit që marrin një pjesë të konsideruar të hapësirave. Dyshemeja e zyrave gjyqësore janë me dëmtrim të dukshëm, dhe edhe pse janë kërkuar mjete për ndërrimin e saj, megjithatë mjete të tilla nuk janë miratuar.

Teknologjia informatike

Pajisja IKT në Gjykatën Themelore Koçan i përmbush problemet aktuale.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Koçan, për shkak të numrit të pa mjaftuar të gjyqtarëve në vitin 2022 është gjykatë **e pa përditësuar**, nuk ka arritur të tejkalojë fluksin në disa sfera, ndërsa në disa sfera është rritur edhe mbetja.

Propozim masa:

Të sigurohen disa kapacitete hapësinore për salla gjykimi për punonjësit dhe hapësira për avokatë.

Të bëhet orvatje të vazhdueshme për plotësimin e vendeve të zbrazura të punës për nëpunësit gjyqësor për të gjitha bazat, ngase numri i këtyre vendeve të punës gjatë vitit raportues është i konsiderueshëm.

Gjithashtu nevojitet të plotësohen edhe vendet e zbrazura të gjyqtarëve për zbatimin papengesë të Orarit vjetor të punës së gjykatës.

GJYKATA THEMELORE RADOVISH

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Lëndë të pakryera në fillim të vitit raportues janë 939 lëndë.

Gjatë vitit 2022, në Gjykatën Themelore Radovish janë formuar dhe pranuar në punë 8815 lëndë të reja.

Gjatë vitit 2022, në punë kanë qenë gjithsej 9778 lëndë.

Gjatë vitit 2022, janë kryer gjithsej 8452 lëndë.

Gjatë vitit 2022, gjithsej numri i lëndëve të pakryera është 1326.

Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore Radovish, nuk e ka tejkaluar fluksin, ndërsa mbetja është rritur për 380 lëndë.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës

Prej 8452 lëndëve të kryera, ndërsa prej lëndëve të pa ankuara të kthyer gjatë vitit raportues: të konfirmuara janë 83 përkatësisht 4.78%, të ndryshuara janë 24, përkatësisht 1.38%, të abroguara janë 21 përkatësisht 121%.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjatë vitit raportues në gjykatë gjithsej në punë ka pasur 91 lëndë me statusin e lëndëve të vjetra, nga të cilat 63 nga viti i kaluar që kanë mbetur të pakryera, ndërsa janë pranuar 28 gjatë vitit 2022, ndërsa janë kryer 41 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 50 lëndë.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Radovish gjatë vitit 2022 nuk e ka tejkaluar fluksin e lëndëve dhe është rritur mbetja e lëndëve dhe është **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa: Zgjedhja e gjyqtarëve, punësimi i nëpunësve gjyqësor.

GJYKATA THEMELORE SVETI NIKOLLË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Në vitin 2022 në Gjykatën Themelore Sveti Nikollë, nga viti i kaluar kanë mbetur 923 lëndë të pakryera, të reja të pranuar kanë qenë 5.218 lëndë, përsëri në punë kanë qenë 23 lëndë, gabimisht të evidentuara 0 lëndë, gjithsej në punë kanë qenë 6.164 lëndë, të kryera 5.307 lëndë, ndërsa kanë mbetur 857 lëndë të pakryera.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në fillim të vitit raportues 2022 janë pranuar 872 lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë 872 lëndë nga të cilat 872 janë të kryera, nuk ka lëndë të pakryer.

PUNA E SEKTORËVE DHE CILËSIA E PUNËS

Spektori penal

Në fillim të vitit 2022 janë 726 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 2.648 lëndë, përsëri në punë kanë qenë 14 lëndë, gabimisht të evidentuara 0 lëndë, gjithsej në punë 3.388 lëndë, të kryera kanë qenë 2.745 lëndë, ndërsa të pakryera janë 643 lëndë.

Cilësia e punës në këtë sektor është si vijon: prej gjithsej 2.745 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 42 lëndë ose 1,53%, të abroguara janë 12 lëndë ose 0,43% dhe të ndryshuara 1 lëndë ose 0,03%.

Spektori civil

Në fillim të vitit 2022, 89 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 292 lëndë, përsëri në punë kanë qenë 9 lëndë, gabimisht të evidentuar 0 lëndë, gjithsej në punë 390 lëndë, janë kryer 274 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 116 lëndë.

Cilësia e punës në këtë sektor është si vijon: nga gjithsej 274 lëndët e kryera, të konfirmuara janë 41 lëndë ose 14,96%, të abroguara 3 lëndë ose 1,09% dhe të ndryshuara janë 1 lëndë ose 0,36%.

Cilësia e punës në nivel të gjykatës është si vijon: Prej gjithsej 5.307 lëndët e kryera, të konfirmuara kanë qenë 83 ose 1,56%, të abroguara janë 15 lëndë ose 0,28 % dhe të ndryshuara 2 lëndë ose 0,03 %.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fund të vitit raportues, prej lëndëve që i kanë zgjidhur gjyqtarët kanë mbetur të pakryera 2 lëndë të vjetra nga përmbarimi i sanksioneve të cilat një për herë të parë është evidentuar 2019, një për herë të parë në 2020, 2 lëndë të vjetra të pakryera nga penale – persona të moshës madhore nga të cilat një për herë të parë është evidentuar në 2020 dhe një për herë të parë është evidentuar 2022.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Sveti Nikollë për realizimin e funksionit të gjyqtarit janë paraparë 4 gjyqtarë. Gjatë vitit 2022 funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar 3 gjyqtarë të zgjedhur në gjykatë, por në janar 2023 është zbrazur edhe një vend gjyqtari. Të paplotësuara janë dy vende për gjyqtarë.

Sipas Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në këtë gjykatë, janë sistemuar 19 vende pune, ndërsa janë paraparë 41 realizues për vende pune të ndara.

Kjo gjykatë gjatë vitit 2022 ka punuar me 15 nëpunës gjyqësor nga të cilët 3 nëpunës profesional gjyqësor, 6 nëpunës ndihmës-profesional gjyqësor, 4 polic gjyqësor dhe 2 sipas Ligjit për marrëdhënie pune.

Ka nevojë për punësim me prioritet të 2 realizuesve – polic gjyqësor që janë paraparë me sistematizimin, ndërsa njëkohësisht në përputhje me sistematizimin ka disa vende të zbrazura pune, të cilat janë të theksuara në detaje në Raportin e punës së kësaj gjykate për vitin 2022.

Kapacitetet hapësinore

Ndërtesa e Gjykatës Themelore Sveti Nikollë është ndërtuar në vitin 1976. Gjyqtarët janë vendosur me zyra të veçanta, ndërsa ka zyra pune edhe për punonjësit tjerë në gjykatë.

Kapacitetet hapësinore në gjykatë janë të plotësuara, nevojitet që të ndërrohen dritaret, ngase janë të punuara nga druri dhe me kalimin e kohës janë deformuar dhe dëmtuar për shkak që ka humbje të madhe ngrohjeje.

Teknologjitë informatike

Në gjykatë përdoret teknologjia informatike edhe në vitin 2022 është siguruar një server i ri, që gjatë kohë është kërkuar, ndërsa kanë marrë edhe 4 kompjuterë cilësor, 3 printerë dhe 1 skanerë i mirë. Në gjykatë ende ka kompjuterë të vjetër dhe nuk mund të punojnë në sistem operativ të fuqishëm. Propozohet që çdo vit të bëhet një derdhje e vogël e kompjuterëve të rinj dhe printerëve siç ka qenë rasti me furnizimin e centralizuar nga viti 2022.

Punësime të planifikuara dhe të realizuara

Nga muaji shtator deri në fund të vitit janë punësuar 5 nëpunës gjyqësor në kohë të caktuar, por me gjendjen momentale të punësuarve në kohë të pacaktuar gjendja është alarmante, që dukshëm ndikon në funksionimin e gjykatës, në mënyrë që është e domosdoshme që në periudhën e ardhshme të miratohen punësime dhe plotësimi i vendeve të zbrazura.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Gjykata Themelore Sveti Nikollë ka arritur të tejkalojë fluksin dhe të zvogëlojë mbetjen e lëndëve të vitit të kaluar dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**.

Propozim masa: Nevojitet që të plotësohen vendet e gjyqtarëve dhe kuadrit administrativo – profesional.

GJYKATA THEMELORE STRUMICË

PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata vitin e ka filluar me 3.186 lëndë, ndërsa ka pranuar 19.691 lëndë të reja. Përsëri në punë janë marrë 125 lëndë, ndërsa gabimisht të evidentuara janë 3 lëndë. Në punë kanë qenë gjithsej 22.999 lëndë, nga të cilat të kryera janë 20.044 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 2.955 lëndë. Fluksi i lëndëve është tejkaluar dhe mbetja është

zvogëluar për 231 lëndë, përkatësisht për 231 lëndë, përkatësisht për 7,25 % në krahasim me mbetjen nga viti 2021.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në administratën gjyqësore si lëndë në regjistrat përkatës është vepruar për 3.429 lëndë, janë kryer 3.408 lëndë, ndërsa procedura nuk ka përfunduar për 21 lëndë.

Puna e sektorëve dhe cilësia e punës

Gjendja me punën e lëndëve është si vijon:

Sektori penal

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 1.693 lëndëve. Janë pranuar 9.871 lëndë të reja, 61 lëndë janë marrë përsëri në punë, ndërsa 2 lëndë janë evidentuar gabimisht. Gjithsej në punë ka pasur 11.623 lëndë, nga të cilat të kryera janë 9.908 lëndë, përderisa të pakryera kanë mbetur 1.715 lëndë. Mbetja e lëndëve është rritur për 22 lëndë ose për 1.3 % në krahasim me mbetjen e vitit 2021.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: prej 3.187 lëndëve të kryera (sipas të dhënës nga tabela nr.5 që nuk përputhet me të dhënë për lëndë të kryera nga tabela nr.4) ankimor janë 250 lëndë. Pas kësaj, 170 lëndë ose 5,33 % janë të konfirmuara, 44 lëndë ose 1,38 % janë të abroguara dhe 36 lëndë ose 1,13 % janë të ndryshuara. Përqindjet janë marrë në raport me numrin e 3.187 lëndëve të kryera.

Sektori civil

Nga viti i kaluar ka pasur mbetje prej 1.493 lëndëve. Janë pranuar 9.820 lëndë të reja, me 64 lëndë të marra përsëri në punë, si dhe me 1 lëndë gabimisht të evidentuar, gjithsej në punë kanë mbetur 11.376 lëndë. Janë kryer 10.136, ndonëse të pakryera kanë mbetur 1.240 lëndë. Mbetja e lëndëve është zvogëluar për 253 lëndë ose për 16,94 %.

Te ky lloj i lëndëve cilësia e punës është si vijon: prej 1.570 lëndëve (sipas të dhënës nga tabela nr.5 që nuk përputhet me të dhënë për lëndët e kryera nga tabela nr.4) ankimor janë 275 lëndë. Prej 213 lëndët të ankuara ose 13,57 % janë të konfirmuara, 51 lëndë ose 3,25 % janë të abroguara dhe 11 lëndë ose 0,7 %, janë të ndryshuara. Përqindjet janë marrë në raportet me numrin e 1.570 lëndëve të kryera.

Paralajmërim: Në raportin që Gjykata Themelore Strumicë e dorëzoi në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë dhënë të dhëna për llojet e ndara të lëndëve por vetëm në grupe për të gjitha lëndët e sektorit.

Gjendja me lëndët e vjetra

Gjykata Themelore Strumicë në fillim të vitit 2022 ka pasur 22 lëndë të vjetra. Në fund të vitit 2022 kanë mbetur 53 lëndë të vjetra, që do të thotë se numri është rritur për 31 lëndë.

Burimet njerëzore

Sipas sistematizimit në Gjykatën Themelore Strumicë duhet të punojnë 15 gjyqtarë, por gjatë vitit raportues 2022 funksionin e gjyqtarit e kanë realizuar 9 gjyqtarë së bashku me Kryetarin e Gjykatës, nga të cilët njëri në bazë të dokumentacionit mjekësor punon me orar të shkurtuar pune. Në gjysmën e parë të vitit 2023 në pension ka shkuar edhe një gjyqtar.

Sipas Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strumicë janë paraparë 117 vende pune nga të cilat janë plotësuar 58.

Kapacitetet hapësinore

Në Gjykatën Supreme Strumicë, në vitin 2022 është siguruar pajisje e re IT, ndërsa është pajisur edhe salla e gjykimit me audio dhe video pajisje për incizimin e seancave penale.

Pajisja ekzistuese vazhdimisht mirëmbahet.

Gjykata ende ballafaqohet me mungesën e karrigeve në sallat e gjykimit dhe në zyrat sidomos që nga furnizimi i kaluar janë amortizuar rreth 200 karrige, ashtu që ka nevojë prioritar për furnizimin me karrige të reja.

Njëkohësisht, sipas të theksuarës, detektor dera e metalit në Gjykatë është në gjendje të keqe dhe i nevojitet urgjentisht të ndërrohet me të re, ndërsa Kryetari konsideron se nevojitet të sigurohet edhe një aparat skaneri.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Nga aspekti i punës së lëndëve të gjykatës, Gjykata Themelore Strumicë e ka tejkuluar fluksin dhe konsiderohet si **gjykatë e përditësuar**.

Cilësia e punës karakterizohet edhe me përqindjen e lartë të vendimeve të pa ankuara dhe cilësia e punës në raport me gjithsej lëndët e kryera.

Propozim masa:

Në periudhën e ardhshme nevojitet të merren masa lidhur me çështjen për zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj dhe plotësimin e vendeve të punës në shërbimin gjyqësor.

Kushtet hapësinore dhe gjendja me pajisjen informatike është e kënaqshme.

Në periudhën e ardhshme duhet të përmirësohen kapacitetet me pajisjen informatike të gjykatës, të përmirësohet pajisja e kuadrove, të furnizohet mobilie e domosdoshme, si dhe të ndërrohet detektor dera e metalit.

Duhet të vazhdohet me punë cilësore.

GJYKATA THEMELORE SH TIP

PUNA E LËNDËVE

Në fund të vitit 2021 kanë mbetur gjithsej 3233 lëndë të pakryera, gjatë vitit 2022 janë pranuar gjithsej 23360 lëndë, 1 gabimisht e evidentuar dhe 168 lëndë janë marrë përsëri në punë ose gjithsej në punë ka pasur 26760 lëndë, janë kryer 22941 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera 3819 lëndë.

Sipas të dhënave Gjykata Themelore Shtip, në vitin raportues 2022 nuk e ka tejkuluar fluksin. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë ka kryer 85,72% të lëndëve.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në punën e administratës gjyqësore, në fillim të vitit nuk ka pasur lëndë të pakryera, gjatë vitit 2022 të reja të pranuar kanë qenë 1221 lëndë, gabimisht të evidentuara nuk ka. Nga gjithsej numri i lëndëve në punë, janë kryer 1220, ka mbetur 1 lëndë e pakryer.

Cilësia e lëndëve në nivel të gjykatës

Nga gjithsej numri i 6578 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 396 lëndë, përkatësisht 6,02%, të abroguara janë 114 lëndë, përkatësisht 1,73% dhe të ndryshuara janë 56 lëndë, përkatësisht 0,85%.

Puna e Sektorëve dhe cilësia e punës

Në Sektorin civil të Gjykatës Themelore Shtip, nga viti i kaluar raportues kanë mbetur 1581 lëndë të pakryera, të reja të pranuar kanë qenë 6606 lëndë, 75 lëndë janë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara 1 lëndë. Gjatë vitit 2022 në këtë sektor në punë kanë qenë gjithsej 8261 lëndë, nga të cilat janë kryer 6282 lëndë dhe kanë mbetur 1979 lëndë të pakryera. Sipas të dhënave Sektori civil nuk e ka tejkuluar fluksin e lëndëve.

Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorit civil në vitin raportues 2022 është si vijon: nga gjithsej numri i 2130 lëndëve të kryera, të konfirmuara janë 273 lëndë, përkatësisht 12,82%, të abroguara janë 65 lëndë, përkatësisht 3,05% dhe të ndryshuara 12 lëndë, përkatësisht 0,56%.

Në Sektorin penal të Gjykatës Themelore Shtip, nga viti i kaluar raportues kanë mbetur 1652 lëndë të pakryera, të reja të pranuar janë 15533 lëndë, 93 lëndë kanë qenë përsëri në punë, ndërsa gabimisht të evidentuara nuk ka. Gjatë vitit 2022 në këtë sektor në punë kanë qenë gjithsej 17278 lëndë, nga të cilat të kryera janë 15439 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 1839 lëndë. Sipas të dhënave Sektori penal në vitin 2022 nuk e ka tejkuluar fluksin e lëndëve.

Cilësia e lëndëve në nivel të Sektorit penal në vitin raportues 2022 është si vijon: Nga gjithsej numri i 4448 lëndëve të kryera, të konfirmuara, janë 123 lëndë, përkatësisht 2,77%, të abroguara 49 lëndë, përkatësisht 1,10% dhe të ndryshuara 44 lëndë, përkatësisht 0,99%.

Në vitin raportues për punën e Gjykatës Themelore Shtip, për vitin 2022 nuk ka të dhëna për lëndë në Sektorin për kundërvajtje.

Gjendja me lëndët e vjetra

Në fillim të vitit 2022 gjykata në punë ka pasur 175 lëndë të vjetra, gjatë vitit janë pranuar 178 lëndë të reja, në punë ka pasur gjithsej 353 lëndë të vjetra, nga të cilat të kryera janë 225 lëndë, në fund të vitit kanë mbetur 128 lëndë të vjetra.

Kapacitetet hapësinore

Pajisja e Gjykatës dhe ndërtesës së gjykatës është në nivel të kënaqshëm. I domosdoshëm është furnizimi me dy dyer të reja me sistem për evidentim.

Në Gjykatë ekzistojnë tre salla gjykimi, ndërsa për shkak të numrit të vogël të sallave gjyqtarët kryesisht gjykojnë në zyrat e tyre. Tri sallat ekzistuese të gjykimit nuk mjaftojnë për nevojat e Gjykatës Themelore Shtip. Gjatë vitit 2022 ka filluar procedura për adaptim dhe për pajisje me sallën e katërt të re, që pritet të përfundojë në vitin 2023.

Për shkak të konfigurimit të ndërtesës gjyqësore është e pamundshme që në sallat ekzistuese të bëhet ndarja e të dëmtuarve – viktimat që të mbrohet sekretet e identitetit të viktimës dhe të respektohet drejta e privatësisë së saj.

Për njësinë në Probishtip është siguruar dhe përgatitur hapësirë për funksionimin normal të saj. Megjithatë, ekzistojnë dëmtime të mureve në hapësirat dhe është i domosdoshëm riparimi i të njëjtëve, përkatësisht ngjyrosja dhe pajisja me gjëra adekuata për ngrohje ftohje. Kjo nevojitet për efikasitetin në veprimin, si në funksion të qytetarëve, ashtu edhe të Komunës Probishtip.

Në Gjykatën Themelore Shtip, ka katër automjete, nga të cilat një "Opell Astra" furnizuar në vitin 2019, ndërsa tre automjetet tjera nuk janë në funksion dhe nuk janë të regjistruara.

Në Gjykatën Themelore Shtip mungon vozitës. Kujdesin për automjetet e realizojnë punonjësit – policët gjyqësor, me pëlqimin e tyre të cilët edhe i drejtojnë automjetet sipas nevojës.

Në Gjykatën Themelore Shtip është i domosdoshëm rikonstruktimi i instalimit elektrik dhe të ujit, duke qenë se e njëjta është me datë më të vjetër, ndërsa është me kapacitet më të madh të punës.

Teknologjia informatike

Në vitin 2022 kanë instaluar një server të ri, por për nevojat e serverit është i nevojshëm pajisja dhe rinovimi i serverit sipas normave të kërkuara. Duhet të bëhen punë të domosdoshme ndërtimore, montimi i dyshemës së lëvizshme, sensor (mjet që zbulon veti fizike) për lagështi, kufizimi i qasjes në hapësirat me serverët dhe ndërrimi i pajisjeve të klimës në server sallën.

Për nevojat e sallave me zë nevojitet furnizimi me pajisje të re kompjuterike dhe softuer për incizim me zë. Kompjuterët dhe softueri për incizim me zë janë për Windows XP që nuk ka më kurrfarë përkrahje nga aspekti operativ softuerik dhe harduerik, në mënyrë që nuk janë kontakti bile me serverët e ri.

Patjetër nevojitet të sigurohen 15 kompjuterë, përfshirë edhe Njësinë në Probishtip, ose të sigurohen SSD disqe për përmirësimin e kompjuterëve ekzistues.

Monitorët në sallat janë të prishura dhe nuk janë në funksion, në mënyrë që domosdo duhet të sigurohen 12 monitorë, seksione për tregimin e të gjithë monitorëve në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën kohë copëza të holla.

Printerët që përdoren në gjykatë janë veç më të amortizuara, në mënyrë që duhet furnizimi me printerë të rinj.

Duhet të sigurohen 3 printerë rrjeti me opsionin për printimin dy anësh.

Gjithashtu, domosdo nevojitet të sigurohet edhe një aparat për fotokopjim që do të mund të përdoret edhe si printer rrjeti dhe skaner.

Duhet 4 UPS me fuqi min. 1500 VA.

Nevojitet trajnimi për përdoruesit e AKMIS-it, si dhe dokumentim më i mirë i ndryshimeve.

Burime njerëzore

Në Gjykatën Themelore Shtip në vitin 2022 ka 13 gjyqtarë, nga të cilët 6 gjyqtarë janë sistemuar në sektorin penal, 7 gjyqtarë në sektorin civil. Gjatë vitit tre gjyqtarë kanë shkuar në pension, në mënyrë që gjykata ka punuar me numër të zvogëluar të gjyqtarëve.

Në vitin raportues 2022 në Gjykatë ka pasur gjithsej 62 punonjës në shërbimin

gjyqësor, megjithatë, në përputhje me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës janë paraparë 120 vende pune. Në Gjykatën Themelore Shtip nuk ka kuadër të mjaftueshëm të nëpunësve gjyqësor për shkak të pensionimit, pezullimeve dhe vendeve të zbrazura.

Gjatë vitit 2022 është realizuar vetëm një punësim – daktilografistë, ndërsa 1 person është angazhuar me kontratë në vepër.

Në Gjykatën Themelore Shtip, nevojitet punësimi i një mjeshtri të përgjithshëm, vend ky që asnjëherë nuk është plotësuar, ndërsa deri më tani gjykata e ka shfrytëzuar mjeshtrin e përgjithshëm të Gjykatës së Apelit Shtip.

Në Gjykatën Themelore Shtip nevojitet punësimi i një vozitësi dhe një person komandimi të policisë gjyqësore.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE ME PROPOZIM MASA

Në vitin raportues 2022 Gjykata Themelore Shtip nuk e ka tejkuluar fluksin dhe ka kryer 85,72% nga numri gjithsej i lëndëve në punë, që do të thotë se është **gjykatë e pa përditësuar**.

Propozim masa:

- Të merren masa për përmirësimin e efikasitetit në sektorin penal dhe civil për tejkalimin e fluksit të lëndëve;
- Të bëhen përpjekje për kryerjen e lëndëve të pakryera të vjetra;
- Të mundësohen punësime të reja për ri pajisjen e kuadrit në përputhje me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës;
- Përmirësimi i kapaciteteve hapësinore në gjykatë;
- Marrja e masave për përmirësimin dhe mbindërtimin e teknologjisë informatike në nivel të gjykatës dhe
- Unifikimi dhe themelimi i Raportit vjetor për punën e Gjykatës Themelore Shtip me të dhënat në sektorin për kundërvajtje.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**